




Raport vjetor 2023

“Për veprimtarinë e inspektimit financiar publik”



DETYRAT E DIFP

Mars 2024

Qëllimi: Mbrojtja e interesave financiarë të njësive publike, kundrejt keqmenaxhimit të rëndë financiar, mashtrimit, vjedhjes, shkatërrimit të pronës, shpërdorimit të detyrës apo korrupsionit.

Veprimtaria: Veprimtaria e inspektimit financiar publik është veprimtari që kryhet pas faktit, mbi bazën e kërkesës, informacionit ose ankesës, për rregullshmërinë e transaksioneve dhe veprimtarive të tjera të menaxhimit financiar, të kryera nën përgjegjësinë e njësive publike dhe individëve, në mënyrë që:

- a) të përcaktojë shkeljet e akteve normative, si dhe të provojë dyshimet për mashtrimet e kryera;
- b) të zbulojë parregullsitë dhe dëmet e shkaktuara në pronën e njësive publike;
- c) të identifikojë individët përgjegjës për shkeljet e kryera dhe të kërkojë marrjen e masave zhdëmtuese, administrative apo disiplinore, sipas shkallës apo llojit të përgjegjësisë.

Hartimi i Raportit vjetor 2023 bazohet në nenin 13, pika 7, të Ligjit nr.112/2015 “Për inspektimin financiar publik”. Drejtoria e Inspektimit Financiar publik, paraqet tek Nëpunësi i Parë Autorizues dhe tek Ministri i Financave Raportin vjetor të veprimtarisë, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

Hartimi i Raportit vjetor të veprimtarisë së inspektimit financiar publik ka për qëllim të prezantojë veprimtarinë e inspektimit financiar publik për periudhën raportuese lidhur me realizimin e objektivave, zbatimin e detyrimeve ligjore në procesin e inspektimit financiar publik, si dhe masat zbatuese për objektivat e parashikuara për vitin 2023, me synim për një shërbim produktiv dhe eficient, në mbrojtje të interesave financiare të njësive publike kundrejt keqmenaxhimit të rëndë financiar, mashtrimit dhe korrupsionit.

2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:

Veprimtaria e Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik, në zbatim të Ligjit nr.112/2015 “Për inspektimin financiar publik” si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, është fokusuar në drejtim të arritjes së objektivave për vitin 2023, sa më poshtë vijon:

- a) Rritje cilësore e treguesve të shërbimit të inspektimit financiar publik.
- b) Përmirësim i kapaciteteve inspektuese dhe profesionale, si dhe rritje e përgjegjshmërisë dhe integritetit të inspektorëve financiarë publikë.

- c) Hartimi i Strategjisë Antikorrupsion për mbrojtjen e interesave financiare të BE:
- d) Zgjerimi i përdoruesve (oficerët e parregullsisve) të strukturave menaxhuese dhe operuese të IPA-s në AFIS portal:

Në përmbushje të objektivave sa më sipër renditur janë planifikuar dhe realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Shqyrtimi i kërkesave, informacioneve apo ankesave dhe dhënia e mendimit tek Nëpunësi i Parë Autorizues për fillimin ose jo të inspektimit financiar publik apo të inspektimit paraprak.
- Kryerja e inspektimeve financiare publike, me profesionalizëm e integritet, sipas rregullave të miratuara.
- Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit me OLAF, si dhe bashkëpunimi operacional në raste të kërkuara prej tij.
- Monitorim i zbatimit të masave të kërkuara nga Ministri i Financave, në përfundim të inspektimit financiar publik.
- Kërkimi dhe shkëmbimi i informacionit me njësi të tjera publike, në fushën e veprimtarisë së inspektimit financiar publik.

Rezultatet e arritura në zbatim të objektivave të Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik për vitin 2023, në mënyrë të përmbledhur:

A. Aktivitetet e kryera nga Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik (DIFP) për realizimin e objektivave të vitit 2023:

- Për periudhën raportuese veprimtaria e Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik është bazuar në Ligjin nr.112/2015 “Për inspektimin financiar publik” si dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij. Realizimi i objektivave të DIFP-së, në tregues sasiorë dhe cilësorë krahasuar me periudhën paraardhëse , për sa vijon:
 - Rritje e kapaciteteve profesionale dhe inspektuese të inspektorëve financiarë publikë, në shqyrtimin dhe vlerësimin me profesionalizëm të kërkesave, informacioneve apo ankesave të ardhura për inspektim financiar publik, si dhe në përmbushje të misioneve të inspektimeve financiare publike sipas rregullave të miratuara, që vlerësohet me “Performancë të lartë” nëpërmjet:
 - ✓ Forcimit të rolit të DIFP për inspektimin financiar publik, në angazhimin në procesin e inspektimit financiar publik të punonjësve të kësaj strukture.
 - Rritjen e besueshmërisë tek DIFP nga subjektet dhe individët që denoncojnë raste të mashtrimeve dhe të korrupsionit me fondet publike.
 - ✓ Në vitin 2023 kanë ardhur 25 sinjalizime/ankesa/kërkesa.

- ✓ Janë realizuar 13 inspektime financiare publike, në 35 subjekte, nga të cilat 2 kanë iniciuar në fund të vitit 2022 dhe kanë përfunduar në fillim të vitit 2023. Masat respektive për këto dy inspektime janë raportuar në raportin e vitit 2022, ndaj nuk janë përfshirë në treguesit e këtij viti.
 - ✓ Krahasuar me periudhën paraardhëse, kemi rritje të numrit të sinjalizimeve. Konkretisht rezultojnë 21 sinjalizime më shumë.
 - ✓ Në vitin 2023 janë realizuar 13 inspektime financiare publike, në 35 subjekte, nga të cilat 2 misione inspektimi financiar publik kanë iniciuar në fund të vitit 2022 dhe kanë përfunduar në fillim të vitit 2023. Masat respektive për këto dy inspektime janë raportuar në Raportin vjetor të veprimtarisë së Inspektimit për vitin 2022, ndaj nuk janë përfshirë në treguesit e këtij viti.
- Rritje e përgjegjshmërisë së strukturave të përfshira në procesin e inspektimit financiar publik:
 - ✓ Subjektet e inspektuara janë angazhuar me përgjegjshmëri në realizimin e misioneve të inspektimit financiar publik, si dhe në zbatimin e masave të kërkuara nga Ministri i Financave në përfundim të inspektimeve financiare.
 - Treguesi i performancës së Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik për vitin 2023, në masën 88,3 % (nga 100 % të mundshme), vlerësohet “Performancë e lartë”.
 - Nga inspektimet e kryera, në mënyrë të përmbledhur, gjetjet e konstatuara konsistojnë kryesisht në:
 - Moszbatimi i ligjshmërisë në planifikimin, realizimin dhe monitorimin e fondeve publike sipas qëllimit dhe destinacionit të përdorimit respektiv duke shkaktuar dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.
 - Shkelje ligjore dhe parregullsi në fushën e zbatimit të Asistencës Financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimit në fushën "Bujqësia dhe Zhvillimi Rural" (IPARD).
 - Shkelje ligjore dhe parregullsi në zbatimin e Marrëveshjes së Subvencionit “Interrig IPA Cross-border Cooperation Programme “Greece- Albania 2014-2020”/Subsidy Contract No. A4-1.3-6, ndërmjet Autoritetit të Menaxhimit për objektivin “Programit Evropian për Bashkëpunim Territorial, të Ministrisë për Zhvillim dhe Investimet, në cilësinë e Autoritetit Menaxhues të Programit Ndërkufitar të Bashkëpunimit Greqi-Shqipëri, 2014-2020”.
 - Shkelje të procedurave ligjore dhe rregullave të prokurimit publik.
 - Parregullsi dhe moszbatim i kushteve të kontratave të lidhura midis palëve.
 - Shkelje ligjore dhe parregullsi në fushën e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, si dhe keqadministrim i vlerave materiale e monetare, në kundërshtim me rregullat e menaxhimit të aktiveve në njësitë e sektorit publik.

- Shkelje dhe parregullsi në fushën e kontrollit dhe disiplinimit të punimeve të ndërtimit/mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve të ndërtimit. Moszbatim i detyrave funksionale.
- Gjatë vitit 2023 lidhur me funksionimin e strukturës së inspektimit në rolin e shërbimit të koordinimit të anti-mashtrimit (AFCOS) dhe si pikë kontakti e Zyrës Evropiane kundër Mashtrimit (OLAF), janë zhvilluar këto aktivitete:
 - Ka vijuar bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit për dy raste bashkëpunimi me OLAF.
 - Pjesëmarrja në Konferencën vjetore të AFCOS-it, organizuar nga Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF), në Budva (Mal i Zi), me ftesë të OLAF-it, periudha 11-13 Shtator 2023; Në këtë seminar kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga Shqipëria, konkretisht përfaqësues nga AFCOS, Drejtoria Mbështetëse e Zyrtarit Kombëtarë Autorizues, në Ministrinë e Financave, nga Prokuroria e Përgjithshme dhe nga Ministria e Brendshme.
 - Pjesëmarrja në ëorkshop-in Rajonal me temë “Lufta kundër mashtrimit me fondet e BE-së, bashkëpunimi midis OLAF dhe autoriteteve në Ballkanin Perëndimorë”, organizuar nga Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF), në Serbi, periudha 21 dhe 22 Mars 2023; Njësia e inspektimit financiar publik/AFCOS, ka bashkëpunuar rregullisht me Autoritetet Kombëtare të Rrjetit të Raportimit të Shërbimit AFCOS, në varësi të objektit të parregullsisë/çështjes, apo informacionit të kërkuar nga OLAF, konkretisht:
 - AFCOS ka mundësuar për OLAF kontaktin me Përfaqësuesit e Autoriteteve Kombëtare të përfshira në këtë rrjet si dhe institucione të tjera shtetërorë, në funksion të bashkëpunimit operacional, për dy raste hetimi, të kërkuara nga OLAF.
- Zgjerimi i përdoruesve (oficerët e parregullsisë) të strukturave menaxhuese dhe operuese të IPA-s në AFIS portal:
 - Është bërë përditësimi i listës së përdoruesve, të cilët raportojnë në sistemin e raportimit të parregullsisë;
- Lidhur me Hartimin e Strategjisë Kombëtare kundër mashtrimit, me qëllim mbrojtjen e interesave financiare të BE-së.
 - ✓ Në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2024-2026, është parashikuar hartimi i Strategjisë Kombëtare kundër mashtrimit, me qëllim mbrojtjen e interesave financiare të BE-së, në të cilën janë përfshirë strukturat operuese dhe menaxhuese të fondeve të BE-së (IPA & IPARD), si dhe disa institucione/anëtarë të rrjetit të raportimit të shërbimit “AFCOS”.
 - ✓ Ministri i Financave dhe Ekonomisë me Urdhrin nr.127, datë 15.04.2022 “Për ngritjen e Grupit të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare kundër mashtrimit, me

qëllim mbrojtjen e interesave financiare të BE-së”, për periudhën 2025-2027” ka ngritur Grupin e punës, në të cilin janë përfshirë strukturat operuese dhe menaxhuese të fondeve të BE-së (IPA & IPARD), si dhe disa Institucione/anëtarë të Rrjetit të raportimit të shërbimit “AFCOS”.

Plan aktivitetet:

- ✓ Vlerësim për gjendjen aktuale dhe risqet që ekzistojnë në parandalimin e parregullsive apo korrupsionit.
 - ✓ Nevojat, masat, prioritetet dhe objektivat e çdo institucioni për parandalimin dhe eliminimin e parregullsive dhe korrupsionit me fondet e EU-së.
 - ✓ Plani i veprimit dhe indikatorët.
 - ✓ Zbatimi dhe monitorimi i procesit.
-
- Lidhur me aktivitetin: “ Vlerësim për gjendjen aktuale dhe risqet që ekzistojnë në parandalimin e parregullsive apo korrupsionit”, është identifikuar, mbledhur dhe qarkulluar tek antarët për analizim, i gjithë dokumentacionin/legjislacionin relevant vendas dhe atij të BE-së, në funksion të përgatitjes së kësaj Strategjie. Gjithashtu janë përgatitur Termat e referencës për angazhimin e ekspertëve për analizën e riskut dhe draftimin e Strategjisë.
 - Për periudhën raportuese janë zhvilluar takime ndërmjet ekspertëve të huaj, si pjesë e asistencës teknike të Projektit “Good Governance”, si dhe takime me Grupin të Punës për hartimin e kësaj strategjie dhe planin e veprimit, në zbatim të saj.
 - DIFP do të vijojë me koordinimin e asistencës teknike edhe nga OLAF, nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm që ka me këtë strukturë, në funksion të hartimit të Strategjisë Kombëtare kundër mashtrimit.
 - Referuar PKIE 2024-2026, miratimi i kësaj strategjie si dhe plan-veprimi në zbatim të saj, është parashikuar brenda 3 mujorit të parë të vitit 2025. Nga ana e strukturave respektive dhe përfaqësuesve të projektit është dakortësuar që ky dokument strategjik të dërgohet për mendim pranë Këshillit të Ministrave brenda muajit Nëntor 2024.
 - Në zbatim të VKM nr. 84, datë 03.02.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe të shpërbimit të ekspertëve të jashtëm, punonjës të administratës publike apo jashtë saj, të cilët do të angazhohen në kryerjen e inspektimit financiar publik”, gjatë vitit 2023:
 - ✓ Janë angazhuar krahas inspektorëve të DIFP edhe 7 (shtatë) inspektorë financiarë publike, ekspertë të jashtëm, punonjës të administratës publike, në 7 misione inspektimi).
 - Drejtorja e Inspektimit Financiar Publik gjatë vitit 2023 ka funksionuar: Drejtor i Komanduar (periudha Janar-Tetor 2023) dhe Drejtor (periudha Tetor e në vijim), Përgjegjës Sektori, katër inspektorë financiarë publik, me 4 vende vakante.

- Kjo strukturë gjatë vitit raportues ka punuar me përkushtim dhe angazhim maksimal në kryerjen e shqyrtimit, vlerësimit të kërkesave/ankesave si dhe në përmbushjen e misionëve të inspektimit.
- Janë realizuar 3 takime me përfaqësues të Drejtuesve të Auditit të Brendshëm të institucioneve qendrore, gjatë të cilave janë diskutuar mundësitë e bashkëpunimit në kuadër të mekanizmave të bashkëpunimit të përcaktuara në Ligjin nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe mbi raste konkrete të përcjella për inspektim financiar publik.

B. Puna e Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik për vitin 2024 do të fokusohet kryesisht në këto objektiva dhe aktivitete për realizimin e objektivave:

- Përmirësim i kapaciteteve inspektuese dhe profesionale, si dhe rritje e përgjegjshmërisë dhe integritetit të inspektorëve financiarë publikë:

Plan aktivitetet:

- ✓ Plotësimi i organikës së Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik, nëpërmjet plotësimit të vendeve vakante.
- ✓ Përmirësimi i kapaciteteve inspektuese dhe profesionale, si dhe rritje e përgjegjshmërisë dhe integritetit të inspektorëve financiarë publikë, me qëllim garantimin e rritjes cilësore të shërbimit të inspektimit financiar publik. Trajnim i vazhdueshëm i punonjësve të Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik.
- Rritje sasiore dhe cilësore e treguesve të shërbimit të inspektimit financiar publik.

Plan aktivitetet:

- ✓ Rritje e besueshmërisë së Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik nëpërmjet rritjes së zbulueshmërisë së rasteve të keqmenaxhimit financiar dhe korrupsionit.
- ✓ Kryerja e inspektimeve financiare publike, me profesionalizëm e integritet, sipas rregullave të miratuara.
- ✓ Informimi i publikut për zbulimet e inspektimit financiar publik.
- ✓ Tregues të përmirësuar të performancës së Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik
- Shkëmbim informacioni dhe bashkëpunim operacional me OLAF për rastet e kërkuara prej tij.

Plan aktivitetet:

- ✓ Mbas ndryshimeve ligjore respektive do të rishikohet Marrëveshja e Bashkëpunimit lidhur ndërmjet Ministrit të Financave dhe Prokurorisë së Përgjithshme (me kërkesë të kësaj të fundit).

- ✓ Rishikimi i Urdhrit të Ministrit të Financave nr.84, datë 09.12.2015 “Për formimin e Rrjetit të Raportimit të Shërbimit AFCOS”, me qëllim përditësimin e emërtimeve të disa institucioneve të përfshira në këtë rrjet dhe përfshirja e institucioneve të reja, sikurse kërkuar nga OLAF, e në vijim, iishikimi i Marreveshjeve të bashkëpunimit të lidhur ndërmjet Ministrit të Financave dhe Drejtuesve të institucioneve, anëtarë të rrjetit AFCOS, në kuadër të ndryshimeve të kuadrit ligjorë për organizimin dhe funksionimin e tyre.
- Hartimi i Strategjisë Antikorrupsion për mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit Evropian:
Plan aktivitetet:
 - ✓ Vlerësim për gjendjen aktuale dhe risqet që ekzistojnë në parandalimin e parregullive apo korrupsionit.
 - ✓ Nevojat, masat, prioritetet dhe objektivat e çdo institucioni për parandalimin dhe eliminimin e parregullive dhe korrupsionit me fondet e BE-së.
 - ✓ Plani i veprimit dhe indikatorët.
 - ✓ Zbatimi dhe monitorimi i procesit.
- Mbrojtja e Interesave Financiare të Bashkimit Evropian dhe vijimi i procesit të shtimit të përdoruesve në sistemin AFIS portal, me punonjës parregullish të strukturave menaxhuese të fondeve IPA.
Plan aktivitetet:
 - ✓ Për oficerët e përcaktuar të parregullive të strukturave IPA dhe IPARD, do të vijojë bashkëpunimi me OLAF për hapjen e aksesit në AFIS Portal (në referencë të kërkesave të bëra nga strukturat respektive).

3. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

3.1. Baza ligjore dhe nënligjore e veprimtarisë së inspektimit financiar publik:

- Veprimtaria e inspektimit financiar publik bazohet në Ligjin nr.112/2015 “Për inspektimin financiar publik”, si dhe në akte të tjera të miratuara në zbatim të këtij ligji, përkatësisht:
 - VKM nr. 84, datë 03.02.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe të shpërbimit të ekspertëve të jashtëm, punonjës të administratës publike apo jashtë saj, të cilët do të angazhohen në kryerjen e inspektimit financiar publik”.
 - Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.29, datë 27.11.2015 “Për kriteret për fillimin e Inspektimit Financiar Publik”,
 - Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.30, datë 27.11.2015 “Për rregullat dhe procedurat e kryerjes së inspektimit financiar publik”.

- Kodin e Etikës për inspektorët financiarë publikë, miratuar nga Ministri i Financave me urdhër nr.85, datë 09.12.2015.
- Manualin për Inspektimin Financiar Publik, miratuar nga Ministri i Financave me Urdhër nr. 26, datë 17.02.2016.

Për periudhën raportuese Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik ka ushtruar funksionin e saj bazuar në ligjin nr.112/2015 “Për inspektimin financiar publik”, si dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij. Realizimi i objektivave të DIFP-së, në tregues sasiorë dhe cilësorë rezulton, për sa vijon:

- Veprimtaria e Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik për periudhën raportuese, viti 2023, referuar realizimit të objektivave, rezulton sa vijon:
 - Rritje e kapaciteteve profesionale dhe inspektuese të inspektorëve financiarë publikë, në shqyrtimin dhe vlerësimin me profesionalizëm të kërkesave, informacioneve apo ankesave të ardhura për inspektim financiar publik, si dhe përmbushje të misioneve të inspektimeve financiare publike, sipas kriterëve ligjore dhe rregullave të miratuara, që vlerësohet me “Performancë të Lartë”, nëpërmjet:
 - ✓ Rritjes së besueshmërisë ndaj strukturës përgjegjëse/Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik, nga subjektet dhe individët që denoncojnë raste të mashtrimeve dhe të korrupsionit me fondet publike.
 - ✓ Kryerja e inspektimeve financiare publike, me profesionalizëm e integritet, sipas rregullave të miratuara.
 - ✓ Informimi i publikut për zbulimet e inspektimit financiar publik. Publikimi i informacionit të përditësuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi rezultatet e inspektimit.
 - ✓ Gjatë vitit 2023:
 - Kanë ardhur 25 sinjalizime për inspektim financiar publik, si dhe janë realizuar 13 inspektime financiare publike në 35 subjekte inspektimi.
 - Janë realizuar 13 inspektime financiare publike, në 35 subjekte, nga të cilat 2 kanë iniciuar në fund të vitit 2022 dhe kanë përfunduar në fillim të vitit 2023. Masat respektive për këto dy inspektime janë raportuar në raportin e vitit 2022, ndaj nuk janë përfshirë në treguesit e këtij viti.
 - ✓ Gjatë vitit 2023, janë kërkuar: masa shpërblim dëmi nga subjektet/personat shkaktarë në vlerën totale për rreth 48,435,006 lekë, 14 masa administrative, 76 masa disiplinore dhe 97 masa rregullative.

3.2.Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik

- Në zbatim të ligjit nr. 112/2015 “Për inspektimin financiar publik”, ndër funksionet ligjore më kryesore që ka realizuar Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik janë:

- Shqyrtimi i kërkesave, informacioneve apo ankesave dhe dhënia e mendimin tek Nëpunësi i Parë Autorizues për fillimin ose jo të inspektimit financiar publik apo të inspektimit paraprak.
- Kryerja e inspektimeve financiare publike, me punonjës të kësaj drejtorie, si dhe në rastet e mungesës së burimeve njerëzore, si dhe mbulimit të fushave specifike të inspektimit financiar publik, me angazhim të ekspertëve të jashtëm, punonjës të administratës publike, që përzgjidhen dhe shpërblehen sipas kritereve të miratuara.
- Monitorimin e zbatimit të masave të kërkuara nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë në përfundim të inspektimit financiar publik, si dhe informimin e Nëpunësit të Parë Autorizues për zbatueshmërinë e tyre.
- Rolin e AFCOS-it dhe shërbimin si pikë kontakti e OLAF-it.

3.3.Subjektet e inspektimit financiar publik:

- Bazuar në ligjin e inspektimit financiar publik, subjekte të inspektimeve financiare publike janë:
 - a) njësitë e qeverisjes së përgjithshme;
 - b) shoqëritë shtetërore, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta që zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme, ose në të cilën një njësi e qeverisjes së përgjithshme zotëron apo kontrollon një pjesë të aksioneve, e cila i jep të drejtën e kontrollit;
 - c) çdo person fizik apo juridik, vetëm për fondet që përfiton nga Buxheti i Shtetit, Bashkimi Evropian apo fondet në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare, ku përfitues është shteti shqiptar.
- Bazuar në ligjin e inspektimit financiar publik, subjekte të inspektimeve financiare publike janë:
 - d) njësitë e qeverisjes së përgjithshme;
 - e) shoqëritë shtetërore, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta që zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme, ose në të cilën një njësi e qeverisjes së përgjithshme zotëron apo kontrollon një pjesë të aksioneve, e cila i jep të drejtën e kontrollit;
 - f) çdo person fizik apo juridik, vetëm për fondet që përfiton nga Buxheti i Shtetit, Bashkimi Evropian apo fondet në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare, ku përfitues është shteti shqiptar.

Në subjektet e inspektuara gjatë vitit 2023, 16 prej tyre janë subjekte publike, 2 shoqëri aksionere me kapital shtetëror dhe 17 subjekte Persona juridik/fizik.

Subjektet e inspektuara janë angazhuar me përgjegjshmëri në realizimin e misioneve të inspektimit financiar publik, në zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve ligjore të tyre, si dhe

në zbatimin e masave të kërkuara nga Ministri i Financave në përfundim të inspektimeve financiare, ndonëse rezultojnë edhe raste me vonesa në konfirmimin e zbatimit të tyre.

3.4. Organizimi i Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik:

Gjatë vitit 2023, Drejtorja e Inspektimit Financiar Publik ka funksionuar:

Drejtor i Komanduar (periudha Janar-Tetor 2023) dhe Drejtor i emëruar (periudha Tetor e vijim), 1 Përgjegjës sektori, 4 (katër) specialistë dhe 4 (katër) vende vakante.

Kjo situatë ka krijuar vështirësi në kapacitetet inspektuese për këtë strukturë, e cila ka punuar tepër e sforcuar gjatë vitit raportues, por me përkushtim dhe angazhim maksimal në kryerjen e shqyrtimit, vlerësimin të kërkesave/ankesave si dhe në përmbushjen e misioneve të inspektimit.

- Gjatë periudhës raportuese, për realizimin e 7 inspektimeve, janë angazhuar krahas inspektorëve të DIFP edhe 7 inspektorë financiar publik, ekspertë të jashtëm, punonjës të administratës publike, me profesionet inxhinier, jurist, si dhe financier.

Gjatë punës inspektuese të inspektorëve financiar publik, ekspert të jashtëm, punonjës të administratës publike, janë vërejtur disa probleme:

- Në disa raste ka mungesë gadishmërie nga ekspertët e jashtëm, punonjës të administratës publike, për angazhimet në inspektimet financiare publike, për shkak të angazhimeve të tyre, të konfirmuara zyrtarisht nga drejtuesit.
- Ndër ekspertët e përzgjedhur në disa profesione të fushës së inxhinierisë, IT-së, etj. ka mangësi apo numër të kufizuar inspektorësh.
- Këto probleme kërkojnë vëmendjen e duhur dhe marrjen e masave nga DIFP dhe autoritetet ligjore në fushën e inspektimit financiar publik, për sa vijon:
 - ✓ Në raste të refuzimit/mungesës së gatishmërisë të ekspertëve të jashtëm, punonjës të administratës publike, për angazhimin e tyre në misionin inspektim, rast pas rasti, referuar justifikimeve/arsyetimeve të paraqitura, për mos përmbushje të këtij detyrimi, DIFP do t'i propozojë Nëpunësit të Parë Autorizues për marrjen e masave për drejtuesit konkret që pengojnë angazhimin e tyre, bazuar në pikën 10 VKM nr. 84, datë 03.02.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe të shpërblimit të ekspertëve të jashtëm, punonjës të administratës publike apo jashtë saj, të cilët do të angazhohen në kryerjen e inspektimit financiar publik”.
 - ✓ DIFP duhet të propozojë për miratim tek Ministri i Financave dhe Ekonomisë për përzgjedhje të reja të inspektorëve financiarë publikë, në fushat specifike të munguara, bazuar në kriteret dhe rregullat e përcaktuara në VKM nr.84, datë 03.02.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe të shpërblimit të ekspertëve të jashtëm, punonjës të administratës publike apo jashtë saj, të cilët do të angazhohen në kryerjen e inspektimit financiar publik”.

3.5. Vlerësimi i performancës së Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik:

- Vlerësimi i performancës së përgjithshme të Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik është kryer mbi bazën e metodologjisë dhe të indikatorëve të përcaktuar në Manualin e inspektimit financiar publik.

Performanca e veprimtarisë së Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik edhe për vitin 2023, duke u bazuar në 7 indikatorët e vlerësimit të performancës (0-100%) vlerësohet “Performancë e lartë”. Treguesi i performancës llogaritet në 88,3% nga 100% të mundshme.

Vlerësimi i kryer për performancën e Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik, në përqindje për secilin nga 7 indikatorët, rezulton sa vijon:

1. Raporti i cilësisë së sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.....100%.
2. Shqyrtimi i ankesave/kërkesave/informacioneve të marra për inspektim financiar Publik..... 100%.
3. Numri i inspektimeve të kryera në raport me vendimet e marra nga NPA..... 100%.
4. Numri i inspektimeve të kryera..... 52%.
5. Niveli i zbulimit në raport me inspektimet e kryera..... 66%.
6. Vlerësimi i procedurave për përmbushjen e detyrimeve ligjore të inspektorëve financiar publik dhe cilësinë e rekomandimeve për çdo inspektim të kryer 100%.
7. Numri i aktiviteteve të AFCOS..... 100%.

Paraqitje grafike:



4. AKTIVITETET E INSPEKTIMIT FINANCIAR PUBLIK

4.1. Veprimtaria e Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik

4.1.1. Shqyrtimi i kërkesave/informacioneve/ankesave të ardhura për inspektim financiar publik dhe vendimarrjet e Nëpunësit të Parë Autorizues si dhe Zyrtarit Kombëtar Autorizues.

- Për vitin 2023 kanë ardhur gjithsej 25 sinjalizime (kërkesa/informacione/ankesa), përkatësisht të grupuara sipas subjekteve kërkuese:
 - ✓ Nga strukturat e auditimit të brendshëm të subjekteve publike dhe KLSH, 3 informacione/kërkesa;
 - ✓ Nga subjekte publike, 3 informacione/kërkesa
 - ✓ Zyrtari Kombëtar Autorizues, 1 kërkesë;
 - ✓ Nga platforma e Bashkëqeverisjes, 1 ankesë/kërkesë;
 - ✓ Nga shoqata/individë të ndryshëm 17 ankesa/kërkesa.
- Pas shqyrtimit të 25 sinjalizimeve të adresuara, Sekretari i Përgjithshëm, në cilësinë e Nëpunësit të Parë Autorizues (NPA) dhe Zëvendës-Ministri i Financave, në cilësinë e Zyrtarit Kombëtarë Autorizues (ZKA), për fondet e Bashkimit Evropian, ka marrë vendimet përkatëse:
 - Mos konsideruar 15 ankesa/kërkesa/informacione, për mos përmbushje të kriterëve ligjore për fillimin e inspektimit financiar publik.
 - Fillimin e inspektimit financiar publik për 10 sinjalizime/ kërkesa/ankesa, konkretisht:
 - 6 (gjashtë) sinjalizime/ankesa të përcjella nga ana e individëve/anonim,
 - 2 (dy) sinjalizime/kërkesa/ankesa të përcjella nga KLSH,
 - 1(një) sinjalizim/ankesë e përcjellë nga ana e Njësisë së Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit,
 - 1 (një) kërkesë për fillim inspektimi financiar publik, nga Zyrtari Kombëtar Autorizues, për parregullsi në zbatimin e një kontrate të financuar nga fondet IPARD II, në kuadër të Programit IPA II.
- Pas shqyrtimeve të sinjalizimeve, DIFP ka paraqitur mendimet tek Nëpunësi i Parë Autorizues (NPA) dhe tek Zëvendës-Ministri i Financave, në cilësinë e Zyrtarit Kombëtarë Autorizues (ZKA), bazuar në kriteret e miratuara. Vendimarrjet e NPA-së dhe ZKA-së, janë në përputhje me mendimet paraqitura nga DIFP.
- Vendimarrjet nga NPA-së dhe ZKA-së, në cilësinë e autoriteteve ligjore respektive, paraqiten në pasqyrën përmbledhëse dhe paraqitjen grafike, për sa vijon:

Nr.	Emërtimi	Realizuar (Numër)
-----	----------	-------------------

1	Kërkesa/informacione/ankesa të ardhura në total gjatë vitit 2023	25
2	Nga totali, kërkesa/informacione/ankesa të shqyrtuara gjatë vitit 2023. Pas shqyrtimit është vendosur:	25
2.1	Nuk plotësojnë kriteret ligjore për të filluar inspektim financiar	15
2.2	Plotësojnë kriteret ligjore për të filluar inspektim financiar	10
a.	Për dy prej tyre vendimmarrja për fillimin e inspektimit është bërë në fillim të vitit 2024.	2
b.	Vendime për fillimin e inspektimit financiar publik	8
3	Vendime për fillimin e inspektimit financiar (3 vendime për inspektime i referohen sinjalizimeve të ardhura gjatë fund vitit 2022)	11

- Nga shqyrtimi i kërkesave/informacioneve/ankesave të ardhura, referuar burimeve të tyre, rezultojnë problematikat sa vijon:
 - ✓ Për informacionet e ardhura nga strukturat e auditimit të brendshëm, problematik mbetet fakti se kërkesat për inspektim financiar nuk evidentojnë specifikisht dyshimet për keqmenaxhim financiar, mashtrim, korrupsion, vepër penale, etj, por përmbajnë tërësisht përfundimet e auditimit të brendshëm me gjetjet/zbulimet, personat përgjegjës dhe rekomandimet/plan veprimet për subjektet e audituara dhe nuk shoqërohen me dokumentacion justifikues.
 - ✓ Ankesat/kërkesat për inspektim financiar nuk evidentojnë specifikisht dyshimet për keqmenaxhim financiar, mashtrime, korrupsion, vepër penale, etj, si dhe nuk shoqërohen me dokumentacion justifikues.

4.1.2. Realizimi i aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë Antikorrupsion si dhe të Menaxhimit të Financave Publike (PFM 2014-2022):

- U vijua me raportimin lidhur me aktivitet e përfshira në PFM 2023 si dhe për nen aktivitet që do të ndërmerren gjatë vitit 2024 për realizimin e mëtejshëm të këtyre objektivave.
 - ✓ Realizuar 3 takime me përfaqësues të DAB-ve, të Ministrisë së Kulturës; përfaqësues të DAB të Bashkisë Korçë, DAP të Ministrisë së Brendshme, respektivisht në muajt Shkurt, Mars dhe Maj.
 - ✓ Publikuar informacion i përditësuar, mbi inspektimet e kryera, në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë/Ministrisë së Financave.

4.2. Subjektet e inspektuara, gjetjet, masat e kërkuara dhe zbatimi i tyre.

Janë kryer 13 inspektime financiare publike, në 35 subjekte të inspektuara, të paraqitura në mënyrë analitike në regjistrin e realizimit të inspektimeve, bashkëlidhur “ANEKSET”.

Konkretisht subjektet e inspektuara renditen sa më poshtë:


1. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural /AZHBR;
2. Operatori ekonomik "XX" P.F, Përfitues;
3. Operatori ekonomik “XX”, P.F/ Përfitues;
4. Operatori ekonomik “XXX”, shpk Përfitues;
5. Operatori ekonomik “XXX 2018”, shpk, Përfitues;
6. Operatori ekonomik “XX”, P.F, Përfitues;
7. Ministria e Kulturës;
8. IEPV Lushnje;
9. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;
10. OE: XX shpk;
11. Bashkia Finiq;
12. Shoqëria XX;
13. Shoqëria Studio private projektimi, studimi XX;
14. Bashkia Korçë;
15. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Gjellbërimit Korçë (NSHPGJ Korçë), në cilësinë e Autoritetit Kontraktor;
16. Shoqëria “XX” shpk;
17. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR)
18. Operatori Ekonomik (XX) shpk;
19. Shoqëria “XX” shpk;
20. Ing.XX, Sarandë, Mbikqyrësi i punimeve;
21. Kolaudatori/Grup kolaudimi/Shoqëri kolaudimi, për investimin objekt inspektimi;
22. Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike;
23. Shoqëria aksionare “Porti Detar” Sarandë;
24. Shoqëria aksionare “Duhan Cigare” Shkodër;
25. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
26. Departamenti i Kufirit dhe Migracionit;
27. Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin, Korçë;
28. Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin, Gjirokastrë;
29. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
30. Dega e Thesarit, Tiranë;
31. Bashkia Devoll;
32. Studio e Projektimit “XX” shpk;
33. Shoqëria “XX” shpk;
34. Shoqëria XX” shpk;

35. Shoqëria “XX” shpk.

Treguesit e përmbledhur të rezultateve të inspektimeve financiare publike, gjetjet dhe masat e kërkuara për vitin 2023, të krahasuara edhe me vitin 2022, paraqiten në tabelën në vijim:

Periudhat raportuese	Sinjalizime të ardhura (numër)	Inspektime të kryera (numër)	Subjekte të inspektuara (numër)	Efek financiar negative i krijuar (në lekë)	Masa shpërblim dëmi (në lekë)	Masa administrative (numër)	Masa disiplinore	Masa rregulluese (numër)	Kallzim penal (numër)
Viti 2022	4	7	21	208,746,491	51,722,281	5	48	56	1
Viti 2023	25	13	35	136,892,471	48,435,006	14	76	97	0
2023/2022	21	6	14	-71,854,020	-3,287,275	9	28	41	-1

Paraqitje grafike:



4.2.1. Gjetjet dhe vlerësimi i fakteve nga inspektimet e kryera, masat e kërkuara dhe zbatimi i tyre nga subjektet e inspektuara

Nga 13 inspektime të kryera në 35 subjekte, gjetjet e adresuara sipas subjekteve të inspektuara, masat e kërkuara dhe zbatimi i tyre, konsistojnë në mënyrë të përmbledhur për sa vijon:

1. Në subjektet: Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) dhe Operatori ekonomik përfitues “XX”, P.F., Përfitues.

2. Në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) dhe Operatorin ekonomik “XX”, P.F, Përfitues.

Këto dy inspektime kanë iniciuar në fund të vitit 2022 dhe kanë përfunduar në fillim të vitit 2023 dhe për masat respektive është raportuar në Raportin vjetor të vitit 2022.

3. Në zbatim të Vendimit të Nëpunësit të Parë Autorizues nr.1, datë 20.01.2023 “Për fillimin e inspektimit financiar publik” (protokolluar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr.1172 Prot, datë 20.01.2023), i ndryshuar, me objekt “Zbatimi i ligjshmërisë lidhur me përdorimin e fondeve publike nga ana e institucionit të AZHBR-së, në kuadër të instrumentit të BE-së për Ndihmën e Para-Anëtarësimit për Zhvillimin Rural (IPARD II) 2014-2020, u krye inspektim financiar publik, në subjektet: Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural/AZHBR dhe Operatori Ekonomik “xxx” shpk, Përfitues, nga ku u konstatua:

Më datë 15.01.2020 është lidhur Kontrata e grantit nr.91/3 Prot, ndërmjet palëve kontraktuese: i) Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, AZHBR (më poshtë referuar si: AZHBR), si palë që jep mbështetjen, përfaqësuar nga Titullari i Institucionit dhe në Operatorin Ekonomik Përfituesit “xxx” shpk, si palë që përfiton fondet.

Objekti i kontratës “Ndërtim stalle për mbarështim viçash, pajisje dhe makineri”, në bazë të Lejes së Ndërtimi nr. 7, datë 06.05.2019 “Për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m², lëshuar nga Bashkia Patos, (protokolluar në Bashkinë Patos nr.11/7 Prot, datë 06.05.2019), me zhvillues subjekti “xxx” shpk, Ndërtues “xxx shpk, përfaqësuar nga Z.xx, dokumentohet të ketë filluar më datë 17.01.2020; Sipërfaqja e tokës së zhvillimit 7000 m², ndërsa sipërfaqja e nga struktura për 840 m² sipërfaqe ndërtimi për 840 m².

- Leja e ndërtimit është dhënë për zhvilluesin “xxx” shpk, për objektin: Stallë për rritje viçash”, për pasurinë me nr. pasurie 16/8, Vol 3, fq 66, ZK nr. 3361. Leja e ndërtimit rezulton të jetë e vlefshme për një periudhë 12 muaj nga data e fillimit të punimeve, referuar grafikut të punimeve.
- Punimet e ndërtimit të godinës 1 kat me sipërfaqe 840 m² konsistojnë në: Punime dheu, Punime shtresash, Punime tavani e suvatime, Punime suvatimi dhe veshje me pllaka, Punime dyer dhe dritare, Punime bojatisje, Punime betoni dhe beton arme (b/a), Punime hekuri dhe betoni, Punime muraturë tulle, Punime hidrosanitare, Punime kanalizimi, Punime elektrike, Punime MNZ, Punime për sistemime te jashtme.
- Punimet për ndërtimin e objektit kanë përfunduar para afatit, sikurse të përcaktuar në kontratën, sa më lart cituar dhe konkretisht më datë 01.07.2020.
- Nga ana e strukturave përgjegjëse të AZHBR-së, dhe konkretisht nga ana e Drejtorisë së Pranimit dhe Aprovimit të Projekteve (DPAP), si dhe nga ana e Komisionit të Vlerësimit (EVC), gjatë konkludimit të vlerës së shpenzimeve të pranueshme, si dhe përcaktimit të

ofertës për çmime të arsyeshme/ofertë fituese, rezulton në vlerën prej 374 244.78 lekë, pa Tvsh, vlerë e cila përfaqëson diferencë në sasi dhe çmim për 5 (pesë) zëra punimesh 6 (gjashtë) nën-zëra punimesh) pjesë e shpenzimeve të pranueshme.

- Totali i investimit në kohën respektive të konkludimit të vlerës së shpenzimeve të pranueshme, si dhe përcaktimit të ofertës për çmime të arsyeshme/ofertë fituese, duhet të ishte në vlerën 48 797 935.22 lekë, pa tvsh (49 172 180 lekë -374 244.78 lekë).
- Vlera prej 243 259.11 lekë, vlerësohet përfitim i padrejtë nga ana e Subjektit përfitues “xxx” shpk, e cila përfaqëson 65% të totalit të shpenzimeve të pranueshme të Investimit/kontributi i përgjithshëm publik (374 244.78*65 %).
- Komisioni i Vlerësimit (EVC), nuk ka përmbushur kërkesat e Aneksit II, pika 1/paragrafi i fundit i kësaj pike (lidhur me vlerësimin dhe përcaktimin e arsyeshmërisë së koston/çmimit për aplikimin ID 01/1/2/05/0310 (nga marrja e kërkesës të DPAP nr.91/19 Prot, datë 22.06.2020 “Kërkesë për përcaktimin e çmimit të arsyeshëm”, deri me hartimin dhe dorëzimin e Raportit përfundimtar të EVC nr.656/11 Prot, datë 31.12.2020).

❖ Lidhur me Amendimet e Kontratës së Grantit:

- Më datë 30.07.2020 është nënshkruar amendimi i Kontratës së grantit Nr. 01/1/2/05/0310 (numër identifikimi), protokolluar pranë AZHBR-së nr.91/23 Prot, datë 30.07.2020, ndërmjet palëve kontraktuese: i) Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, AZHBR, si palë që jep mbështetjen, përfaqësuar nga Titullari i Institucionit; si dhe; ii) Përfituesit të grantit/”xxx” shpk, përfaqësuar nga Z. xx. si palë që përfiton fondet, e cila ndër të tjera ka reflektuar:
 - Totali i shpenzimeve të pranueshme: 49 172 180 lekë;
 - Kontributi i përgjithshëm publik në shumën 31 961 917 lekë (në masën 65 % të totalit të shpenzimeve të pranueshme të investimit), aprovuar me njoftimin nr.91/22, datë 23.07.2020. Kontributi i përgjithshëm publik, përbëhet nga: i) shuma në vlerën prej 7 990 479 lekë, e cila përfaqëson Financim kombëtar, në masën prej 25 % të shumës së kontributit të përgjithshëm publik të aprovuar, si dhe; ii) shuma në vlerën prej 23 971 438 lekë, e cila përfaqëson financim/kontribut të BE-së në masën 75 %, të shumës së kontributit të përgjithshëm publik të aprovuar.
 - Referuar nenit 2 “Shuma e kontraktuar”, të Amendimit të kontratës bazë nr.91/23, datë 30.07.2020, rezulton se: “Shuma në vlerën prej 3 196 192 lekë, përfaqëson para financimin për përfituesin në masën 10 % të shpenzimeve të pranueshme, të aprovuara/miratuara nga AZHBR, e cila përbëhet nga: i) shuma në vlerën prej 799 048 lekë, e cila përfaqëson Financim kombëtar, në masën prej 25 % të shumës së parafinancimit të aprovuar; ii) shuma në vlerën prej 2 397 144 lekë, e cila përfaqëson financim/kontribut të BE-së, në masën 75 % të shumës së para financimit të aprovuar, si dhe; iii) neni 4, pika 1, ndryshon:... para financimi do të përbëhet nga: i) shuma në vlerën prej 2 397 144 (75% kontribut BE), si dhe; ii) shuma në vlerën prej 799 048 lekë (25% kontribut kombëtar)”.

- ❖ Lidhur me fazat e ndjekura nga ana e AZHBR-së, si dhe nga ana e Aplikantit, e për më tej, Përfitues i Grantit (aplikimi; kontrolli dhe pranueshmëria e aplikimit, procedura e kontrollit, si dhe Autorizimi dhe Ekzekutimi i pagesave respektive):
 - Drejtoria e Pranimit dhe Aprovimit të Projekteve:
 - Formulari i aplikimit datë 30.01.2019, me numër Identifikimi: ID 01/1/2/05/0310 (protokolluar në AZHBR nr.656 Prot, datë 30.01.2019); (Versioni 1.4 2019), rezulton të jetë përcjellë dorazi nga ana e Aplikantit pranë AZHBR-së, për masën/Masa 1: “Investime në asete fizike në ferma bujqësore”.
 - Në referencë të thirrjes datë 15 Janar 2019 “Për dorëzim të Aplikimeve”, publikuar në faqen e internetit të AZHBR-së, rezulton se, aplikimi sa më lart, është dorëzuar në zarf të mbyllur me Titullin e thirrjes për dorëzim të aplikimit respektiv; Zarfi mban emrin e plotë, adresën, si dhe mban shënimin “të mos hapet para dorëzimit”.
 - Nga ana e Aplikantit, rezulton të jetë dorëzuar aplikimi pranë AZHBR-së, brenda afatit të përfundimit për dorëzimin e aplikimit, afatit të përcaktuar për këtë thirrje, sa më lart cituar.
 - Dokumentohet që, nga ana e DPAP-së, më datë 25.09.2019, të jetë kërkuar dokumentacion shtesë/Njoftim për dokumentacion shtesë, drejtuar subjektit aplikues “xxx” shpk.
 - Në zbatim të pikës 5.2.1 të Manualit të Procedurës të Drejtorisë së Kontrollit, rezulton se, nga ana e Drejtorisë së Kontrollit të jetë kryer, kontroll në vend/verifikim në terren, në referencë të kërkesës së bërë nga Drejtoria e Pranimit dhe Aprovimit të Projekteve (shkresa nr.656/9 Prot, datë 05.11.2019 “Kërkesë për kryerjen e kontrollit në vend).
 - Nga ana e strukturës përgjegjëse të AZHBR-së, Drejtoria e Kontrollit, rezulton të jetë kryer “kontroll në vend/verifikim në terren”, para kontraktimit të aplikimit me numër 01/1/2/05/0310 në referencë të kërkesës së bërë nga DAP (shkresa nr.656/9 Prot, datë 05.11.2019 “Kërkesë për kryerjen e kontrollit në vend”), si dhe dokumentohet që me shkresën nr. 656/10 Prot, datë 21.11.2019, Drejtoria e Kontrollit të ketë përcjellë pranë DPAP-së dosjen e aplikimit dhe setin e dokumentacionit të përgatitur nga kontrolli në vend për përfituesin “xxx” shpk.
 - Nuk rezulton të jetë kërkuar kontroll shtesë, përpara lidhjes së kontratës, nga ana e Drejtoria e Pranimit dhe Aprovimit të Projekteve.
 - Institucioni i AZHBR-së/DPAP me shkresën nr.91/2 Prot, datë 14.01.2020 “Njoftim me shkrim për aprovimin e aplikimit dhe nënshkrimin e kontratës” drejtuar Aplikantit “xxx” shpk, ka njoftuar aplikantin se: “Aplikimi është aprovuar”.
 - Dokumentohet që, më datën 15.01.2020, ndërmjet AZHBR-së, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor për Fondet e Programit IPARD II, 2014-2020 dhe Përfituesit të Fondeve nga ky program/“xxx” shpk, të jetë lidhur kontrata protokolluar në AZHBR me nr. 91/3 Prot, datë 15.01.2020.

- Struktura e Drejtorisë së Kontrollit:
- Nga ana e SKI/DK, dokumentohen të jenë kryer 6 kontrole në terren, kontrole këto të ushtruara pranë Subjektit “xxx”, lidhur me investimin “Ndërtim stalle për rrije vicash”, me numër identifikimi ID 01/1/2/05/0310, Masa 1 “Investime në asetet fizike në fermat bujqësore”, respektivisht:
 - 1 (një) verifikim/kontroll në vend/terren, para miratimit të lidhjes së Kontratës së Grantit,
 - 4 (katër) verifikime/kontrole shtesë në vend/terren, pas lidhjes së Kontratës së Grantit;
 - 1 (një) verifikim/kontroll në vend/terren, para autorizimit për pagesë në masën 90 % të vlerës së Kontratës së Grantit.
- Mbi verifikimet e kryera në vend/terren mbas nënshkrimit të Kontratës së Grantit nga palët respektive:
 - Nga ana e Drejtorisë së Kontrollit, rezulton të jenë kryer 4 (tetë) kontrole shtesë për punime të fshehura/maskuara për periudhën e parashikuar të punimeve, sipas Raport Progresit të paraqitur nga aplikanti, referuar Programeve të punës: i) nr.840 Prot, datë 18.02.2020;ii) nr.1058, datë 10.03.2020, iii) nr.1155, datë 30.03.2020, si dhe; iv) nr.1220, datë 14.04.2020, sipas urdhrave të Drejtuesit të Drejtorisë së Kontrollit “Për verifikimin në vend”, respektivisht:i) nr.247, datë18.02.2020, ii) nr.273, datë 10.03.2020, iii) nr.286, datë 30.03.2020, si dhe; iv) nr.293, datë 14.04.2020 (në referencë të kërkesës së bërë nga DAP shkresa nr.91/5 Prot, datë 16.01.2020 “Kërkesë për kryerjen e kontrollit në vend”), si dhe me shkresat :i) nr. 91/14 Prot, datë 09.03.2020, ii) nr. 91/15 Prot, datë 27.03.2020, iii) nr.91/16 Prot, datë 23.04.2020, si dhe; iv)nr.91/17 Prot, datë 27.04.2020 “Dorëzim dosje dhe seti dokumentacioni të përgatitur nga VNV”, ka përcjellë pranë DPAP-së Raportin e verifikimit në vend/Terren; Listën për verifikimin në vend, si dhe setin respektiv të dokumentacionit.
 - Nga ana Drejtorisë së Kontrollit, rezulton të jetë urdhëruar verifikimi në vend i dosjes (në referencë të pikës 5.2.2 “Procedura për verifikimin në vend pas kërkesës për pagesë), pas kërkesës për pagesë, bërë nga ana e Përfituesit, dhe të të gjithë formularëve që kanë të bëjnë me investimin, në referencë të Urdhrit nr.363 datë 20.10.2020 “Për realizimin e kontrollit në vend”, Formulari E-5.1-1.2, si dhe me shkresën nr.337/1 Prot, datë 04.11.2020, Drejtorja e Kontrollit ka përcjellë pranë DAP dosjen e aplikimit dhe setin respektiv të dokumentacionit.
 - Nga kontrolli i ushtruar/verifikimi ne terren, kanë rezultuar, diferenca në sasi, për 62 zëra e nen zëra punimesh/ (+/-), përcjellë pranë Drejtorisë së Pranimiit dhe Aprovimit të Projekteve
 - Në përfundim të kontrollit administrativ të dokumentacionit të kryer nga ana e DAP-së dhe të kontrollit në vend/terren të kryer nga ana e Drejtorisë së Kontrollit, kanë rezultuar diferenca në vlerën totale prej 7 096 324.28 lekë, vlerë e cila përfaqëson diferenca në Komponentin “Pajisje makineri bujqësore dhe punime ndërtimi”, për 21 zëra /të pakryera, e për rrjedhojë vlera 4 612 610. 78 lekë (7 096 324.28 * 65 %= 4 612 610. 78),

e cila përfaqëson kontributin e përgjithshëm publik, rezulton të mos jetë ekzekutuar, në autorizimin respektiv të pagesës së bërë nga ana e Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave.

- Struktura e Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave (DAP), si dhe Drejtoria e Ekzekutimit të Pagesave (DEP):
 - Mbi autorizimin dhe ekzekutimin e parapagesës, në masën 10 % të kontratës së grantit:
 - Nga ana e Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave, me shkresën nr.91/10 Prot, datë 11.02.2020 “Njoftim mbi shumën e autorizuar, Parapagesë 10 %”, nënshkruar nga ana e Titullarit të AZHBR-së, është njoftuar Përfituesi “xxx” shpk se: “Shuma e autorizuar për Kontratën e Grantit nr.91/3 Prot, datë 15.01.2020, është në vlerën prej 3 313 363.64 lekë, nga e cila: i) 75 % financohet nga Kontributi i Bashkimit Evropian, në vlerën prej 2 485 022.73 lekë, si dhe; ii) 25 % financohen nga Kontributi Kombëtar në vlerën prej 828 340.91 lekë”.
 - Nga ana e Përfituesit dokumentohet “Çertifikatë garancie pagesë paradhënie” nr.16/FRSG1/057259, datë 29.01.2020, lëshuar nga Kompania/Shoqëria e sigurimeve “S” sh.a, në cilësinë e garantuesit të pagesës së paradhënies në vlerën prej 3 644 700 lekë, ose në masën 110 % të vlerës së parafinancuar, si dhe me afat të vlefshmërisë të garancisë së paradhënies që përkon nga data 29.01.2020 deri datë 30.06.2021 (datë që përkon me dorëzimin nga përfituesi/kontraktuesi të situacioneve, me vlerën e kësaj pagese paradhënie), referuar Kontratës së Grantit nr.91/3, datë 15.10.2020, neni 4 “Detyrimet e Përfituesit”, pika 1 “Pagesa paraprake e përfituesit”.
 - AZHBR, me shkresën nr. 91/11 Prot, datë 11.02.2020 “Njoftim për parapagesë”, mbas kontrollit për plotësinë dhe përputhshmërinë për parapagesën deri në masën 10 % të ndihmës publike, ka bërë me dije Përfituesin “xxx” shpk, mbi shumën e autorizuar, Parapagesës 10%, në vlerën prej 3 313 363.64 lekë, vlerë e cila, do të transferohet në llogarinë e dokumentuar të Tij”.
 - Dokumentohet që, nëpërmjet operatorit bankar ...me urdhër transfertën e datës 05.03.2020 të jetë kryer parapagesa në masën 10% të ndihmës publike, në vlerën prej 3 313 363.64 lekë, referuar Kontratës së grantit nr.91/3, datë 15.01.2020, neni 3 “Të drejtat e përfituesit”, pika 1, si dhe të nenit 6 “Detyrimet e AZHBR”, pika 2.
 - Dokumentohet që në llogarinë bankare të përfituesit/ të jetë transferuar parapagesa 10% të ndihmës publike, në vlerën prej 3 313 363.64 lekë.
 - Mbi autorizimin dhe ekzekutimin e pagesës në masën 90 % të kontratës së grantit, të amenduar:
 - Nga ana e Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave me shkresën nr.3334/2 Prot, datë 12.11.2020 “Njoftim për pagesë” nënshkruar nga ana e Titullarit të AZHBR-së, është njoftuar Përfituesi “xxx” shpk se, shuma e autorizuar për Kontratën e Grantit nr. 91/3 Prot, datë 15.01.2020, e amenduar, është në vlerën prej 24 035 942.58 lekë nga të cilat: i) 75 % financohet nga Kontributi i Bashkimit Evropian, në vlerën prej 18 026 957.05

leke, si dhe; ii) 25 % financohen nga Kontributi Kombëtar në vlerën prej 6 008 985.68 lekë.

- Dokumentohet që, nëpërmjet operatorit bankar me urdhër transfertën e datës 05.03.2020, të jetë kryer pagesa në masën 90% të ndihmës publike, në vlerën prej 24 035 942 lekë, referuar Kontratës së Grantit 91/3 Prot, datë 15.01.2020, e amenduar, neni 4 “Të drejtat e përfituesit”, pika 1, si dhe të nenit 6 “Detyrimet e AZHBR”, pika 2,
- Dokumentohet që në llogarinë bankare të përfituesit/operatori bankar të jetë transferuar pagesa 90% të ndihmës publike, në vlerën prej 24 035 942 lekë.
- Nga ana e Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave, në cilësinë e strukturës përgjegjëse për kontrollin e plotësisë dhe përshtatshmërisë të kërkesave për pagesë, nuk janë përmbushur detyrat funksionale, sikurse përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të organizimit dhe funksionimit të administratës për Agjencinë AZHBR, neni 15, pika 15.5.2, si dhe; kërkesat respektive, sikurse përcaktuar në “Manualin e Procedurave të Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave”, pika 3 “Objekti i punës”, si dhe në pikën 5.5. “Verifikimi administrativ i kërkesës për pagesë”, si dhe nuk janë përmbushur kërkesat e chek listës respektive/E-4.1-1.12 3 “Lista e kontrolleve për plotësimin dhe përputhshmërinë”, pika 25, ku citohet kërkesa për: “Kopje të librit të masave, vetëm kur parashikon ndërtim dhe rindërtim”.

▪ Subjekti Përfitues “xxx” shpk:

- Nuk ka respektuar kërkesat e: i) Ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”; ii) Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e Punimeve të ndërtimit”, Kreu III “Dokumentacioni teknik i punimeve të ndërtimit”, si dhe Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3, datë 15.02.2001 ”Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

Në përfundim të inspektimit, Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka urdhëruar/kërkuar:

- Masa shpërblim vlerë dëmi 1(një)
- Masa rregullative 8 (tetë)
- Masa disiplinore 1 (një)

Nga ana e subjekteve është raportuar mbi statusin e zbatimit të masave të lëna. Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik, ka raportuar pranë Nëpunësit të Parë Autorizues mbi masat e ezauruara dhe vijon monitorimin e masave në proces zbatimi.

4. Në zbatim të Vendimit të Nëpunësit të Parë Autorizues nr.10, datë 17.02.2023 “Për fillimin e inspektimit financiar publik”, i ndryshuar, me objek inspektimi: “Zbatimi i ligjshmërisë lidhur me përdorimin e fondeve publike nga ana e institucionit të AZHBR-së, në kuadër të instrumentit të BE-së për Ndihmën e Para-Anëtarësimit për Zhvillimin Rural (IPARD II) 2014-2020, u krye inspektim financiar publik në subjektet: Agjencia

për Zhvillim Bujqësor dhe Rural dhe Operatori ekonomik “xxx.”, sh.p.k, Përfitues, nga ku u konstatua, për sa vijon:

- Dokumentohet që, Kontrata me numër identifikimi: ID 01/1/3/05/0297 të jetë lidhur më datë 19.05.2020, ndërmjet palëve kontraktuese: i) Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, si palë që jep mbështetjen (më poshtë referuar si: AZHBR), përfaqësuar nga Titullari i Institucionit; si dhe, ii) Shoqëria “xxx” sh.p.k si palë që përfiton fondet, përfaqësuar nga Z.xx.
- Nga ana e strukturave përgjegjëse të AZHBR-së, dhe konkretisht nga ana e Drejtorisë së Pranimit dhe Aprovimit të Projekteve, si dhe nga ana e Komisionit të Vlerësimit (EVC), gjatë konkludimit të vlerës së shpenzimeve të pranueshme, si dhe përcaktimit të ofertës për çmime të arsyeshme/ofertë fituese, rezultojnë diferenca, përkatësisht: i) në vlerën prej 301 246 lekë pa Tvsh, vlerë e cila përfaqëson diferencë çmimi për 5 (pesë) zëra punimesh, pjesë e shpenzimeve të pranueshme, krahasuar me çmimet e ofertuesve sipas ofertave të paraqitura me aplikimin fillestar (zëri: Punime civile), si dhe, ii) në vlerën 210 Euro apo 26 557 lekë pa Tvsh, vlerë e cila përfaqëson diferencë çmimi për zërin: “Sistemi kondicionimit në të ftohtë”, pjesë e shpenzimeve të pranueshme, krahasuar me çmimet e ofertuesve sipas ofertave të paraqitura me aplikimin (ndërtim serre).
- Totali i investimit në kohën respektive të konkludimit të vlerës së shpenzimeve të pranueshme, si dhe përcaktimit të ofertës për çmime të arsyeshme/ofertë fituese, duhet të ishte në vlerën 40 243 720 lekë pa Tvsh (40 571 523 lekë – 327 803 lekë).
- Vlera prej 213 071 lekë, vlerësohet përfitim i padrejtë nga ana e Subjektit Përfitues “R G F” sh.p.k, e cila përfaqëson 65 % të totalit të Shpenzimeve të pranueshme të Investimit/Kontributi i përgjithshëm publik (327 803 lekë*65 %).
- Nga ana e Komisionit të Vlerësimit (EVC) nuk janë respektuar kërkesat e Aneksit II “Procedura e përcaktimit të arsyeshmërisë së kostos nga KV”, pika 1/paragrafi i fundit i kësaj pike (lidhur me vlerësimin dhe përcaktimin e arsyeshmërisë së kostos/çmimit për aplikimin ID: 01/1/3/05/0297, nga marrja e kërkesës nr.642/10 Prot, datë 19.12.2019 “Kërkesë për përcaktimin e çmimit të arsyeshëm” deri në hartimin dhe dorëzimin e Raportit përfundimtar të EVC nr.1185 Prot, datë 07.04.2020.
- Nga ana e Drejtorisë së Pranimit dhe Aprovimit të Projekteve, nuk është respektuar afati kohor 6 (gjashtë) mujor, nga marrja dhe regjistrimi i formularit të aplikimit deri në përgatitjen e kontratës, në mos respektim të përcaktimeve të Manualit të Procedurave të Drejtorisë së Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve, paragrafi 5.5 “Kontrolli i plotësisë dhe pranueshmëria e formularit të aplikimit”, si dhe në mospëmbushje të detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të administratës për Agjencinë/AZHBR, neni 13, pika 13.3, si dhe pika 13.6.1.
- Nga ana e Drejtorisë së Pranimit dhe Aprovimit të Projekteve, nuk janë respektuar kërkesat e Udhëzimit për Aplikantët/SKEMA E GRANTEVE IPARD II 2014-2020/Versioni 1.4 2019/Formulari i aplikimit, pjesa 3 “Listat e dokumentave mbështetës

bashkëlidhur Formularit të Aplikimit”, dhe konkretisht nën pikat 3.1/3, 3.1/4, 3.1/5, kërkesat e Ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 23 “Përgjegjësitë”, pika 3, si dhe është vepruar në mosrespektim të përcaktimeve të Manualit të Procedurave të Drejtorisë së Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve dhe të detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të administratës për Agjencinë AZHBR, neni 13.

- Nga ana e Drejtorisë së Kontrollit, gjatë ushtrimit të kontroleve respektive, rezulton të mos jetë evidentuar diferenca e punimeve për rrugën 600ml*3m/ Zëri “Shtresë cakulli mbeturinë kave t=20.., në vlerën 52 416 lekë (96 m²*840 lekë*0.65), vlerësuar përfitim i padrejtë nga ana e Përfituesit, në mospërmbushje të detyrave funksionale, sikurse përcaktuar në Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të administratës për Agjencinë/AZHBR, dhe konkretisht neni 14, pika 14.5.2 “Detyrat e inspektorit të kontrollit IPARD”; si dhe kërkesat respektive, sikurse përcaktuar në Manualin e Procedurës së Drejtorisë së Kontrollit, pika 5.2.2 “Procedura për verifikim në vend pas Kërkesës për pagesë”.
- Nga ana e Subjektit “xxx” sh.p.k nuk janë respektuar kërkesat e Udhëzimit për Aplikantët/ SKEMA E GRANTEVE IPARD II 2014-2020/ Versioni 1.4 2019/Formulari i aplikimit, pjesa 3 “Listat e dokumentave mbështetës bashkëlidhur Formularit të Aplikimit”, dhe konkretisht nën pikat 3.1/3, 3.1/4, 3.1/5, kërkesat e Ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 23 “Përgjegjësitë”, pika 3.
- Nga ana e Subjektit “xxx” sh.p.k nuk janë respektuar kërkesat e: i) Ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”; ii) Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e Punimeve të ndërtimit”, Kreu III “Dokumentacioni teknik i punimeve të ndërtimit”, si dhe Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3, datë 15.02.2001 ”Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

Në përfundim të inspektimit, Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka urdhëruar/kërkuar:

- Masë shpërblim dëmi 3 (tre)
- Masa rregullative 7 (shtatë)
- Masa disiplinore 11 (njëmbëdhjetë)

Masat e kërkuara janë zbatuar nga subjektet e inspektuara. Drejtorja e Inspektimit Financiar Publik, ka raportuar pranë Nëpunësit të Parë Autorizues mbi statusin e realizimit të masave, dhe vijon monitorimin e masave në proces zbatimi.

5. Në subjektet: Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) dhe Operatori Ekonomik “xx” P.F, Përfitues, u krye mision inspektimi financiar publik në zbatim të Vendimit të Nëpunësit të Parë Autorizues nr.19, datë 16.03.2023 “Për fillimin e inspektimit financiar publik”, i ndryshuar (protokolluar në Ministrinë e Financave dhe

Ekonomisë nr.4859/1 Prot, datë 16.03.2023), u konstatua sa vijon:

Më datë 14.10.2019 është lidhur Kontrata e Grantit nr.531/13 Prot, ndërmjet palëve kontraktuese: i) Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, AZHBR (më poshtë referuar si: AZHBR), si palë që jep mbështetjen, përfaqësuar nga Titullari i Institucionit me Operatorin Ekonomik/subjektin “xxx” Person Fizik, përfaqësuar nga Z. xx, Administrator, në cilësinë e Përfituesit, si palë që përfiton fondet, me objekt: “Ndërtimi i një shtese anësore të një hoteli 3 katësh me bodrum”, në bazë të Lejes së Ndërtimit nr.2653, datë 17.01.2018, lëshuar nga Bashkia Korçë, me zhvillues subjekti “xx” Person Fizik.

Punimet e ndërtimit të godinës objekt kontrate, konsistojnë në: Punime dheu, Punime betoni dhe beton arme (b/a), Punime murature, Punime shtresash, Punime suvatimi, veshje e bojatisje, Punime hidroizolimi dhe tarace, Punime dyer dhe dritare, Punime ngrohje, Punime hidrosanitare, Punime ndaj zjarrit MNZ, Instalime elektrike, Instalimet e sistemit rrufepritës, tokëzime.

Punimet për ndërtimin e objektit kanë përfunduar para afatit, sikurse të përcaktuar në kontratën, sa më lart cituar dhe konkretisht më datë 22.09.2020.

- Mbi përcaktimin e çmimeve nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (EVC)/Investimi: “Investim në njësi akomodimi me stil tradicional në zonë malore, rurale”, nga Subjekti Aplikues “xx” Person Fizik.

Referuar Manualit të Procedurave të Drejtorisë së Pranimit dhe Aprovimit të Projekteve (DPAP), pika 5.5.1.2 “Vlerësimi i shpenzimeve të pranueshme” dhe pika 5.5.2 “Vlerësimi dhe krahasimi i ofertave”, nën-pika 1 dhe 2, rezulton se nga ana e DPAP/Inspektori përgjegjës për kontrollin e parë dhe inspektori i kontrollit të dytë, mbështetur në dokumentacionin e kërkuar/ofertat e paraqitura nga subjekti aplikues “AS” PF, dokumentohet të jetë bërë krahasimi i ofertave dhe llogaritja e çmimit (shpenzimet e pranueshme) për komponentët e objektit: “Investim në njësi akomodimi me stil tradicional në zonë malore, rurale”.

- Nga ana e strukturave përgjegjëse të AZHBR-së, dhe konkretisht nga ana e Drejtorisë së Pranimit dhe Aprovimit të Projekteve, si dhe nga ana e Komisionit të Vlerësimit (EVC), gjatë konkludimit të vlerës së shpenzimeve të pranueshme, si dhe përcaktimit të ofertës për çmime të arsyeshme/ofertë fituese, rezulton për më pak në vlerën prej 119 800 lekë, pa Tvsh, vlerë e cila përfaqëson diferencë në çmim për 6 (gjashtë) zëra të komponentit “Mobolim/Pajisje mobilimi”, pjesë e shpenzimeve të pranueshme.
- Totali i investimit në kohën respektive të konkludimit të vlerës së shpenzimeve të pranueshme, si dhe përcaktimit të ofertës për çmime të arsyeshme/ofertë fituese, duhet të ishte në vlerën 20 873 181.99 lekë, pa Tvsh (20 992 981.99 lekë -119 800 lekë).
- Vlera prej 77 860 lekë, vlerësohet përfitim i padrejtë nga ana e Subjektit Përfitues “A.S” PF, e cila përfaqëson 65 % të totalit të shpenzimeve të pranueshme të Investimit/kontributi i përgjithshëm publik (119 800*65 %).

- Komisioni i Vlerësimit (EVC), nuk ka përmbushur kërkesat e Aneksit II, pika 1/paragrafi i fundit i kësaj pike (lidhur me vlerësimin dhe përcaktimin e arsyeshmërisë së kostos/çmimit për aplikimin (nga marrja e kërkesës të DPAP nr.531/6 Prot, datë 04.09.2019 “Kërkesë për përcaktimin e çmimit të arsyeshëm”, deri me hartimin dhe dorëzimin e Raportit përfundimtar të EVC nr.531/11 Prot, datë 10.10.2019).
- Struktura e Drejtorisë së Kontrollit:
 - Nga ana e SKI/DK, dokumentohen të jenë kryer 4 (katër) kontrole në terren, kontrole këto të ushtruara pranë Subjektit/Përfituesit të mbështetjes publike “xx” PF, lidhur me investimin “Ndërtimin e një shtese anësore të një hoteli 3 katësh me bodrum”, Masa për Sektorin “Turizmi i natyrës dhe ai rural”, pjesë e Masës 7: “Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit”, respektivisht:
 - 1 (një) verifikim/kontroll në vend/terren, para miratimit të lidhjes së Kontratës së Grantit;
 - 2 (dy) verifikime/kontrole shtesë në vend/terren, pas lidhjes së Kontratës së Grantit;
 - 1 (një) verifikim/kontroll në vend/terren, para autorizimit për pagesë në masën 90 % të vlerës së Kontratës së Grantit.
 - ✓ Mbi verifikimet e kryera në vend/terren mbas nënshkrimit të Kontratës së Grantit nga palët respektive:
 - Nga kontrolli i ushtruar/verifikimi në terren, kanë rezultuar, diferenca (+/-) në sasi, për 128 zëra në komponentin “Punime ndërtimore” dhe në komponentin “Mobilimi/Pajisje mobilimi” të kontraktuara, përcjellë pranë Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave.
 - Në përfundim të kontrollit administrativ të dokumentacionit të kryer nga ana e Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave dhe të kontrollit në vend/terren të kryer nga ana e Drejtorisë së Kontrollit, kanë rezultuar diferenca në vlerën totale prej 642 150.21 lekë, vlerë e cila përfaqëson diferenca në Komponentin “Punime ndërtimi”, për 26 zëra /të pakryera, e për rrjedhojë vlera 642 150.21 lekë (987 923.41 * 65 %), e cila përfaqëson kontributin e përgjithshëm publik, rezulton të mos jetë ekzekutuar, në autorizimin respektiv të pagesës së bërë nga ana e Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave.
- Struktura e Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave (DAP), si dhe Drejtoria e Ekzekutimit të Pagesave (DEP):
 - Mbi autorizimin dhe ekzekutimin e parapagesës, në masën 10 % të kontratës së grantit:
 - Dokumentohet që, nëpërmjet operatorit bankar “Intesa SanPaolo Bank”, me urdhër transfertën e datës 19.11.2019, të jetë kryer parapagesa në masën 10% të ndihmës publike, në vlerën prej 1 301 898 lekë, referuar Kontratës nr.531/12 Prot, datë 11.10.2019, neni 3 “Të drejtat e përfituesit”, pika 1, si dhe të nenit 6 “Detyrimet e AZHBR”, pika 1; si dhe; Amendimit nr.531/16 Prot, datë 04.11.2019, neni 1 “Detyrimet e përfituesit”, pika 1 dhe neni 2 “Detyrimet e AZHBR”, pika 1 dhe 2.
 - Dokumentohet që, në llogarinë bankare të përfituesit, të jetë transferuar parapagesa në masën 10% të ndihmës publike, në vlerën prej 1 301 198 lekë.

- Mbi kthimin e fondeve në rastin e mbipagesës/Pagesës së ekzekutuar:

Referuar Manualit të procedurave për Sektorin për Ekzekutimin e Pagesave, pika 5.9 “Ekzekutimi i pagesave”, nënpika 5.9.8 “Kthimi i fondeve në rastin e mbipagesës/pagesës së ekzekutuar në llogarinë e gabuar bankare”, si dhe Kontratës së Grantit nr.531/13 Prot, datë 14.10.2019, neni 4 “Detyrimet e përfituesit”, pika 21 si dhe neni 5 “Të drejtat e AZHBR-së”, pika 11, gërma “d”, si dhe pika 12, rezulton:

 - Dokumentohet që, nga ana e Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave, të jetë konstatuar diferenca në shumën prej 570 370 lekë, e cila përfaqëson principal/ pagesë më tepër në llogarinë e përfituesit “xxx” Person Fizik, si rezultat i amendimit të Kontratës së Grantit nr.531/13 Prot, datë 14.10.2019 (ndryshimit të kontributit të përgjithshëm publik e për rrjedhojë ndryshim të parapagesës në masën 10 % të këtij kontributi (1 301 898.370- 1 301 328), për të cilën:
 - Dokumentohet që, me shkresën nr.1201/9 Prot, datë 11.09.2020/Formulari E-4.1-1.20 “Njoftim për kthimin e fondeve” Titullari i Institucionit të AZHBR-së, drejtuar subjektit kontraktues/përfitues “xxx” Person Fizik, ka kërkuar kthimin e shumës prej 570 370 lekë, brenda 15 ditëve nga marrja e këtij njoftimi.
 - Me shkresën nr.3054/4 Prot, datë 29.09.2020 “Dërgim transfertash”, Drejtoria e Ekzekutimit të Pagesave, drejtuar Drejtorisë së Financës/Sektorit të Kontabilitetit si dhe Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave, dokumenton në bashkëlidhje të saj urdhër-transfertën datë 20.09.2020 për arkëtimin e shumës prej 570 370 lekë nga ana e përfituesit “A.S” Person Fizik, nëpërmjet operatorit bankar.
- Mbi autorizimin dhe ekzekutimin e pagesës në masën 90 % të Kontratës së grantit, të amenduar:

Referuar Manualit të Procedurave të Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave, nënpika 5.2 “Marrja dhe përpunimi i kërkesës për pagesë”, Manualit të procedurave për Sektorin për Ekzekutimin e Pagesave, pika 5.9 “Ekzekutimi i pagesave”, si dhe Kontratës nr.531/12 Prot, datë 11.10.2019, neni 3 “Të drejtat e përfituesit”, pika 1, si dhe të nenit 6 “Detyrimet e AZHBR”, pika 1; Amendimit nr.531/16 Prot, datë 04.11.2019, neni 1 “Detyrimet e përfituesit”, pika 1 dhe neni 2 “Detyrimet e AZHBR”, pika 1 dhe 2; si dhe: Amendimit nr.1201/7 Prot, datë 14.08.2020, neni 1 “Objekti i kontratës”, gërma “d”, dhe neni 2 “Shuma e kontraktuar”, pika 2, dhe pika 3/3a, rezulton:

- Dokumentohet që, nëpërmjet operatorit bankar me urdhër transfertën e datës 22.02.2021, të jetë kryer pagesa në masën 90% të ndihmës publike, në vlerën prej 11 069 802 lekë.
- Dokumentohet që në llogarinë bankare të përfituesit, të jetë jetë transferuar pagesa 90% të ndihmës publike, në vlerën prej 11 069 802 lekë.
- Nga ana e Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave, në cilësinë e strukturës përgjegjëse për kontrollin e plotësisë dhe përshtatshmërisë të kërkesave për pagesë, nuk janë

përmbushur: i) kërkesat respektive, sikurse përcaktuar në “Manualin e Procedurave të Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave”, pika 3 “Objekti i punës”, si dhe në pikën 5.5. “Verifikimi administrativ i kërkesës për pagesë”, dhe kërkesat e chek listës respektive/E-4.1-1.12 3 “Lista e kontrolleve për plotësimin dhe përputhshmërinë”, pika 24, ku citohet kërkesa për: “Kopje të librit të masave, vetëm kur parashikon ndërtim dhe rindërtim”, si dhe detyrat funksionale, sikurse përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të organizimit dhe funksionimit të administratës për Agjencinë AZHBR, neni 15, pika 15.5.2.

- Subjekti Përfitues “xxx” P.F:
- Nga ana e Subjektit Përfitues nuk janë respektuar kërkesat e: i) Ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”; ii) Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III “Dokumentacioni teknik i punimeve të ndërtimit”, si dhe Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3, datë 15.02.2001 ”Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

Në përfundim të inspektimit, Ministri i Financave ka urdhëruar/kërkuar:

- Masa shpërblim vlerë dëmi 1 (një)
- Masa rregullative 5 (pesë)
- Masa disiplinore 1 (një)

Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik, ka raportuar pranë Nëpunësit të Parë Autorizues mbi statusin e realizimit të masave, dhe vijon monitorimin e masave në proces zbatimi.

6. Në zbatim të Vendimit të Nëpunësit të Parë Autorizues nr.24, datë 02.05.2023 “Për fillimin e inspektimit financiar publik”, i ndryshuar, u krye inspektim financiar publik, në subjektet: Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve, në Institucionin e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale Lushnje (IEVP), si dhe në Shoqërinë “xx” shpk, kontraktuar për kryerjen e shërbimit “Transporti i punonjësve të IEVP Lushnje”, nga ku u konstatua, për sa vijon:

- ❖ Lidhur me argumentimin e nevojave, përlllogaritjen e fondit limit, vlerës limit të kontratës, hartimin e specifikimeve teknike, kushteve të përgjithshme të kontratës, si dhe kushteve të veçanta të kontratës, pjesë e Dokumenteve Standarte të Tenderit (DST)/ të miratuara, si dhe realizimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Transport të punonjësve të IEVP Lushnje”:
- Institucioni i IEVP, Lushnje:
- Nga ana e Institucionit të IEVP, Lushnje/strukturat përgjegjëse/Personi përgjegjës për prokurimet, rezulton të jetë dërguar pranë APP-së “Regjistri i parashikimeve publike për

- vitin 2021”, në tejkalim të afatit, sikurse përcaktuar në VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 4, pika 1.
- Nga ana e Institucionit të IEVP-së/strukturat përgjegjëse/Personi përgjegjës, nuk janë zbatuar kërkesat e VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar neni 7, pika 2, dhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 4, pika 2 (dokumentohet dërgimi në APP i Regjistrin të realizimit të prokurimeve publike për 4-mujorin e tretë të vitit 2021, respektivisht brenda datës 10 Janar të vitit 2022 dhe për 4-mujorin e tretë të vitit 2022, respektivisht brenda datës 10 Janar të vitit 2023).
 - Nga ana e Institucionit të IEVP-së/strukturat përgjegjëse/Personi përgjegjës, në Regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike të vitit 2021, dokumenton objektin e prokurimit: “Shpenzime të tjera transporti të ndryshme” dhe jo “Transporti i punonjësve të policisë të IEVP Lushnje”.
 - Urdhri i prokurimit nr.1 Prot, datë 18.01.2021 “Për ngritjen e komisionit të planifikimit, fondit limit, specifikimeve teknike, termave të referencës”, miratuar nga ana e ish-Titullarit të IEVP-së, në cilësinë e ish-Titullarit të AK:
 - o Nuk referon në përmbajtje të tij, detyrimin e Institucionit të IEVP Lushnjë për iniciimin e procedurës së prokurimit, për transportin e punonjësve të policisë së burgjeve, në referencë të kërkesave të Ligjit nr.10032, datë 11.12.2008 “Për policinë e burgjeve”, neni 15 “Rregullimi i pagave”, pika 5.
 - o Nuk përmbush kërkesat e VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 57, pika 2.
 - Nga ish-Titullari i IEVP-së, Lushnje, në cilësinë e ish-Titullarit të Autoritetit Kontraktor, dhe Personi përgjegjës për prokurimet, nuk janë respektuar rregullat e prokurimit publik, për objektin e prokurimit, referuar VKM-së nr.914, datë 19.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 56 dhe neni 57, pika 3.
 - Referuar Urdhrit nr.1, datë 18.01.2021 “Për përlllogaritjen e fondit limit”, lëshuar nga ana e ish-Titullarit të Institucionit të IEVP-Lushnjë, në cilësinë e ish-Titullarit të AK, rezulton se, Komisioni i ngritur për këtë qëllim:
 - o Nuk ka specifikuar kategorinë e punonjësve të IEVP-së, të cilët do të përfitojnë nga ky shërbim transporti, në mungesë të një liste emërore për punonjësit, si dhe në mungesë të adresave respektive të tyre, në funksion të përcaktimit të distancës që duhet të përshkruhet nga ana e OE të shpallur fitues, i cili do të ofronte shërbimin e transportit për punonjësit e policisë së IEVP Lushnje.
 - o Nuk dokumenton një analizë të bërë lidhur me turnet respektive që do të kryhen nga punonjësit e policisë dhe organizimi i tyre, bazuar në skemën e sigurisë, të miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Burgjeve nr.183, datë 01.07.2015 “Udhëzim mbi përshkrimin e detyrave të policisë së burgjeve sipas vend shërbimeve në IEVP Lushnje”.

- Nuk dokumenton, si dhe mungon një analizë lidhur me rritjen e numrit të punonjësve të policisë që do të përfitojnë nga shërbimi i transportit (referuar procesverbaleve të mbajtura nga ky Komision).
- Nga ana e Institucionit të IEVP-së/strukturat përgjegjëse, nuk janë përmbushur kërkesat e VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”.
- Nuk dokumentohet Urdhri i ish-Titullarit të Institucionit të IEVP-së, në cilësinë e ish-Titullarit të AK, për ngritjen e Komisionit “Mbi hartimin e kërkesave teknike apo kushtet e veçanta të kualifikimit” të procedurës së prokurimit “Kërkesë për propozim”, për Marrëveshjen Kuadër me afat 24 muaj, me objekt: “Transporti i punonjësve të policisë të IEVP-së Lushnje”.
- Nga ana e Institucionit të IEVP-së/strukturat përgjegjëse/Komisioni për “Planifikimin e fondit limit, specifikimeve teknike dhe termave të referencës”, në referencë të Urdhrit nr. 1, datë 18.01.2021, nuk janë përmbushur kërkesat e VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 61.
- ❖ Mbi lidhjen e Marrëveshjes Kuadër (MK) nr.1/57 Prot, datë 29.03.2021, me objekt: “Transporti i punonjësve të IEVP Lushnje”.
- Më datë 29.03.2021, rezulton të jetë lidhur MK nr.1/57 datë 29.03.2021, ndërmjet Institucionit të IEVP Lushnje, në cilësinë e AK, përfaqësuar nga Z.ZR, me detyrë ish-Titullar i Institucionit dhe Operatorit Ekonomik (OE) shoqëria “xx” shpk, përfaqësuar nga Z.R.Sh, Administrator, me të dhëna: i) Objekti: “Transporti i punonjësve të IEVP Lushnje”; ii) Vlera e kontratës”: 7 644 229 lekë, pa Tvsh; si dhe, iii) Afati i realizimit të shërbimit: 24 muaj; Pjesë integrale e MK janë edhe Formulari i Deklaratës së Ofertës, të paraqitur nga Ofertuesi, Specifikimet teknike dhe Formulari i çmimit të ofertës (në mungesë të specimenteve respektive/hartues/konfirmues (në footnooter rezulton të jetë vendosur adresa e sektorit ligjor të IEVP-së).
- Objekti i MK nr.1/57 Prot, datë 29.03.2021 dokumenton të jetë “Transporti i punonjësve të IEVP Lushnje” dhe jo “Transporti i punonjësve të policisë të IEVP Lushnje”, objekt ky, i cili nuk përmbush përcaktimet e Ligjit nr.10032, datë 11.12.2008 “Për policinë e burgjeve”; Në përmbajtje të MK është përcaktuar numri total i punonjësve, për 167 punonjës, me vlerë shërbimi transporti 191.7 lekë për çdo punonjës, të cilët do të marrin shërbimin e transportit.
- Nga ana e Institucionit të IEVP-Lushnje, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor/strukturat përgjegjëse/përkatese, nuk janë zbatuar kërkesat e Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, Kreut II-B “Përpilimi, shtypja, shumëfishimi dhe evidencimi i dokumenteve” dhe të nenit 11 dhe nenit 12 “Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e rregullores së njehsuar të punës me dokumentet në Autoritetet Publike të Republikës së Shqipërisë”.

- a) Kontrata e shërbimit nr.1/58 Prot, datë 29.03.2021, periudha 1 Prill 2021- 31 Dhjetor 2021, në vlerën prej 3 048 413 lekë, pa Tvsh ose 3 658 096 lekë, me Tvsh, lidhur ndërmjet Institucionit të IEVP-së dhe shoqërisë “xx” shpk:
- Më datë 29.03.2021 është lidhur Kontrata e Shërbimit nr.1/58 Prot, datë 29.03.2021 ndërmjet Institucionit të IEVP-së dhe shoqërisë “xx” shpk, me të dhënat: i) Objekt i kontratës: “Transporti i punonjësve të IEVP Lushnje “Marrëveshje Kuadër me një operator”, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me REF-86265-02-08-2021; ii) Afati i shërbimit: periudha 01.04.2021 deri në 31.12.2021, si dhe iii) Vlera e kontratës: 3 048 413 lekë, pa Tvsh ose 3 658 096 lekë, me Tvsh; në përmbajtje të kësaj kontrate shërbimi (grafiku i lëvizjes) specifikohet numri i punonjësve, 167 punonjës, me vlerë transporti për çdo punonjës 191.7 lekë, të cilët do të marrin shërbimin e transportit, në referencë të termave të referencës të MK.
 - Nga ana e Institucionit të IEVP Lushnje/AK, rezulton të jetë dërguar pranë APP-së “Njoftimi i nënshkrimit nga palët respektivë” të MK nr.1/57 Prot, datë 29.03.2021, si dhe të kontratës së shërbimit, nr.1/58 Prot, datë 29.03.2021, brenda afateve ligjore të përcaktuara.
 - Më datë 24.03.2021, nga ana e shoqërisë kontraktore “xx” shpk, rezulton të jetë bërë sigurimi i kontratës në masën 10 % të vlerës totale të MK, në shumën prej 917 307.5 lekë, referuar Marrëveshjes Kuadër nr.1/57, datë 29.03.2021, neni 5 “Sigurimi i kontratës”, si dhe Kontratës së Shërbimit nr.1/58 Prot, datë 29.03.2021, neni 28.
- b) Kontrata e Shërbimit/minikontrata nr.1/68 Prot, datë 10.11.2021, Periudha Nëntor-Dhjetor 2021, në vlerën 1 329 630 lekë, me Tvsh lidhur ndërmjet Institucionit të IEVP-së dhe shoqërisë “xx” shpk:
- Rezulton se, kjo kontratë shërbimi të jetë anuluar nga ana e ish-Titullari i Institucionit të IEVP-së, në cilësinë e ish-Titullarit të AK, më datë 11.11.2021.
 - Anullimi i Kontratës së Shërbimit vlerësohet i njëanshëm dhe në shkelje të dispozitave ligjore në fuqi: i) Kodit të Procedurave Administrative të RSH, neni 122 “Pavlefshmëria e kontratës administrative”, neni 123 “Ndryshimi, prishja apo tërheqja nga kontrata administrative, si dhe; ii) dispozitave ligjore të Kodit Civil të RSH, neni 696 “E drejta për t’u tërhequr nga kontrata”.
 - Kjo Kontratë shërbimi nuk ka prodhuar efekt financiar për buxhetin e shtetit.
- c) Kontrata e Shërbimit nr.1/71 Prot datë 10.01.2022, Periudha Janar-Dhjetor 2022, në vlerën 5,513,139 lekë, me Tvsh, lidhur ndërmjet Institucionit të IEVP-së dhe Shoqërisë “xx” shpk:
- Referuar formularit të ofertës ekonomike dhe grafikut të lëvizjes, rezulton se, Kontrata e shërbimit nr.1/71 Prot, datë 10.01.2022 “Transporti i punonjësve të IEVP Lushnje “Marrëveshje Kuadër ...”, në përmbajtje të saj të ketë parashikuar 192 punonjës policie, të cilët do të marrin shërbimin nga 167 punonjës policie sikurse përcaktuar në: i) Grafikun e lëvritimit, ii) Dokumentat Standarte të Tenderit (DST), si dhe; iii) Marrëveshjen Kuadër nr. 1/57, datë 29.03.2021, me një diferencë prej 25 punonjës më shumë.

- Nuk dokumentohet të ketë një ndryshim të strukturës organike dhe rritje të numrit të punonjësve të policisë, e cila të mund të justifikojë rritjen e numrin të punonjësve që përfitojnë nga shërbimi i transportit, e për më tej mungon një relacion i cili të dokumentojë domosdoshmërinë e rritjes së numrit të punonjësve, që përfitojnë nga shërbimi i transportit.
- Rezulton se, objekti i Kontratës së shërbimit “transport i administratës dhe trupës policore -IEVP Lushnje ...”, i adresohet edhe punonjësve të administratës të Institucionit të IEVP Lushnjë, në kundërshtim me kushtet e MK dhe qëllimin e lidhjes së saj.
- d) Amendimi nr.01/76 Prot, datë 30.11.2022 i Marrëveshjes Kuadër nr.1/57, datë 29.03.2021, lidhur ndërmjet Institucionit të IEVP-së dhe Shoqërisë “D” shpk:
 - Nga ana e APP-së (referuar sistemit elektronik të prokurimeve), dokumentohet të jetë refuzuar shtesa e kontratës për 3 muaj për mbulimin e shpenzimeve të transportit të IEVP Lushnje, me arsyetimin se, mungon një argumentin nga ana e Institucionit të IEVP-së Lushnje/strukturat përgjegjëse, i cili të sjellë në pah arsyet e klasifikimit të rasteve lidhur me kryerjen e shërbimit të gatishmërisë së emergjencës apo punonjësve mbështetës në rrethana të paparashikuara, dhe argumentimi lidhur me mos përfshirjen e këtyre rasteve si shërbime të mundshme në MK, dhe referuar të dhënave në SPE, vlera e modifikimit të MK tejkalon 20 % të vlerës së kontratës fillestare/MK.
 - Me Urdhër të Titullari të AK nr.1/73, datë 17.11.2022 “Për ngritjen e Grupit të punës për hartimin e amendimit të kontratës së transportit”, në mungesë të ekstemiteve ligjore (nr.prot ska, datë 17.11.2022, në mungesë të konceptuesit dhe konfirmuesit) është ngritur grupi i punës për amendimin e MK, në mos përmbushje të kërkesave të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, Kreut II-B. “Përpilimi, shtypja, shumëfishimi dhe evidencimi i dokumenteve”, të nenit 11 dhe nenit 12 të “Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e rregullores së njehsuar të punës me dokumentet në Autoritetet Publike të Republikës së Shqipërisë”.
 - Ky urdhër ka të njëjtat ekstemiteve ligjore (numër dhe datë urdhri si dhe datë protokollit) të Urdhrit të Titullarit të Institucionit të IEVP-së, nr.1/73, datë 17.11.2022 “Për ngritjen e Grupit të punës për hartimin e amendimit të kontratës së transportit”, konceptuar nga Zv-Drejtori i IEVP-së Lushnje, në tejkallim të kompetencave, duke marrë atributet e Sektorit Ligjor të institucionit.
 - Me Vendimin nr.01/2, datë 30.11.2022, Titullari i AK, rezulton të jetë miratuar relacioni i Grupit të punës të ngritur me Urdhër nr.1/73, datë 17.11.2022, mbi amendimin e Marrëveshjes Kuadër nr.1/57, datë 9.03.2021, në mungesë të një dokumenti fizik, i cili të dokumentohet në bashkëlidhje të këtij Vendimi, e për më tej, nuk dokumentohet të jetë regjistruar në librin e protokollit të Institucionit të IEVP-Lushnje.
 - Amendimi nr.01/76 Prot, datë 30.11.2022, i Marrëveshjes Kuadër nr.1/57, datë 29.03.2021, i është mbivendosur Kontratës së shërbimit nr.1/76 Prot, datë 09.12.2022, për kryerjen e transportit të punonjësve të policisë në IEVP Lushnje, lidhur ndërmjet Institucionit të IEVP-së dhe shoqërisë “xx” shpk (Amendimi nr.01/76 Prot, datë 30.11.2022

rezulton të jetë anuluar nga ana e Titullarit të IEVP-së referuar Vendimit nr.1/80, datë 17.02.2023 “Për anulim të amendimit të kontratës”, 3 muaj mbas nënshkrimit nga palët respektive të Kontratës së shërbimit nr.1/76 Prot, datë 09.12.2022).

- e) Kontrata e shërbimit nr.1/78 Prot, datë 24.01.2023, periudha 01 Shkurt 2023 deri në 30 Prill 2023, në vlerën 1 135 902 lekë, pa Tvsh, ose 1363 082 lekë, me Tvsh, lidhur ndërmjet Institucionit të IEVP-së dhe Shoqërisë “xx” shpk:
 - Nga ana e IEVP Lushnje/strukturat përgjegjëse, rezulton të jetë lidhur Kontrata e shërbimit nr.1/78 Prot, datë 24.01.2023, në kundërshtim me përcaktimet e MK (në tejkalim të afatit 24 mujor).

Nga ana e Drejtuesve të Institucionit të IEVP, Lushnje, sipas periudhës së ushtrimit të detyrës nga ana e tyre, është vepruar në kundërshtim me kërkesat e: i) Ligjit nr.36/2014, datë 10.04.2014, i ndryshuar “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.10032 datë 11.12.2008 “Për policinë e burgjeve”, neni 15, pika 5 “Rregullimi i pagave”; ii) Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, si dhe; iii) në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, konkretisht:

Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar; VKM-në nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar; Ligjin nr. 62/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar; iv) në kundërshtim me detyrat funksionale, sikurse përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të Institucionit të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale Lushnje (IEVP) nr.5393/1, datë 22.06.2010, neni 5, pika 1 “Drejtori”; i) grafikun e lëvrimin, pjese integrale e kontratës; si dhe v) përcaktimet e Dokumenteve Standarte të Tenderit/Shtojca 10 “Shërbimi dhe Grafiku i Ekzekutimit” të Marrëveshjes Kuadër me nr.1/57 datë 29.03.2021, neni 4, “Grafiku i ekzekutimit të kontratës”.

- ❖ Lidhur me zbatimin e ligjshmërisë në zbatimin e Marrëveshjes Kuadër nr.1/57 Prot, datë 29.03.2021, me objekt: “Transporti i punonjësve të IEVP Lushnje”, të amenduar dhe Kontratave të shërbimit, në zbatim të kësaj marrëveshje, të lidhura ndërmjet Institucionit të IEVP, Lushnje dhe Subjektit kontraktor, Shoqëria “xx” shpk.
- Institucioni i IEVP Lushnje/Strukturat përgjegjëse:
 - Me Urdhrin nr.1/62 Prot, datë 06.04.2021 “Për ngritjen e Komisionit të monitorimit të Kontratës së transportit”, i ndryshuar, dokumentohet të jetë ngritur Grupi i punës për monitorimin e Marrëveshjes Kuadër nr.1/57 Prot, datë 29.03.2021, si dhe të kontratave të shërbimit: Kontratë shërbimi nr.1/58 Prot, datë 29.03.2021, Kontratë shërbimi nr.1/71 Prot, datë 10.01.2022, Kontratë shërbimi nr.1/76 Prot, datë 09.12.2022, dhe Kontratë shërbimi nr.1/78 Prot, datë 24.01.2023, referuar kërkesave të: VKM-së nr.914, datë 29.12.2021 “Për rregullat e prokurimit publik” dhe Kreut II “Kushtet e Përgjithshme të Kontratës” neni 34, “Monitorimi i kontratës” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 107 “Zbatimi dhe

mbikëqyrja e kontratës”, si dhe nenit 108 “Raportimi në rastet e mospërbushjes së detyrimeve kontraktore”.

- a) Kontratë shërbimi nr.1/58 Prot, datë 29.03.2021.
- Nga ana e Komisionit Monitorues, është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e Marrëveshjes Kuadër, pika 1.1.2, si dhe në kundërshtim me Urdhrin nr.1/62 Prot, datë 06.04.2021 “Për ngritjen e Komisionit të monitorimit të kontratës së transportit”, i ndryshuar.
 - Nuk dokumentohen arsyet pse situacioni dhe Akti i marrjes në dorëzim me nr.509/3, datë 03.03.2022, pavarësisht faturës tatimore të lëshuar me vonesë nga operatori ekonomik, të jenë bërë brenda të njëjtës ditë, datë 03.03.2022, në mosrespektim të kërkesave të Urdhrit nr.508, datë 02.03.2022 “Për ngritjen e Komisionit për monitorim të kontratës së transportit”.
 - Numri i ditëve të situacionuara për shërbim transporti, muaji Janar 2022, rezulton me diferencë 9 ditë, gjithsej shërbim transport i faturuar dhe i pranuar nga Komisioni Monitorues, rezulton të jetë 22 ditë kalendarike.
 - Numri i punonjësve të deklaruar në shërbimin e ofruar nga subjekti kontraktor “D” shpk, referuar faturave tatimore, periudha Prill 2021- Mars 2023, rezulton të jetë më shumë se numri i përcaktuar në grafikun e lëvrimin (pjesë integrale e kontratës), në kundërshtim me kërkesat specifike të Dokumenteve Standarte të Tenderit, Shtojca 10 “Shërbimi dhe Grafiku i Ekzekutimit”, të Marrëveshjes Kuadër me nr.1/57, datë 29.03.2021, si dhe të Kontratave të lidhura në zbatim të MK, neni 4 “Grafiku i ekzekutimit të kontratës”.
 - Përshkrimi i shërbimit të situacioneve të deklaruara nga shoqëria “xx” shpk dokumentohet të jetë “Transport i administratës dhe trupës policore në IEPV Lushnje-Kosovë, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 1 “Objekti i kontratës”, Kreut I, “ Kushtet e veçanta të kontratës”, “Shërbimi i transportit të punonjësve IEPV Lushnje”.
 - Nga ana e Nëpunësit Zbatues/Spektori i Financës, në IEPV Lushnje, nuk janë përmbushur kërkesat e: i) Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”, pika 3 “Nëpunësi zbatues i të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës”, germa “e”, ii) Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu I, pika 4/a, si dhe; iii) Rregullores së Brendshme të Institucionit të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale Lushnje (IEVP) nr.5393/1, datë 22.06.2010, në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.5330, datë 07.06.2010 “Për miratimin e rregullores së Brendshme të Institucionit të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale Lushnje (IEVP)”, neni 9 “Spektori Financës” pika 1.
 - Nga ish-Titullari i Institucionit të IEVP-së (periudha Prill-Dhjetor 2021), nuk janë përmbushur kërkesat e: i) Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”; ii) në mosrespektim të detyrimeve/ përcaktimeve kontraktuale, të Marrëveshjes Kuadër nr.1/57, datë 29.03.2021, si dhe; iii) Kontratës së shërbimit nr.1/58, datë 29.03.2021.

- b) Kontrata e shërbimit nr.1/71 prot, datë 10.01.2022:
- Nga ish- Titullari i Institucionit të IEVP-së, rezulton të jetë lidhur Kontrata e shërbimit nr.1/71 prot, datë 10.01.2022, në mungesë të fondeve buxhetore, në mosrespektim të kërkesave të Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 51 “Menaxhimi i angazhimeve”.
 - o Në shkresën nr.1000/01, datë 08.02.2022 “Mbi detajimin e buxhetit në nivel nën/artikulli për vitin 2022”, të Drejtorisë së Përgjithshme e Burgjeve rezulton se, zëri “Shpenzime të tjera transport” është në vlerën 4 594 000 lekë me Tvsh, ndërkohë kur vlera financiare e kontraktuar dokumentohet të jetë në vlerën prej 5 513 139 lekë me Tvsh, për më pak në vlerën prej 919 800 lekë.
 - Nga ana e Institucionit të IEVP-Lushnjë/ Struktura përgjegjëse, rezulton se, Kontrata e shërbimit nr.1/71 prot, datë 10.01.2022, është zbatuar në mosrespektim të detyrimeve kontraktuale, referuar Marrëveshjes Kuadër nr.1/57, datë 29.03.2021, neni 4, “Grafiku i ekzekutimit të kontratës”, të Ligjit nr.10 032 datë 11.12.2008 “Për policinë e burgjeve” të ndryshuar, neni 15, pika 5 “Rregullimi i pagave“, rregullat e prokurimit publik, si dhe Rregullores së Brendshme të Institucionit të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale Lushnje (IEVP) me nr.5393/1 Prot, datë 22.06.2010, neni 5, pika 1 “Drejtori”.
- c) Kontrata e shërbimit, nr.01/76 Prot, datë 30.11.2022,
- Kontrata e shërbimit, nr.01/76 Prot, datë 30.11.2022, e cila është anuluar me Vendimin e Titullarit të Institucionit të IEVP-së nr. 1/80, datë 17.02.2023 “Për anulim të amendimit të kontratës”, nuk ka prodhuar efekte financiare për buxhetin e shtetit.
- d) Kontrata e shërbimit/minikontrata nr.1/76 Prot, datë 09.12.2022:
- Nga ana e Institucionit të IEVP-Lushnjë/ Struktura përgjegjëse, rezulton se Kontrata e shërbimit nr.1/76 Prot, datë 09.12.2022, për periudhën 01 Nëntor 2022 -31 Janar 2023, në vlerën 1 163 679 lekë pa Tvsh ose 1 396 415 lekë me Tvsh është zbatuar në mosrespektim të detyrimeve kontraktuale, referuar Marrëveshjes Kuadër nr.1/57, datë 29.03.2021, neni 4, “Grafiku i ekzekutimit të kontratës”, të Ligjit nr.10 032 datë 11.12.2008 “Për policinë e burgjeve” të ndryshuar, neni 15, pika 5 “Rregullimi i pagave“, rregullat e prokurimit publik, si dhe Rregullores së Brendshme të Institucionit të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale Lushnje (IEVP) me nr.5393/1 Prot, datë 22.06.2010, neni 5, pika 1 “Drejtori”.
 - o Rezulton se, në total numri i punonjësve të policisë që do të marrin shërbimin/ do të transportohen është 185 punonjës, pra 18 punonjës më shumë, se numri i përcaktuar në grafikun e lëvrimet (pjesë integrale e kontratës, 167 punonjës të përcaktuar nga MK nr.1/57 Prot, datë 29.03.2021).
 - Nga ana e Titullarit të AK/IEVP-së, Lushnje respektiv, është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr.10032, datë 11.12.2008 “Për policinë e burgjeve”, i ndryshuar, neni 15 “Rregullimi i pagave”, pika 5, iv) Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, si dhe në kundërshtim me detyrat funksionale, sikurse përcaktuar në

Rregulloren e Brendshme të Institucionit të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale Lushnje (IEVP) nr.5393/1, datë 22.06.2010, neni 5, pika 1 “Drejtori”.

e) Kontrata e shërbimit nr.1/78 Prot, datë 24.01.2023:

- Nga ana e Institucionit të IEVP-Lushnje/ Struktura përgjegjëse, rezulton se, Kontrata e shërbimit/minikontrata nr.1/78 Prot, datë 24.01.2023, periudha 01 Shkurt 2023 deri në 30 Prill 2023, në vlerën 1 135 902 lekë pa Tvsh ose 1363 082 lekë, me Tvsh, është zbatuar në mosrespektim të detyrimeve kontraktuale, referuar Marrëveshjes Kuadër nr.1/57, datë 29.03.2021, neni 4, “Grafiku i ekzekutimit të kontratës”, të Ligjit nr.10 032 datë 11.12.2008 “Për policinë e burgjeve” të ndryshuar, neni 15, pika 5 “Rregullimi i pagave“, rregullat e prokurimit publik, si dhe Rregullores së Brendshme të Institucionit të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale Lushnje (IEVP) me nr.5393/1 Prot, datë 22.06.2010, neni 5, pika 1 “Drejtori”.
- Nga ana e Titullarit të AK/IEVP-së, Lushnje respektiv, është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr.10032, datë 11.12.2008 “Për policinë e burgjeve”, i ndryshuar, neni 15 “Rregullimi i pagave”, pika 5, iv) Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, si dhe në kundërshtim me detyrat funksionale, sikurse përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të Institucionit të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale Lushnje (IEVP) nr.5393/1, datë 22.06.2010, neni 5, pika 1 “Drejtori”.

Kontratat e shërbimit, në zbatim të Marrëveshjes Kuadër, të lidhura ndërmjet Institucionit të IEVP-së dhe Shoqërisë “D-2” shpk, të cilat janë hartuar dhe konceptuar nga Sektori Ligjor, rezultojnë të jenë zbatuar nga ana e Institucionit të IEVP Lushnjë/strukturat përgjegjëse në kundërshtim me detyrimet kontraktuale, referuar Marrëveshjes Kuadër nr.1/57, datë 29.03.2021, neni 4, “Grafiku i ekzekutimit të kontratës”, pjesë integrale e kontratës; ii) përcaktimet e Dokumenteve Standarte të Tenderit/Shtojca 10 “Shërbimi dhe Grafiku i Ekzekutimit” të Marrëveshjes Kuadër me nr.1/57 datë 29.03.2021, si dhe detyrat funksionale, sikurse përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të Institucionit të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale Lushnje (IEVP) me nr.5393/1, datë 22.06.2010, neni 8, pika 1 dhe pika 2, gërma “a”, “b” dhe “i”.

- Shoqëria “xx” shpk, me administrator z.xx, në cilësinë e Operatorit Ekonomik, të kontraktuar për kryerjen e shërbimit “Transporti i punonjësve të IEVP Lushnjë”:
- Nga ana e subjektit kontraktor, Shoqëria “xx” shpk, është vepruar në kundërshtim me:
 - i) grafikun e lëvrimit, pjesë integrale e kontratës; ii) përcaktimet e Dokumenteve Standarte të Tenderit/Shtojca 10 “Shërbimi dhe Grafiku i Ekzekutimit” të Marrëveshjes Kuadër me nr.1/57 datë 29.03.2021, neni 4, “Grafiku i ekzekutimit të kontratës”, si dhe;
 - iii) të Kontratave të shërbimit: a) nr.1/58 Prot, datë 29.03.2021; b) nr.1/71 Prot, datë 10.01.2022; c) Amendim i Marrëveshjes Kuadër nr. 1/57 Prot, datë 29.03.2021, Kontratë shërbimi nr.1/76 Prot, datë 09.12.2022, si dhe; d) Kontratë shërbimi nr.1/78 Prot, datë 24.01.2023, paragrafi VII “Çmimi dhe Pagesa”, pika 7.1” Formulari i ofertës ekonomike”.

- Për muajin Janar 2022 dhe Shkurt 2022, referuar situacioneve dhe faturave tatimore të lëshuar nga Shoqëria “xx” shpk rezulton se, nuk është përcaktuar numri i ditëve për shërbimin e kryer “Për transportin e administratës dhe trupës policore”, në referencë të grafikut të lëvrimit, pjese integrale e kontratës;
- Për muajin Janar 2022, rezulton se numri i ditëve të situacionuara për shërbim transporti, është për më pak për 9 (nëntë) ditë kalendarike sikurse përcaktuar në grafikun e lëvrimit, pjese integrale e kontratës, si dhe në ofertën fituese.
- Për periudhën e shërbimit të kryer periudha Mars 2022-Mars 2023, rezulton se Faturat tatimore të lëshuara janë në mosrespektim të Marrëveshjes Kuadër me nr.1/57, datë 29.03.2021, neni 4 “Grafiku i ekzekutimit të kontratës” si dhe neni 8 “Detyrimet e veçanta të Kontraktuesit”, si dhe të Minikontratës nr.1/71, datë 10.01.2022 paragrafi VII “Çmimi dhe Pagesa”, pika 7.1” Formulari i ofertës ekonomike” (nuk dokumentojnë/specifikojnë shërbimin e kryer/transport sipas ditëve respektive (ditë jave, e shtunë dhe e diel).
- Në të gjitha kontratat e shërbimit të lidhura ndërmjet IEVP-së dhe Subjektit, sa më lart përmendur, rezulton se në përmbajtjen e tyre mungon specifikimi/numër raste për ditë feste dhe data respektive.
- Vlera prej 2 663 516 lekë, përfaqëson faturimin tepër të shërbimit të transportit nga Shoqëria “xx” për numër punonjësish më shumë se numri i përcaktuar në grafikun e lëvrimit, periudha Prill 2021-Mars 2023 si dhe likujduar më tepër nga ana e strukturave përgjegjëse të IEVP-së Lushnjë, në kundërshtim me kërkesat e: i) Marrëveshjes Kuadër me nr.1/57, datë 29.03.2021, si dhe përcaktimeve të Kontratave të shërbimit, neni respektiv “Grafiku i ekzekutimit të kontratës”, si dhe kërkesat specifike të Dokumentave Standarte të Tenderit/Shtojca 10 “Shërbimi dhe Grafiku i Ekzekutimit”, vlerësohet përfitim i padrejtë nga ana e Kontraktorit dhe përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.
- ❖ Lidhur me zbatimin e ligjshmërisë në përcaktimin e normativave të harxhimit dhe përdorimit të karburantit, të llojit naftë/benzinë për mjetet e transportit në gjendje pune/ose me difekt të Institucionit IEVP, Lushnje, periudha 01.04.2021 deri në 31.07.2021, si dhe për periudhën 01.04.2022 deri në 31.07.2022 (me përzgjedhje).
- Mbi planifikimin dhe realizimin e fondeve buxhetore për blerje karburanti të llojit naftë/benzinë.
- Nga ana e strukturave përgjegjëse të IEVP Lushnje (Sektori i Financës dhe Sektori ligjor), rezulton të mos jenë planifikuar dhe realizuar fonde/shpenzime buxhetore, në strukturën buxhetore Artikullin 602 “Shpenzime të tjera operative”, nën artikullin 60020 “Mallra dhe shërbime të tjera” dhe në veçanti për zërin “Blerje karburanti”, të llojit “Naftë” dhe “Benzinë” për aktivet respektive në inventar dhe në përdorim të saj. Referuar “Evidencës së shpenzimeve buxhetore”/Situationit të shpenzimeve buxhetore, si dhe Regjistrin të parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike, për vitin 2021 (Prill-Korrik 2021) si dhe për vitin 2022 (Prill-Korrik 2022).

Për periudhën objekt inspektimi (Prill-Korrik 2021 dhe Prill-Korrik 2022), dokumentohet se:

- Furnizimi me karburant të llojit “Naftë” dhe “Benzinë” për IEVP Lushnje, realizohet nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, referuar Fletë daljeve respektive dhe Fletë hyrjeve të magazinës së IEVP Lushnje, sikurse trajtuar në vijim.
- Mbi inventarin e mjeteve të transportit të IEVP-së, Lushnje:
Nga ana e strukturës përgjegjëse për financat dhe Komisionit të inventarizimit ndër vite dhe në veçanti të vitit 2022:
 - Dokumentohet që mjetet e transportit/aktive në inventarin e institucionit, kanë një moshë mesatare prej 21.6 vite, në referencë të vitit të prodhimit, vitit të daljes jashtë funksionit dhe deri më sot.
 - Nuk dokumentohet numri i saktë i aktiveve “Mjete transporti” në inventarin kontabël dhe fizik të IEVP-së, duke mos përfshirë në kontabilitet mjetin tip “Fiat”, me targë Policia 0797, në referencë të procesit të inventarizimit të kryer në fund të vitit 2022 si dhe të fotove të bëra më datë 31.05.2023
 - Nuk dokumentohet propozimi dhe vlerësimi për nxjerrje jashtë përdorimi të mjeteve të transportit ndër vite, me statusin “Jashtë funksionit”, në referencë të të dhënave të Fletës së inventarit të Aktiveve Afatgjata Materiale (AAM) si dhe llogarisë inventariale 215 “Mjete transporti”.
 - Nuk dokumentohet dokumentacion ligjor justifikues për daljen jashtë funksionit për mjetin tip “Mitsubishi” me targë Tr 15 19 G në muajin janar 2022 dhe për mjetin tip “Mercedes Benz” me targë NO 803739 në muajin korrik 2022 si dhe për mjetin tip “Ëolsvagen” me targë Policia 0707 në muajin prill 2023, ndërkohë që në referencë të fotove të bëra më datë 31.05.2023, gjendja teknike/fizike e tyre tregon statusin jashtë funksionit më para periudhave të konfirmuara nga ana e IEVP Lushnje.
 - Nuk dokumentohet dalje jashtë përdorimit për mjetet e transportit me statusin “Jashtë funksionit” ndër vite si dhe në veçanti në vitin 2022, në referencë të Pasqyrës financiare “Gjendja e aktiveve dhe ndryshimet e aktiveve (Vlera neto)” të bilancit të vitit 2022.
- Mbi përcaktimin e normativave të harxhimit dhe përdorimit të karburantit, të llojit naftë/benzinë për mjetet e transportit në gjendje pune/ose me difekt të Institucionit IEVP, Lushnje:
 - Për mjetet e transportit në inventar dhe përdorim nga ana e IEVP Lushnje, normativa e harxhimit të karburantit për 100 km të përshkuara i referohet normativës së përcaktuar për një periudhë gati 18 vjet, e për rrjedhojë, nga ana e strukturave përgjegjëse të IEVP Lushnje, nuk dokumentohet një përcaktim i ri/ përcaktimi për çdo vit i normativave të harxhimit të karburantit për mjetet e transportit, gjeneratorët dhe kaldajat, pasi këto aktive kanë një afat përdorimi gati 18 vjet në qarkullim, referuar akteve ligjore e nënligjore për këtë qëllim.

- Nuk dokumentohet që, nga ana e Titullarit/Titullarëve të IEVP Lushnje, sipas kohës respektive të ushtrimit të detyrës nga ana e Tij/Tyre të jetë urdhëruar ngritja e komisionit/grupit të punës për përcaktimin e normativës së harxhimit të karburantit të llojit naftë për 1 (një) orë pune, për aktivin "Gjenerator", e për rrjedhojë nuk dokumentohet praktika shkresore zyrtare lidhur me përcaktimin e normativës së harxhimit të karburantit për 1 (një) orë pune për 3 (tre) Gjeneratorët në administrim dhe përdorim nga ana e IEVP Lushnje.
- Nuk dokumentohet, që nga ana e Titullarit/Titullarëve të IEVP Lushnje, sipas kohës respektive të ushtrimit të detyrës nga ana e Tij/Tyre të jetë urdhëruar ngritja e komisionit/grupit të punës për përcaktimin e normativës së harxhimit të karburantit të llojit naftë për 1 (një) orë pune, për aktivin "Kaldaja nr.1" dhe "Kaldaja nr.2", e për rrjedhojë nuk dokumentohet praktika shkresore zyrtare lidhur me përcaktimin e normativës së harxhimit të karburantit për 1 (një) orë pune për Kaldajat në administrim dhe përdorim nga ana e IEVP Lushnje.
- Mbi përdorimin e karburantit të llojit/Naftë:
Nga ana e IEVP Lushnje/Strukturave përgjegjëse, lidhur me administrimin dhe mirë përdorimin e vlerave materiale/karburant i llojit "Naftë" dhe "Benzinë", rezulton se:
 - Për mjetet e transportit të tipeve dhe markave të ndryshme në përdorim/gjendje pune, me konsum të karburantit të llojit "Naftë" dhe "Benzinë", dokumentohet që sasia e karburantit gjendje më 31.03.2021 dhe më 31.07.2021, nuk rakordon me sasinë e karburantit sipas depozitave/sebratorëve të tyre/afro 60 litra secili mjet, pra dokumentimi i sasisë së karburantit gjendje sipas datave si më sipër, është mesatarisht 7.7 herë më shumë, ndërsa për Gjeneratorët është 18 herë më shumë.
 - Për mjetet e transportit të tipeve dhe markave të ndryshme në përdorim/gjendje pune, me konsum të karburantit të llojit "Naftë" dhe "Benzinë", dokumentohet që sasia e karburantit gjendje më 31.03.2022 dhe më 31.07.2022, nuk rakordon me sasinë e karburantit sipas depozitave/serbratorëve të tyre/afro 60 litra secili mjet, pra dokumentimi i sasisë së karburantit gjendje sipas datave si më sipër, është mesatarisht 4.8 herë më shumë, ndërsa për Gjeneratorët është 15.5 herë më shumë.
 - Për periudhën Prill-Korrik 2021 dhe Prill-Korrik 2022, nuk dokumentohen librat e magazinës/kartelat dyfishe (Magazinë-Sektori i Prapavijës/Sektori i Financës) për çdo aktiv afatgjatë material (AAM), respektivisht: Për mjetet e transportit, Gjeneratorë të fuqive të ndryshme dhe Kaldajat, në inventar dhe përdorim nga ana e IEVP Lushnje, me qëllim dokumentimin e gjendjes në fillim të muajit, furnizimin gjatë muajit dhe gjendjen në fund të muajit të sasisë së karburantit/naftë dhe benzinë.
 - Për periudhën Prill-Korrik 2021, nga krahasimi i bërë për daljen e karburantit me sasinë e tërhequr sipas urdhër dorëzimeve/furnizimeve sipas mjeteve respektive, dokumentohet të jetë bërë dalje për më shumë në sasinë prej 17.99 litra naftë në vlerën 2 490.76 lekë (920-902.01).

- Për periudhën Prill-Korrik 2021, nga krahasimi i bërë për daljen e karburantit me sasinë e naftës sipas kilometrave të përshkuara nga mjetet e transportit, dokumentohet të mos justifikohet sasia e naftës prej 362.62 litra naftë në vlerën prej 50 205.82 lekë (920-557.38).
- Për periudhën Prill-Korrik 2022, nga krahasimi i bërë sipas Fletë daljeve të magazinës për sasinë e karburantit me sasinë e karburantit/naftë të furnizuar sipas urdhër dorëzimeve/ furnizimeve sipas mjeteve respektive, dokumentohet të jetë bërë dalje për më shumë në sasinë prej 30 litra naftë në vlerën 5 171.55 lekë (1787-1757).
 - Për periudhën Prill-Korrik 2022, nga krahasimi i bërë për daljen e karburantit me sasinë e naftës sipas kilometrave të përshkuara nga mjetet e transportit, dokumentohet të mos justifikohet sasia e naftës prej 62.22 litra naftë në vlerën 10 803 lekë (1 757-1694.78).
 - Nuk dokumentohet sasia e naftës në fillim të muajit Prill 2022 për mjetin e transportit Pol 0707, në përdorim nga ana e IEVP Lushnje.
- Mbi statusin e kilometrave të përshkuara nga mjetet në përdorim dhe në gjendje pune:
 - Nga ana e IEVP Lushnje/Strukturave përgjegjëse, lidhur me administrimin dhe mirë përdorimin e vlerave materiale/karburant i llojit “Naftë” dhe “Benzinë”, për mjetet e transportit në përdorim dhe gjendje pune, rezulton se: Për periudhën Prill-Korrik 2021 dhe Prill-Korrik 2022:
 - Nuk dokumentohet "Analiza e karburantit", nënshkruar nga ana e Përgjegjësit të Sektorit të Prapavijës/Logjistikës, si dhe nga ana e Specialistit të Burimeve Njerëzore/Specialistit të Financës/Me delegim të funksionit Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, me qëllim dokumentimin e sasisë së naftës gjendje në fillim muaji, sasinë e furnizuar gjatë muajit dhe sasinë gjendje në fund të muajit të këtij mjeti.
 - Nuk dokumentohet/en Urdhër/Urdhërat e lëvizjes të miratuara nga ana e Titullarit të IEVP Lushnje sipas datave të lëvizjes.
 - Nuk dokumentohet/en Autorizimi/Autorizimet e lëvizjes të miratuara nga ana e Titullarit të IEVP Lushnje sipas datave të lëvizjes.
 - Për mjetet në përdorim nga ana e përdoruesve të tyre për muajt respektiv:
 - Nuk dokumentohet Fletë udhëtimi për kilometrat e përshkuara nga ana e përdoruesve të mjeteve në përdorim dhe Përgjegjësi i Sektorit të Prapavijës/Logjistikës, si dhe nga ana e Specialistit të Burimeve Njerëzore/Specialistit të Financës/Me delegim të funksionit Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, me qëllim justifikimin e sasisë së karburantit/naftë & benzinë, të tërhequr.
 - Për mjetet në përdorim nga ana e përdoruesve të tyre për muajt respektiv, Fletë udhëtimi i paraqitur:
 - Nuk dokumenton sasinë e naftës, sipas datave të lëvizjes.
 - Nuk dokumenton nënshkrimin e personit udhëtues por mban nënshkrimin e përdoruesit të mjetit për kilometrat e përshkuara.
 - Nuk dokumenton sasinë e naftës të konsumuar për kilometrat e përshkuara.

- Nuk dokumenton përlogaritjet e kryera me qëllim justifikimin e sasisë së karburantit për kilometrat e përshkuara sipas normativës së harxhimit të karburantit/100 kilometra, si dhe nuk mban nënshkrimin e Përgjegjësit të Sektorit të Prapavijës/Logjistikës, si dhe nga ana e Specialistit të Burimeve Njerëzore/Specialistit të Financës/Me delegim të funksionit Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.

Për periudhën Prill-Korrik 2021 dhe Prill-Korrik 2022;

- Nuk dokumentohet, që urdhërat e dorëzimit/furnizimit me karburant të llojit naftë dhe benzinë të jenë konfirmuar/nënshkruar nga ana e Përgjegjësit të Sektorit të Financës, në referencë të kërkesave të urdhrit nr.737, datë 16.06.2021 “Mbi delegimin e autoritetit të funksionit të specialistit të shërbimeve deri në plotësimin e organikës”, germa “a”, pika 3, si dhe të kërkesave të urdhrit nr. 5330, datë 07.06.2010 “Për miratimin e rregullores së brendshme të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale Lushnje”, Kreu II “Organizimi dhe detyrat e strukturave përgjegjëse”, neni 9 “Sektori i Financës”, pika 1, pika 3.
- Nuk dokumentohet, që nga ana e Sektorit të Financës (Përgjegjësi i Sektorit dhe Specialisti i Financës), të jenë kryer kontrole lidhur me administrimin e dokumentacionit justifikues ligjor për përdorimin e karburantit/naftë/benzinë të furnizuar dhe konsumuar nga aktivet në përdorim dhe administrim të IEVP Lushnje, në referencë të kërkesave të urdhrit nr. 5330, datë 07.06.2010 “Për miratimin e rregullores së brendshme të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale Lushnje”, Kreu II “Organizimi dhe detyrat e strukturave përgjegjëse”, neni 9 “Sektori i Financës”, pika 1, pika 2/c.
- Nuk dokumentohen, që në bashkëlidhje të urdhër dorëzimeve/furnizimeve me karburant të llojit naftë dhe benzinë të jenë pamjet filmike/fotot e çdo mjeti transporti gjatë furnizimit të tyre, në referencë të kërkesave të Urdhrit nr.696, datë 07.06.2021 “Për procedurat e administrimit të vlerave materiale, karburantin, ushtrimit dhe detyrat e personave përgjegjës”, pika 4 dhe 14.
- Lidhur me miratimin e Urdhër dorëzimeve/furnizimeve me karburant të llojit naftë dhe benzinë për aktivet në përdorim, të IEVP, Lushnje:

Për periudhën Prill-Korrik, 2021 dhe Prill-Korrik 2022:

- Dokumentohet që urdhër dorëzimet/furnizimet me karburant të llojit naftë dhe benzinë për aktivet në përdorim, të IEVP, Lushnje të jenë nënshkruar dhe miratuar respektivisht nga:
 - Ish-Drejtori, në: 4 raste/Qershor 2021; 2 raste/Korrik 2021.
 - Zv/Drejtori, në: 3 raste/Prill 2022; 10 raste/Maj 2022; 7 raste/Qershor 2022; 8 raste/Korrik 2022.
 - Ish-Përgjegjësi i Sektorit të Prapavijës/Logjistikës, në: 6 raste/Prill 2021; 5 raste/Maj 2021.
 - Specialist në Sektorin e Burimeve Njerëzore/Me delegim të kompetencave të përgjegjësit të Sektit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, në 1 rast/Prill 2021; 2 raste/Korrik 2021; 7 raste/Prill 2022.

- Nuk dokumentohet nënshkrimi nga ana e personit përgjegjës i autorizuar, urdhër dorëzimi datë 01 dhe 31.07.2022, për të cilën është miratuar furnizimi me karburant nga ana e Magazinierit.
- Dokumentohet që atributet ligjore të Përgjegjësit të Sektorit të Prapavijës/Logjistikës, janë ushtruar nga Zv.Drejtori i IEVP Lushnjë, në kundërshtim me Urdhërat respektivë të lëshuara nga ana e Titullarit të IEVP-së, nr.737, datë 16.06.2021“Mbi delegimin e autoritetit të funksionit të specialistit të shërbimeve deri në plotësimin e organikës”, nr. 696 datë 07.06.2021“Për procedurat e administrimit të vlerave materiale, karburantin, ushtrimit dhe detyrat e personave përgjegjës”, si dhe nr.1308, datë 01.06.2022 “Për komandimin në detyrë në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve”.
- Mbi statusin e orëve të punës të kryera nga “Gjeneratorët” dhe “Kaldajat 1 dhe 2” në përdorim nga IEVP, Lushnje:
 - Për periudhën Prill-Korrik 2021, për aktivet: “Gjeneratorë” dhe “Kaldaja nr.1 dhe Kaldaja nr.2”, dokumentohet që këto aktive të mos kenë punuar apo të kenë konsumuar sasinë e karburantit të llojit naftë, referuar kartelës së punës së tyre.
 - Për periudhën Prill-Korrik 2022, për aktivin: “Kaldaja nr.1 dhe Kaldaja nr.2”, dokumentohet që këto aktive të mos kenë punuar apo të kenë konsumuar sasinë e karburantit të llojit naftë, referuar kartelës së punës së tyre.
 - Për periudhën Prill-Korrik 2022, për aktivin: “Gjeneratorë të fuqive të ndryshme”, dokumentohet që këto aktive të kenë punuar për 38.91 orë pune dhe të kenë konsumuar sasinë e karburantit të llojit naftë prej 469.726 litra, referuar kartelës së punës së tyre.
 - Nga ana e IEVP Lushnje/strukturave/personave përgjegjës:
 - Nuk dokumentohet një proces verbal i nënshkruar ndërmjet palëve (Personi/personat përgjegjës për Gjeneratorët dhe personave të regjimit të brendshëm të IEVP-së), ku të dokumentohet ndërprerja e energjisë elektrike nga ana e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSSHE), ora e vënies dhe ndërprerjes së punës së gjeneratorëve, me qëllim ruajtjen e sigurisë në ambientet e IEVP Lushnje, në referencë të Urdhrit nr. 1419, datë 10.02.2021 “Për limitet e harxhimit të karburanteve më automjete transporti, gjeneratorë, kaldajë për vitin 2021”, gërma B.1 “Përdorimi i karburantit për motor-gjeneratorët”.

Vlerën prej 267 197 lekë e cila përfaqëson, karburant të llojit naftë dhe benzinë, në mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor, për mjetet e transportit në inventar dhe përdorim nga IEVP-Lushnje, vlerësohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.

Konkluzion:

Nga ana Institucionit të IEVP-Lushnjë/Autoritet dhe strukturat përgjegjëse respektive, nuk janë menaxhuar me përgjegjshmëri fondet publike, referuar shkeljeve dhe parregullsive të konstatuara, duke sjellë për pasojë dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në vlerën prej 2 663 516 lekë, si dhe nuk janë menaxhuar me përgjegjshmëri fondet publike/administrimi i vlerave materiale (përdorimi i karburantit dhe llojit naftë dhe benzine), duke sjellë për pasojë dëm

ekonomik në buxhetin e shtetit, vlerësuar dëm solidar, nga personat shkakhtarë, në vlerën prej 267 197 lekë.

Institucioni i IEVP-Lushnje, për periudhën objekt inspektimi, e ka ushtruar veprimtarinë e vet në mungesë të funksionimit të kontrollit të brendshëm (komponentëve respektiv), duke ekspozuar Institucionin ndaj një dëmi ekonomik, në vlerën totale prej 2 930 713 lekë.

Në përfundim të inspektimit, Ministri i Financave ka urdhëruar/kërkuar:

- Masa shpërblim dëmi, 2 (dy)
- Masa administrative 1 (një)
- Masa rregullative, 13 (trembëdhjetë)
- Masa disiplinore, 14 (katërmbëdhjetë)

Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik, ka raportuar pranë Nëpunësit të Parë Autorizues mbi statusin e realizimit të masave, dhe vijon monitorimin e masave në proces zbatimi.

7. Në zbatim të Vendimit të Nëpunësit të Parë Autorizues nr.26, datë 11.05.2023 “Për fillimin e inspektimit financiar publik”, i ndryshuar, me objekt: “Zbatimi i ligjshmërisë për regjistrimet në Sistemin SIFQ të dokumentacionit financiar të shpenzimeve të kryera, të raportuara dhe të likujduara, periudha 13.01.2023-26.01.2023, për llogari të vitit 2022, nga strukturat përgjegjëse të Njësisë shpenzuese, Ministria e Kulturës, Kodi 1012001, si dhe; Verifikimi i dokumentacionit mbështetës ligjor, me zgjedhje për shpenzimet të cilat datojnë në vitin 2022 dhe janë likujduar në periudhën 13.01.2023-26.01.2023, nga Njësia shpenzuese, Ministria e Kulturës, Kodi 1012001”, u krye inspektim financiar publik, në subjektin: Ministria e Kulturës, nga ku u konstatua, për sa vijon:

Referuar të dhënave të Sistemit SIFQ, rezulton që gjatë periudhës 13.01.2023-26.01.2023, të jenë regjistruar në sistem 281 Urdhër shpenzime të Ministrisë së Kulturës, nën përgjegjësitë e Nëpunësit regjistruar, Nëpunësit Zbatues, Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit të Thesarit, në vlerën totale prej 236 951 830 lekë, respektivisht: Programi 01110/Aparati në vlerën prej 3 661 812 lekë; Programi 08220/Trashëgimia, në vlerën prej 43 621 381 lekë dhe Programi 08230/Arti , në vlerën prej 189 668 637 lekë.

❖ Ministria e Kulturës/strukturat përgjegjëse respektive:

- Përbërja e kolegjiemeve të ngritura referuar Urdhrave respektiv të Ministrit të Kulturës nr.887, datë 12.12.2022 dhe nr.863, datë 05.12.2022, nuk rezulton të ketë reflektuar kërkesat e Ligjit nr.10352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën”, i ndryshuar, neni 27, si dhe përcaktimet e Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm të Ministrisë së Kulturës, neni 48, pika 2.
 - o Në disa raste, Kryetari i Kolegjiomit, gjatë realizimit të procedurës së vlerësimit dhe të përzgjedhjes së projekteve fituese, ka ushtruar funksionin e Tij, në kushtet e

konfliktit të interesit (Kryetari i Kolegjiut rezulton të ketë mbajtur dhe atributet ligjore të Autoritetit kontraktor, si dhe të atij monitorues).

- Kontrata/Kontratat e lidhura ndërmjet palëve, nuk dokumentojnë të mbajnë nënshkrimin/siglimin e palëve respektive kontraktore në Aneksat pjesë integrale të këtyre kontratave, konkretisht: Aneksi 1 “Të dhënat e subjektit përfitues” dhe Aneksi 2 “Preventivi”.
- Nga ana e Ministrisë së Kulturës, rezulton të jenë lidhur kontrata me “individë”/Përfitues të projekteve artistike, në kundërshtim me kërkesat e: i) Ligjit nr.10352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën”, i ndryshuar, neni 26; ii) Udhëzimit të Ministrisë së Kulturës, për vitin 2022, “Seksioni se cilët mund të aplikojnë”; iii) Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, neni 40 “Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare”, si dhe; iv) Ligjit Nr.9723, datë 3.5.2007, i ndryshuar “Për Regjistrimin e Biznesit”, neni 22 “Detyrimi për regjistrim”.
- Nga ana e Ministrisë së Kulturës/strukturave përgjegjëse respektive, nuk janë përmbushur kërkesat e: i) Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Njesimi i Dokumenteve dhe vërtetimi i nënshkrimit”, neni 49 “Njehsimi i akteve të veta”; ii) Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat në RSH”, i ndryshuar/ “Normat teknike, profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në RSH”; iii) Vendimit nr.4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e Rregullores së njehsuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të RSH”; si dhe; iv) Rregullores së Brendshme të Institucionit, neni 44, pika 5, të miratuar me Urdhër 348, datë 18.09.2015, lidhur me qarkullimin e akteve administrative/dokumentave si: Vendime të Kolegjiut, Urdhër Ministri, Kontrata dhe pjesët integrale të tyre.
- Kontratat respektive të lidhura ndërmjet Ministrisë së Kulturës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe Përfituesve të Projekteve Artistike kanë vijuar të implementohen në mungesë të një Amendimi Kontrate, nënshkruar nga palët respektive.
 - o Nga ana e Përfituesve të Projekteve Artistike e Kulturore (në disa raste) rezulton se: Kërkesat e bëra “Për shtyrje afati”, në funksion të realizimit të projektit, të mos jenë kryer në rrugë zyrtare dhe protokollare, në mungesë të specimenteve protokollare të palëve kontraktore, në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, si dhe në mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale respektive; Këto kërkesa nuk përmbushin përcaktimet e Udhëzimit të Thirrjes për projekt propozimet, viti 2022, ku përcaktohet se, aktivitetet duhet të zhvillohen brenda afatit respektiv, sikurse përcaktuar në këtë Udhëzim.
- Nga ana e Ministrisë së Kulturës, struktura përgjegjëse për financën, rezulton të mos jenë mbajtur evidencat kontabël për Projektet Artistike, lidhur me rregjistrimin dhe kontabilizimin e detyrimeve financiare të krijuara gjatë vitit 2022, në kundërshtim me kërkesat e: Ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; ii) Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues dhe neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”; iii) Udhëzimit nr.34, datë

14.12.2022 “Për procedurat e mbylljes së llogarisë vjetore të buxhetit për vitin 2022”; si dhe iv) Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm të Ministrisë së Kulturës.

- ❖ Lidhur me monitorimin/strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollin e dokumentacionit ligjor justifikues pas faktit/struktura përgjegjëse për financën (Programi 01110/Aparati; Programi 08220/Trashëgimia, dhe Programi 08230/Arti):
 - Nga ana e Ministrisë së Kulturës, strukturat përgjegjëse monitoruese, referuar Raporteve finale të hartuara, rezultojnë se, në përmbajtje të tyre të mos kenë pasqyruar/reflektuar treguesit respektiv financiar, gjatë realizimit të Projekteve Artistike (referuar zërave apo veprimtarive që financohen, bazuar në Aneksin 2 Preventivi i Kontratës/Kontratave); Raportet finale nuk dokumentojnë hallkat miratuese apo adresim institucional.
 - Nga ana e Grupeve të monitorimit rezultojnë të mos jenë përmbushur detyrat funksionale të caktuara referuar urdhrave respektiv të Ministrit të Kulturës, lidhur me konfirmimin/nënshkrimin e situacionit/eve të projektit/Projekteve Artistike, dokument i cili, rezultojnë të jetë përcjellë pranë strukturës përgjegjëse për financën/Drejtoria e Financës.
 - Nga ana e Ministrisë së Kulturës, struktura përgjegjëse për financën, rezultojnë të jetë vijuar me likuidimet respektive ndaj subjekteve kontraktore, në cilësinë e Përfituesit/Përfituesve, në mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor si: i) listës emërore të palëve të treta përfituese (referuar Aktiviteteve/shërbimeve/koncerteve të realizuara) ii) pagesave të kryera nga ana e Përfituesit/ Përfituesve për llogari të palëve të treta, si dhe; iii) mos mbajtjes dhe derdhjes të tatimit në burim në masën 15%, pranë organeve tatimore, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 8 “Të ardhura të tatueshme”, gërma “e” si dhe të Kontratës/Kontratave respektive neni 6, pika 2.
 - Nga ana e Ministrisë së Kulturës, struktura përgjegjëse për financën, është vepruar në kundërshtim me kërkesat e kuadrit ligjor për kontabilitetin dhe pasqyrta financiare, të ndryshuar, si dhe të kuadrit ligjor për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të ndryshuar, si dhe atij nënligjor për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, lidhur me regjistrimin dhe kontabilizimin e detyrimeve debitorë të krijuara pranë Ministrisë së Kulturës për llogari të palëve paditëse, të detajuara sipas natyrës së shpenzimit/Objektit të Vendimit/ Shpenzimeve gjyqësore/Taksë/ Tarifë përmbartimore etj (referuar Vendimit/Vendimeve të organeve gjyqësore për kreditorët respektivë).
 - Nga ana e Ministrisë së Kulturës, struktura përgjegjëse për financën, rezultojnë se, për vitin 2022, të mos jenë evidentuar, dokumentuar dhe ngarkuar në sistem, vendimet gjyqësore respektive për vlerën totale të tyre, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr.37, datë 06.10.2020 “Monitorimi dhe publikimi periodik i stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme” .

- Për më tej, nga ana e Ministrisë së Kulturës/strukturat përgjegjëse, lidhur me egzekutimin e vendimeve gjyqësore, nuk administrohet fatura tatimore, lëshuar nga Zyra Përmbartimore (e cila në përmbajtje të saj të përmbajë tarifën përmbartimore përkatëse për shërbimin e ofruar për vitin buxhetor).
- ❖ Lidhur me Përfituesit: Programi 01110/Aparati; Programi 08220/Trashëgimia, dhe Programi 08230/Arti, konstatohet sa vijon:
 - Nga ana e Përfituesve të Projekteve Artistike, nuk janë zbatuar kërkesat e Ligjit “Për arkivat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nuk janë përmbushur detyrimet kontraktuale respektive, lidhur me dokumentacionin e paraqitur pranë Ministrisë së Kulturës, në cilësinë e Autoriteti Kontraktor si: Raport Financiar, Situacion, Raport Narrativ, i cili/të cilët rezultojnë të mos jetë/në përcjellë nëpërmjet Zyrës së Protokollit në Ministrinë e Kulturës; Ky dokumentacion rezultojnë të mos ketë marrë miratimin dhe konfirmimin nga Autoriteti Kontraktor, si dhe nga Sekretariati Teknik, në cilësinë e monitoruesit, referuar Urdhrave respektiv të Ministrit të Kulturës.
 - Nga ana e Përfituesve të Projekteve Artistike dhe Kulturore, nuk janë zbatuar kërkesat e: Ligjit Nr.92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu IV/Seksioni 1, neni 86 dhe neni 99 “Momenti i lëshimit të faturës”, pika 2, lidhur me lëshimin e faturës/faturave tatimore të shitjes, ekstremitetet e të cilës/cilave, nuk përputhen me datën e zhvillimit të aktivitetit.
 - Nga ana e Përfituesve të Projekteve Artistike dhe Kulturore, rezultojnë që, dokumentacioni financiar i paraqitur nga ana e tyre në funksion të justifikimit të shpenzimeve të kryera, për zërat e financuara nga Ministria e Kulturës, në cilësinë e Financuesit, të mos jenë në versionin origjinal apo kopjo e noterizuar si dhe në disa raste në mungesë të kuponit tatimor (kasë fiskale) për blerjet me lekë në dorë/Cash.

Për sa më lart:

- Nga ana e Ministrisë së Kulturës, struktura përgjegjëse për financën, rezultojnë që, për Kontratën e shërbimit nr.1137/8 Prot, datë 17.03.2022 me objekt “Mirëmbajtje e kamerave të vëzhgimit të Ministrisë dhe Institucioneve të varësisë”, të jetë likuiduar për më tepër subjekti kontraktor/OE “xxx”, në vlerën 147 895 lekë (përfitim i padrejtë), vlerësuar dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, në kundërshtim me përcaktimet e: i) Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e Nëpunësit Autorizues” dhe neni 12, dhe “Përgjegjshmëria menaxheriale e Nëpunësit Zbatues; ii) Udhëzimit nr.30 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 35, 36, 44 e 45, si dhe; iii) Udhëzimit nr.2, datë 19.01.2022 “Për përdorimin e arkivës elektronike në procesin e ekzekutimit të buxhetit të shtetit nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

- Ministria e Kulturës/struktuar përgjegjëse të saj për: Programin 01110/Aparati, Programin 08220/Trashëgimia, dhe Programin 08230/Arti, ka kryer likujdime për llogari të Përfituesve respektiv, në mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor (dokumentimit të transfertës bankare, të kryer nga këta të fundit për llogari të palëve të treta për çdo shërbim të kontraktuar), në kundërshtim me kërkesat e: i) Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 4, pika 19; ii) Ligjit nr.25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; iii) Udhëzimit nr.34, datë 14.12.2022 “Për procedurat e mbylljes së llogarisë vjetore të buxhetit për vitin 2022”, Kreu IV, pika 23, Kreu V, pika 33 dhe pika 34; iv) Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit“, pika 79 “E drejta për të kryer shpenzime ; si dhe, v)Kontratat e lidhura ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe subjekteve kontraktorë, në cilësitë e Përfituesit/Përfituesve.
- Veprimet dhe mosveprimet e strukturave respektive përgjegjëse në Ministrinë e Kulturës, në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, sa më lart përmëndur, kanë ekspozuar buxhetin e shtetit ndaj një efekti financiar negativ, në vlerën prej 30 563 433 lekë.

Në përfundim të inspektimit, Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka urdhëruar/kërkuar:

- Masë shpërblim dëmi, 1 (një)
- Masa administrative 2 (dy)
- Masa disiplinore, 12 (dymbëdhjetë)
- Masa rregullative, 13 (trembëdhjetë)

Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik, ka raportuar pranë Nëpunësit të Parë Autorizues mbi masat e ezauaruara dhe vijon monitorimin e masave në proces zbatimi.

Nga ana e subjekteve është raportuar mbi statusin e zbatimit të masave të lëna. Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik, ka raportuar pranë Nëpunësit të Parë Autorizues mbi masat e ezauaruara dhe vijon monitorimin e masave në proces zbatimi.

8. Në zbatim të Vendimit të Nëpunësit të Parë Autorizues nr.43 Prot, datë 29.06.2023 “Për fillimin e inspektimit financiar publik” i ndryshuar me objekt: i) “Zbatimi i ligjshmërisë në zbatimin e Kontratës së Punës nr.450 Prot, datë 21.02.2022 “Rikonstruksioni i Qendrës Multifunkionale Aliko”, të amenduar, të lidhur ndërmjet Bashkisë Finiq, përfaqësuar nga Z.xx, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe shoqërisë “xxx” shpk, përfaqësuar nga z.xx, në cilësinë e Administratorit të shoqërisë dhe ii) “Zbatimi i ligjshmërisë në zbatimin e kontratës së punës nr.451 Prot, datë 21.02.2022, lidhur ndërmjet Bashkisë Finiq, përfaqësuar nga z.xx, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe shoqërisë “xxxx” shpk, përfaqësuar nga zz.xx, në cilësinë e Administratorit të shoqërisë”, u krye inspektim financiar publik në subjektet: Bashkia Finiq/Strukturat përgjegjëse, Shoqëria “xxx” shpk, në cilësinë e Sipërmarrësit të Punimeve, si dhe Shoqëria “xxx” shpk, në cilësinë e

Projektuesit dhe Mbikëqyrësit të Punimeve, nga ku u konstatua për sa vijon:

- Më datë 09.12.2019, në Prevezë, Greqi, është lidhur një Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet përfituesit kryesorë, Bashkisë së Prevezës (Lead Partner/LP) dhe 2 përfituesve të tjerë të Projektit, konkretisht: Bashkia Finiq (Project Beneficiary (PB) no.2), përfaqësuar nga z.K K, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë, dhe Universiteti i Janinës (Project Beneficiary (PB) no.3); Akronimi i Projektit “Solis”; Emri i plotë i Projektit: “Cross-Border-Cooperation for energy efficiency”.
- Vlera e projektit/Buxheti i Projektit, si dhe shpenzimet e njohura për përfituesin (neni 9), për Bashkinë Finiq (neni 9), rezultojnë të jenë: Totali i shpenzimeve të njohura/Total eligible cost = 828 952.23 Euro, përkatësisht: i) 704 609.40 Euro nga Buxheti i BE-së, si dhe; ii) 124 342.83 Euro nga Buxheti kombëtar i Përfituesit.
- Në datën 12.12.2019 rezultojnë të jetë nënshkruar Marrëveshja e Subvencionit “Interreg IPA Cross-border Cooperation Programme “Greece- Albania 2014-2020”/Subsidy Contract No. A4-1.3-6, ndërmjet Autoritetit të Menaxhimit për objektivin “Programit Evropian për Bashkëpunim Territorial, të Ministrisë për Zhvillim dhe Investimet, në cilësinë e Autoritetit Menaxhues të Programit Ndërkufitar të Bashkëpunimit Greqi-Shqipëri, 2014-2020”, të përfaqësuar nga ana e Sekretariatit të ERDF, CF dhe ESF Program, në Ministrinë e Zhvillimit dhe Investimeve, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe Bashkisë së Prevezës, në cilësinë e Përfituesit kryesor/Lead Beneficiary, të Projektit “Bashkëpunimi ndërkufitar për efikasitetin e energjisë duke përdorur energjinë diellore”, shkurtimisht projekti “Solis”.
 - Përfituesi kryesor (Bashkia Prevezë) merr përsipër detyrimin të zbatojë projektin në bashkëpunim me përfituesit e mëposhtëm: i) Bashkia Finiq, Rrethi Sarandë/Qarku Vlorë, Përfituesi i dytë; si dhe; ii) Universiteti i Janinës, Përfituesi i tretë (referuar nenit 1/1.3 të kësaj kontrate).
 - Totali i buxhetit për projektin i aprovuar bazuar në Vendimin e Komitetit të Përbashkët të Monitorimit, rezultojnë në vlerën prej 1 932 686.23 Euro dhe konkretisht për Bashkinë Finiq/Përfituesi nr.2, rezultojnë në vlerën prej 828 952.23 Euro, nga të cilat: i) vlera prej 704 609.40 Euro nga buxheti i BE-së, si dhe; ii) vlera prej 124 342.83 Euro nga buxheti kombëtar i përfituesit (referuar nenit 1/1.4 të kësaj kontrate).
 - Periudha e implementimit të projektit nuk duhet të kalojë datën 31.12.2023 (neni 2/2.1).
- ❖ Mbi zbatimin e Kontratës nr.450 Prot, datë 21.02.2022 (Kushtet e Përgjithshme të Kontratës/KPK dhe Kushtet e Veçanta të Kontratës/KVK), të lidhur ndërmjet Bashkisë Finiq, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, dhe shoqërisë “xxx” shpk, në cilësinë e Sipërmarrësit të punimeve të ndërtimit:
 - Në bashkëlidhje të Kontratës dokumentohen: i) Përshkrim i përgjithshëm i projektit (volume I, i dosjes së tenderit); ii) Përshkrimi teknik i projektit (volume I, i dosjes së tenderit); iii) Tabelat që referojnë punimet sasiore; iv) Skicimet teknike; v) Oferta financiare e aprovuar; vi) Kushtet e përgjithshme (KPK) dhe Kushtet e veçanta të kontratës (KVK).

- Nuk dokumentohet, që kjo Kontratë pune të jetë nënkontraktuar tek palë të treta.
- Kontrata nr.450 Prot, datë 21.02.2022, rezulton të jetë lidhur në mungesë të sigurimit të kontratës, në masën 5% të vlerës totale të kontratës, përkatësisht në vlerën prej 4 689 870.89 lekë, ose në vlerën 38 441.56 Euro, vlerë e cila vlerësohet dem ekonomik në buxhetin e shtetit.
- Në referencë të nenit 46 të KPK dhe nenit 27 i KVK “Parafinancimi”/“Pre-financing”, përcaktohet se, parafinancimi do të jetë në masën prej 15% e vlerës totale të kontratës, e cila përkon me vlerën prej 14 069 612.55 lekë.
- Për Kontratën bazë nr.450 Prot, datë 21.02.2022, rezulton të jenë kryer 3 (tre) Amendime (neni 37 i KPK), të cilat kanë konsistuar në shtyrjen e afatit të realizmit të punimeve të ndërtimit: i) Amendimi nr.1, datë 21.10.2022 (protokolluar në Bashkinë Finiq nr.2821 Prot, datë 21.10.2022) ka shtyrë afatin e përfundimit të punimeve të ndërtimit, deri më datë 20.03.2022; ii) Amendimi nr.2, datë 21.03.2023 ka shtyrë afatin e përfundimit të punimeve të ndërtimit deri më datë 28.06.2023; Ky amendim, nuk dokumentohet të jetë protokolluar në Bashkinë Finiq dhe për më tej, pranë dy subjekteve kontraktore, si dhe; iii) Amendimi nr.3, datë 21.08.2023, ka shtyrë afatin e përfundimit të punimeve të ndërtimit deri më datë 31.10.2023; Ky amendim rezulton të jetë nënshkruar nga palët respektive për rreth 2(dy)-muaj me vonesë, nga data e përfundimit të Amendimit nr.2, që përkon më datën 28.06.2023, si dhe rreth 3(tre) muaj me vonesë nga marrja e Njoftimit nga Autoriteti Menaxhues, lidhur me miratimin e afatit të përfundimit të punimeve të ndërtimit, deri më datë 31.10.2023, në kundërshtim me kërkesat e nenit 35 “Zgjatja e periudhës së implementimit të punimeve”; Ky amendim është vënë në dispozicion për grupin e inspektimit me shkresën e Bashkisë Finiq nr.2079 Prot datë 06.09.2023, protokolluar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr.5681/17 Prot, datë 11.09.2023.
- + Shkresa nr.236/1 Prot, datë 22.06.2023, protokolluar në Bashkinë Finiq nr.1331 Prot, datë 22.06.2023 me anë të së cilës shoqëria “xxx” shpk, në cilësinë e Sipërmarrësit të punimeve të ndërtimit, ka kërkuar shtyrje të afatit të punimeve, për një periudhë 2-mujore, e cila përkon nga data 28.06.2023-28.08.2023, nuk përmbush kërkesat e nenit 35 “Extension of the period of implementation of tasks”/“Zgjatje e periudhës së implementimit të punimeve” të KPK.
- + Shkresa nr.236/1 Prot, datë 22.06.2023, daton 6 (gjashtë) ditë para përfundimit të punimeve, si dhe nuk rezulton t’i jetë drejtuar shoqërisë “Studio xx” shpk, në cilësinë e Mbikqyrësit të punimeve të ndërtimit, në kundërshtim me kërkesat e nenit 35 të KPK, nën-pika 35.1, 35.2, dhe 35.3.

Për sa më lart:

- Amendimet e kryera rezultojnë të kenë marrë miratimin paraprak nga Autoriteti Menaxhues (Projekti për Interregy IPA Autoritetit Menaxhues të Programit Ndërkufitar të Bashkëpunimit Greqi-Shqipëri, 2014-2020), e për më tej, nga ana e Sekretariatit të Përbashkët/Joint Secretariat (referuar korespondencës elektronike të mbajtur)/me

- përjashtim të Amendimit nr.3 datë 21.08.2023, i cili nuk dokumenton miratimin e dhënë nga ana e Sekretariatit të Përbashkët/Joint Secretariat.
- Për Amendimet e kryera, nuk dokumentohet që nga ana e shoqërisë “xxx” shpk, në cilësinë e Mbikqyrësit të punimeve të ndërtimit, të jetë bërë një vlerësim për arsyet e parashtruara nga ana e shoqërisë “xxx” shpk, në cilësinë e Sipërmarrësit të punimeve të ndërtimit, lidhur me kërkesën për shtyrje të afatit të punimeve, në kundërshtim me kërkesat e kontratës së punës nr.450 Prot, datë 21.02.2022, neni 35/35.3 “Zgjatja e afatit të punimeve të ndërtimit”/“Extensions of the period of implementation of tasks”.
 - Për Amendimet e kryera nga ana e shoqërisë “xxx” shpk, në cilësinë e Sipërmarrësit të punimeve të ndërtimit, nuk është përmbushur detyrimi kontraktual, sikurse përcaktuar në kontratën e punës nr.450 Prot, datë 21.02.2022, neni 15 i KPK dhe neni 10 i KVK “Sigurimi i Kontratës”/“Performance guarantee”.
 - Nga ana e Shoqërisë “xxx” shpk, në cilësinë e Sipërmarrësit të punimeve të ndërtimit, nuk dokumentohet që të jetë kryer sigurimi i kontratës në masën 5 % të vlerës totale të kontratës, në vlerën prej 4 689 870.89 lekë, ose në vlerën 38 441.56 Euro, në formën e garancisë bankare pranë një operatori bankar ose pranë një kompanie/shoqërie sigurimi, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin shqiptar, në kundërshtim me kërkesat e nenit 15/15.2/15.3 të KPK dhe nenit 10 të KVK.
 - Me shkresën datë 10.05.2022 “Akt dorëzimi i sheshit të ndërtimit”, dokumentohet dorëzimi i sheshit të ndërtimit lidhur me objektin: “Rikonstruksioni i Qendrës Multifunkionale Aliko”, nënshkruar nga palët respektive.
 - Fillimi i punimeve lidhur me objektin: “Rikonstruksionin e Qendrës Multifunkionale Aliko”, përkon me datën 10.05.2022, referuar proces verbalit të mbajtur, datë 10.05.2022 “Mbi fillimin e punimeve”, nënshkruar nga palët respektive.
 - Nga data 28.06.2023, datë e cila përkon me përfundimin e punimeve të ndërtimit, Bashkia Finiq/strukturat përgjegjëse, nuk dokumentojnë të kenë ndërmarrë hapat respektivë ligjorë, sikurse përcaktohet në këtë kontratë, si dhe nuk dokumentohet asnjë korespondencë zyrtare lidhur me ecurinë e projektit/realizimin e tij.
- ❖ Lidhur me likuidimin e kontratës nr.450 Prot, datë 21.02.2022:
- Kontrata nr.450 Prot, datë 21.02.2022, e amenduar, lidhur ndërmjet palëve respektive, sa më lart përmendur, ka përcaktuar në Volume 2/Section 1, pika 4: “Autoriteti Kontraktor bie dakort të paguajë Sipërmarrësin, sikurse përmendet në këtë kontratë..., në referencë të përmbushjes/përfundimit të punimeve dhe të riparimit të difekteve, në referencë të detyrimeve kontraktuale, sipas ndarjes: i) Kontrata e punës (duke përjashtuar Tvsh) 78 164 514.69 lekë; ii) Kontrata e punës (përfshirë Tvsh) 93 797 417.62 lekë; si dhe; iii) “...Tvsh si dhe taksat e tjera nuk mbulohen nga fondet e BE; (Tvsh mbulohet nga kontributi i Qeverisë Shqiptare/Buxheti i shtetit)”.
 - Më datë 08.04.2021, pranë Bankës së Shqipërisë, është transferuar vlera prej 140 863 Euro, ose në vlerën prej 17 169 897.11 lekë nga “B/O Preveza Transferta (multi), për

- llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila përfaqëson transhin e parë të disbursuar për Bashkinë Finiq, në cilësinë e Investitorit.
- Me shkresën nr.14641/1 Prot, datë 07.09.2021 “Kërkesë për transferim fondi” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (protokolluar në Bashkinë Finiq nr.2224/1 Prot, datë 09.09.2021), drejtuar Bankës së Shqipërisë, si dhe për djeni Bashkisë Finiq, rezulton se, për Projektin “Solis” të jetë transferuar vlera prej 140 863 Euro, ose në vlerën prej 17 169 897.11 lekë.
 - Nga ana e Bashkisë Finiq, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor/strukturat përgjegjëse, rezulton të jetë kryer pagesa për llogari të shoqërisë “xxx” shpk, në cilësinë e Sipërmarrësit të punimeve të ndërtimit, në vlerën prej 11 724 677 lekë, ose në vlerën prej 96,690.3 Euro, e cila përfaqëson paradhënie në masën 15% të vlerës totale të kontratës (fatura tatimore e shitjes/ elektronike nr.16/2022 datë 18.03.2022; në përshkrimin e faturës specifikohet “Paradhënie punimesh”), në referencë të transfertës bankare datë 28.03.2022/29.03.2022.
 - o Paradhënia në masën 15% të vlerës së kontratës bazë, rezulton të jetë në vlerën 14 069 612.55 lekë, respektivisht në vlerën prej 11 959 170.67 lekë, në masën 85 %, kontribut i BE dhe në vlerën prej 2 110 441.88 lekë (tvsh në masën 20 %), në masën 15%, kontribut i Qeverisë Shqiptare.
 - o Likuidimi i kryer nga ana e Bashkisë Finiq/struktura përgjegjëse, në vlerën prej 11 724 677 lekë (për më pak në vlerën prej 234 493.67 lekë), vlerë e cila përfaqëson “Paradhënien” në masën 15% të vlerës së kontratës, për llogari të Shoqërisë “xxx” shpk, në cilësinë e Sipërmarrësit të punimeve të ndërtimit, nuk ka respektuar raportet sikurse përcaktuar në marrëveshjen e partnershipit, e për më tej, përcaktimet kontraktuale, sa më lart trajtuar, lidhur me respektimin e raporteve (85% kontribut i BE-së dhe 15% kontribut i Qeverisë Shqiptare).
 - o Paradhënien e dhënë në vlerën prej 11 724 677 lekë, mbuluar nga kontribut i BE-së, në mungesë të sigurimit të kontratës, në masën 5% të vlerës totale të kontratës së amenduar, vlerësohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, në kushtet kur buxheti i shtetit tashmë është ekspozuar ndaj një riku të lart, lidhur me kthimin e fondeve tashmë të përthithura për projektin “Solis” nga Qeveria Shqiptare/Bashkia Finiq-Përfitues.

Për me tej:

- Me urdhër shpenzimit nr.78, datë 27.02.2023, rezulton të jetë kryer pagesa në vlerën prej 15 000 000 lekë, ose në vlerën 129 310 Euro, për llogari të shoqërisë “xxx” shpk, në cilësinë e Sipërmarrësit të punimeve të ndërtimit, me objekt shpenzimi “MoF për parafinacimin e projektit të huaj “Solis”/Rikonstruksioni i Objektivit Shkollor Multifunksional”, në strukturën buxhetore: Kod programi 1110; Llogaria ekonomike 231103; Kod projekti 90005 AB, në vlerën 15 000 000 lekë,

Vlerësohet:

- Urdhër shpenzimi nr.78, datë 27.02.2023, i paraprin kërkesa për çelje fondi nr.1771 Prot, datë 06.07.2022 në vlerën prej 124 342.83 Euro, vlerë e cila, i referohet narrativës: “Shuma e bashkëfinancimit”.
- Në fakt rezulton se, kjo pagesë i referohet kërkesës për Tvsh/paradhënie për vlerën totale të kontratës, pavarësisht se, urdhër shpenzimi në bashkëlidhje dokumenton: (Kontratën nr.450 Prot, datë 21.02.2022, Faturën tatimore të shitjes/elektronike nr.2/2023, datë 11.01.2023 në vlerën 24 224 676.67 lekë, pa tvsh dhe në vlerën 29 069 612 lekë, me tvsh, si dhe Situacionin pjesor nr.1, në vlerën prej 24 224 676.67 lekë, pa Tvsh dhe në vlerën 29 069 612 lekë, me Tvsh).
- Kërkesa dhe likuidimi i kryer për Tvsh/paradhënie për vlerën totale të kontratës, bie në kundërshtim:me: i) aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për Tvsh-në; ii) Marrëveshjen e patnershipit datë 12.12.2019; si dhe: iii) kontratën respektive nr.450 Prot, datë 21.02.2022, e amenduar, trajtuar hollësisht në Raportin e inspektimit financiar publik.
- Vlera prej 15 000 000 lekë, e cila përfaqëson pagesën për Tvsh paradhënie për vlerën totale të kontratës, ose në vlerën prej 124 342.83 Euro, vlerësohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.
- ❖ Lidhur me kërkesa të tjera për ndihmë financiare/Projekti “Solis”:
- Dokumentohet që, me shkresën nr.655 Prot, datë 20.03.2023 “Kërkesë për financim të Projektit “Solis” të ish-Kryetarit të Bashkisë Finiq/Njësia e Zbatimit të Projektit “Solis”, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Programit Strategjik dhe Kordinimit të Ndihmës (SASPAC), si dhe shkresën nr.655/2 Prot, datë 13.04.2023 “Kërkesë për financim të Projektit ”Solis”, është kërkuar respektivisht ndihmë në vlerën prej 300 000 Euro dhe në vlerën 145 911.74 Euro (vlerë e cila i referohet shpenzimeve të cilat do të raportohen së shpejti referuar përmbajtjes së kësaj shkrese).
- Të dy kërkesat e adresuara për SASPAC, referojnë në kërkesën e Bashkisë Finiq për “Parafinancim”.
- ❖ Lidhur me Kontratat e shërbimit të konsulencës të Projektit “Solis”:
- Nga ana e Bashkisë Finiq/Përfituese e fondeve të Projektit “Solis”, rezulton të jenë lidhur 3 (tre) kontrata me subjekte dhe persona të tretë, në cilësinë e Ekspertit të jashtëm, në vlerën totale prej 38 000 Euro dhe likuidimi për këto kontrata rezulton në vlerën prej 3 346 487 lekë, ose në vlerën prej 27 463.25 Euro, përkatësisht:
- Kontrata nr.s’ka, datë 12.04.2021 e lidhur me subjektin “xx” shpk, përfaqësuar nga Znj.M.K, me objekt: “Kontratë shërbimi me Ekspertin e Jashtëm, ËP1, ËP2, ËP5; “Solis” Cross -border cooperation for energy, efficiency using solar energy”, në vlerën prej 24 800 Euro dhe likuiduar në vlerën prej 22 320 Euro ose në vlerën prej 2 735 663 lekë;
- Kontrata nr.1094/4 Prot, datë 18.06.2021 e lidhur me znj.xx, Individ, me objekt: “Solis” Cross -border cooperation for energy efficiency using solar energy” në vlerën prej 6 200 Euro dhe likuiduar në vlerën prej 2,110.5 Euro ose në vlerën prej 284 158 lekë;
- Kontrata nr.34/2 Prot, datë 13.02.203 e lidhur me subjektin “xxx” shpk, përfaqësuar nga znj.S.M, me objekt: “Kontratë shërbimi me Ekspertin e Jashtëm ËP3, DEL 4.2.2

Monitoring Energy efficiency interventius“Solis” Cross-border cooperation for energy efficiency using solar energy”, në vlerën prej 7 000 Euro dhe likuiduar në vlerën prej 3 032.75 Euro ose në vlerën prej 326 676 lekë;

- Rezulton që pagesat respektive të kryera, për të 3 (tre) kontratat sa më lart trajtuar, kanë burim financimi diferencën e Transhit të Parë, disbursuar nga Bashkia Prevezë më datë 08.04.2021 për llogari të Bashkisë Finiq, Përfitues i Projektit “Solis”, në vlerën prej 5 445 220.84 lekë ose në vlerën prej 44 173.57 Euro.
- Likuidimet e kryera për këto kontrata janë bërë në mungesë të plotë të dokumentacionit ligjor justifikues, në kundërshtim me përcaktimet respektive, sikurse parashikuar në këto kontrata; Për Kontratën nr.s’ka, datë 12.04.2021 me subjektin “xxx” shpk, dhe Kontratën nr.1094/4 Prot, datë 18.06.2021 me znj.xx, Individ, janë konstatuar parregullsi, që kanë konsistuar ndër të tjera edhe në lidhje të paligjshme ndërmjet ofertuesve, për realizimin e ekspertizës për projektin “Solis”.
- Pagesat e kryera nga Bashkia Finiq/strukturat përgjegjëse për llogari të subjekteve dhe personave të tretë, në cilësinë e Ekspertëve të jashtëm, në vlerën prej 27 463.25 Euro, ose në vlerën prej 3 346 497 lekë, vlerësohen dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, e për më tej, vlera e kontratave të lidhura, në total prej 38 000 Euro vlerësohet efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit.

❖ Mbi verifikimin në terren për objektin: Rikonstruksioni i Qendrës Multifunktionale Aliko:

Nga krahasimi i Preventivit/Ofertë fituese/KPK dhe KVK të kontratës nr.450 Prot, datë 21.02.202, situacionit pjesor nr.1, Grafikut të punimeve, si dhe afatit të përfundimeve të punimeve të ndërtimit, të amenduar, rezulton:

- Nga 156 zëra punimesh të preventivuara/të kontraktuara, në vlerën prej 93 797 417.60 lekë, me Tvsh, rezulton që deri më datë 25.07.2023, të mos jenë realizuar 93 zëra punimesh në vlerën prej 64 727 813.30 lekë, ose në masën 69.11 %.
- Nga ana e shoqërisë “xxx” shpk, në cilësinë e Sipërmarrësit të punimeve të ndërtimit, Shoqërisë “Studio xx” shpk, në cilësinë e Mbikqyrësit të punimeve të ndërtimit, si dhe Bashkisë Finiq/Strukturat përgjegjëse, nuk janë respektuar kërkesat e KVK, dhe përkatësisht neni 23/23.1 “Rregjistri i punimeve”/“Ëork register“ dhe neni 24 “Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve”/“Origin and quality of eorks and materials”, si dhe kërkesat e KPK, përkatësisht neni 39 dhe neni 40.
- Nga ana e shoqërisë “xxx” shpk”, në cilësinë e Sipërmarrësit të punimeve të ndërtimit si dhe Shoqërisë “xx” shpk, në cilësinë e mbikqyrësit të punimeve të ndërtimit, nuk janë zbatuar:i) detyrimet kontraktore referuar kontratave respektive të lidhura ndërmjet palëve, ii) kërkesat e Aneksit 7.1-c2 të Marrëveshjes datë 12.12.2019, përkatësisht neni 8 dhe neni 14, iii) kërkesat e ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu “Projektimi, mbikqyrja, zbatimi dhe kolaudimi i punimeve të ndërtimit”, neni 7/paragrafi 2, neni 8/paragrafi 2, neni 10, si dhe; iv) kërkesat e Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 16.06.2011 “Për

mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar.

- Vlera prej 81 270 lekë, e cila përfaqëson zëra punimesh të pakryera, vlerësohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.

Për sa më lart: Nga ana e Bashkisë Finiq, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor/strukturat përgjegjëse, nuk janë zbatuar kërkesat ligjore, lidhur me monitorimin, ndjekjen, zbatimin dhe likuidimin e kësaj kontrate.

Në kushtet kur afati i përfundimit të kontratës nr.450 Prot datë 21.02.2022, të amenduar, ka mbaruar, si dhe në kushtet kur nuk rezulton që punimet e kryera nga ana e shoqërisë “xxx” shpk, në cilësinë e Sipërmarrësit të punimeve të ndërtimit të kenë përfunduar, duke cënuar në këtë mënyrë realizimin dhe përmbushjen e qëllimit të këtij projekti/kontrate, sikurse miratuar në Marrëveshjen e patneritetit datë 12.12.2019, vlerësohet se, Qeveria Shqiptare tashmë është e ekspozozuar ndaj riskut të mospërthithjes së fondeve në vlerën prej 563 745.53 Euro (kontribut i BE-së), si dhe për kthimin e vlerës së disbursuar në llogarinë e dedikuar në Bankën e Shqipërisë/paradhënie në vlerën prej 140 863.87 Euro (kontribut i BE-së), për llogari të Bashkisë Prevezë/ LB (në llogarinë respektive).

Në përfundim të inspektimit, Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka urdhëruar/kërkuar:

- Masa shpërblim dëmi 10 (dhjetë)
- Masa rregullative 7 (shtatë)
- Masa disiplinore 10 (dhjetë)
- Masa administrative 4 (katër)

Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik, ka raportuar pranë Nëpunësit të Parë Autorizues.do të vijojë me monitorimin e zbatimit të masave, pasi aktualisht çështja është në proces gjyqësor.

9. Në zbatim të Vendimit të Nëpunësit të Parë Autorizues 67, datë 18.09.2023 “Për fillimin e inspektimit financiar publik”, i ndryshuar, u krye inspektim financiar publik në subjektet: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Korçë (NSHP Korçë), në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe në Shoqërinë “xx” shpk, në cilësinë e Operatorit Ekonomik, nga ku u konstatua, për sa vijon:

- Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Gjellbërimit Korçë nuk ka menaxhuar me përgjegjshmëri planifikimin dhe përdorimin e fondeve buxhetore që lidhen me planifikimin dhe administrimin e “materialeve eklektike” që do të prokurohen, referuar parregullësive dhe shkeljeve ligjore, të trajtuara në Raportin e inspektimit financiar publik, në papërgjegjshmëri menaxheriale të ish-Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues, për mos kryerje të detyrave funksionale dhe veprimeve financiare të kryera në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi, si dhe grupit të planifikimit të “materialeve eklektike”, të cilët kanë planifikuar mbi nevojat reale të ndërmarrjes, me pasojë efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit.

- Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Gjellbërimit Korçë, në argumentimin e nevojave dhe në përlllogaritjen dhe përcaktimin e vlerës limit të kontratës/fondit limit, për procedurat e prokurimit me objekt “Materiale elektrike” nuk dokumentohet t’i jenë referuar gjendjes së mallrave në magazinë, trajtuar në Raportin e inspektimit financiar publik.
- Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Korçë/strukturat respektive, kanë vepruar në papërgjegjshmëri menaxheriale, në mosrespektim të parimeve të ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit, si dhe në kundërshtim me përcaktimet ligjore të trajtuara në këtë Raport të inspektimit financiar, veprime dhe mosveprime të cilat kanë sjellë për pasojë rritje të vlerës totale të Marrëveshjes Kudër dhe Minikontratave respektive, të lidhura ndërmjet Bashkisë Korçë në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe shoqërisë “xxx” shpk, në vlerën totale 9 342 378 lekë, e cila vlerësohet efekt financiar negativ për buxhetin e njësisë publike NJSHP Korçë.
- Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Gjellbërimit Korçë/strukturat përgjegjëse të saj ka vepruar në shkelje të rregullave të prokurimit publik, dhe konkretisht:
 - o Ndryshimet në Regjistrin e parashikimit të prokurimeve për vitin 2020 nuk shoqërohen me një relacion shpjegues dhe argumente mbi ndryshimet në zërat respektiv të Regjistrit, nga strukturat/autoritetet ligjore respektive, në kundërshtim me kërkesat e VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, nenit 4 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik”, pikës 4.
 - o Nga ana e njësisë së prokurimit dhe nga ana e personit përgjegjës (specialist i fushës) të ngarkuar për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit, nuk janë respektuar kërkesat e VKM-së nr.914, datë 28.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 59 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit”, të pika 2, gërma “a”.

Në përfundim të inspektimit, Ministri i Financave ka urdhëruar/kërkuar:

- Masa rregullative 4 (katër)
- Masa disiplinore 5 (pesë) masa

Nga ana e subjekteve është raportuar mbi statusin e zbatimit të masave të lëna. Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik, ka raportuar pranë Nëpunësit të Parë Autorizues mbi masat e ezauruara dhe vijon monitorimin e masave në proces zbatimi.

10. Në zbatim të Vendimit të Nëpunësit të Parë Autorizues nr.77, datë 06.10.2023 “Për fillimin e inspektimit financiar publik”, i ndryshuar, u krye inspektim financiar publik, me objekt inspektimi: “Zbatimi i ligjshmërisë për procedurat e kryera lidhur me kalimin e fondit prej 13 544 581 lekë, nga ana e shoqërisë aksionare “Porti detar” Sarandë, në shoqërinë aksionare “Duhan cigare” Shkodër, në shumën prej 13 544 581 lekë (referuar

3 (tre) vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme nr.49, datë 19.06.2019; nr.62, datë 30.07.2019 dhe; iii) nr.3, datë 09.01.2020), si dhe “Zbatimi i ligjshmërisë lidhur me destinacionin e përdorimit të fondit prej 13 544 581 lekë dhe përfituesve, nga ana e shoqërisë “Duhan Cigare” sh.a Shkodër”, në subjektet: Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike/strukturat përgjegjëse, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Shoqëria aksionare “Porti Detar” Sarandë dhe Shoqëria aksionare “Duhan cigare”, Shkodër, nga ku u konstatuar, për sa vijon:

Ministri i Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e Aksionerit të vetëm shtet për Shoqërinë “Porti Detar” Sarandë dhe të Aksionerit mazhoritar për Shoqërinë “Duhan cigare” Shkodër, me Vendimet e Asamblesë së Aksionerit (nr.49 datë 19.06.2019; nr.62 datë 30.07.2019, si dhe, nr.3 datë 09.01.2020) ka vendosur kalimin e fondeve në vlerën prej 13 544 581 lekë, nga Shoqëria aksionare “Porti Detar” Sarandë për Shoqërinë aksionare “Duhan cigare” Shkodër.

- ❖ Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike/ Drejtoria e Administrimit të Pronës Shtetërore, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, sot Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit:

Për periudhën objekt inspektimi rezulton që:

- Nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve rezulton të jenë marrë 3 (tre) Vendime, të cilat kanë konsistuar në kalimin e fondeve për shoqërinë aksionare “Duhan cigare” Shkodër: i) nr.49 Prot, datë 19.06.2019, në vlerën prej 1 778 079 lekë, ii) nr.62, datë 30.07.2019, në vlerën 9 766 502 lekë, si dhe, iii) nr.3, datë 09.01.2020, në vlerën prej 2 000 000 lekë.
- Nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, në referencë të këtyre vendimeve, është vendosur kalimi i fondit në vlerën totale prej 13 544 581 lekë, nga shoqëria “Porti Detar” Sarandë, për shoqërinë “Duhan cigare” Shkodër.
- Kërkesat për fonde, bërë nga shoqëria aksionare “Duhan cigare” Shkodër, nuk dokumentohet të jetë shqyrtuar paraprakisht në Këshillat Mbikëqyrës respektivë: i) Këshillin Mbikëqyrës të shoqërisë aksionare “Portit Detar” Sarandë, si dhe, ii) Këshillin Mbikëqyrës të shoqërisë aksionare “Duhan cigare” Shkodër, në mos përmbushje të kërkesave të Ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, “Këshilli i administrimit”, neni 154 “Të drejtat dhe detyrimet”, pika 1 “Këshilli i administrimit”, germa “ç”.
- Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, nuk kanë respektuar kërkesat ligjore, sikurse parashikuar në VKM-në nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qera, enfiotezë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”.

- Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, nuk kanë respektuar kërkesat ligjore, sikurse parashikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.570, datë 03.10.2018 “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, pika 7.
- Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve vlerësohen akte ligjore të cilat, nuk referojnë/mbështeten në kërkesat, sikurse parashikuar në Ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, dhe konkretisht neni 135, pika 2 “Të drejtat dhe detyrimet” të këtij ligji.
- Nga ana e Drejtorisë së Administrimit të Pronës Shtetërore nuk dokumentohet një analizë database/prognozë e të ardhurave të kontratave të qerasë dhe emfiteozës, si dhe një parashikim i të ardhurave, në funksion të përdorimit të këtyre të ardhurave, në referencë të VKM-së nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.
- Nga ana e Drejtorisë së Administrimit të Pronës Shtetërore, nuk janë përmbushur kërkesat e VKM-së nr.503, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë”, Kreu III- pika 17 “Administrimi i pronës Shtetërore”, si dhe Kreu IV, pika 16, ku përcaktohen përgjegjësitë e Ministrisë së Financës mbi: “Ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga të qenit Pronar i Pronës Shtetërore”, si dhe nuk janë përmbushur detyrat funksionale sikurse përcaktuar në Rregulloren e Brendshme, neni 25/1 “Drejtoria e Administrimit të Pronës shtetërore”, paragrafi 3, “Detyrat Kryesore”, germa “c” dhe “g”.
- Për sa më lart, Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, me anë të të cilave është kryer kalimi i fondit nga shoqëria aksionare “Porti Detar” Sarandë, për shoqërinë aksionare “Duhan cigare” Shkodër, në vlerën totale prej 13 544 581 lekë, kanë ekspozuar buxhetin e shtetit ndaj një risku potencial.

❖ Shoqëria aksionare “Porti Detar” Sarandë:

- Nga ana e shoqërisë aksionare “Porti Detar” Sarandë/strukturat përgjegjëse, nuk dokumentohet një analizë financiare e detajuar, në zbatim të kërkesave zyrtare/referencat përkatëse ligjore në fuqi, lidhur me kalimin e fondeve për secilin Vendim/Urdhër të zbatuar nga ana e tyre, në cilësinë e klientit urdhërues.
- Nga ana e shoqërisë aksionare “Porti Detar” Sarandë/strukturat përgjegjëse nuk dokumentohet një korrespondencë zyrtare me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, si dhe me Drejtorinë së Përgjithshme të Administrimit të Pronës, në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, lidhur me kërkesat e pikës 3, të Vendimit nr. 49, datë 19.06.2019, ku është përcaktuar: “Me krijimin e të ardhurave nga qeradhënia”, shuma prej 1 778 079 lekë, do të kalojë në favor të shoqërisë aksionare “Porti Detar” Sarandë.
- Nga ana e Administratorit të shoqërisë aksionare “Porti Detar” Sarandë, nuk janë respektuar kërkesat e Ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”, Kreu III “Administratorët dhe Këshilli mbikëqyrës, sistemi me dy nivele”, neni 166 “Dispozita në zbatim”, pika 1.

❖ Shoqëria aksionare “Duhan Cigare” Shkodër:

- Nga ana e Administratorit të shoqërisë dhe Nëpunësit Zbatues/Ekonomiste, për periudhën respektive të ushtrimit të detyrës, rezulton se, pagat e punonjësve nuk janë paguar në mënyrë proporcionale, si dhe nuk është ruajtur kronologjia e evidentimit dhe likuidimit të shpenzimit respektiv.
- Nuk janë respektuar kërkesat për plotësimin e deklaratave për kontributet për sigurimet shëndetësore dhe shoqërore, në moszbatim të kërkesave të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (periudha Shkurt-Mars 2018, E Sig-025).
- Likuidimi i kryer për llogari të ekspertit kontabël, lidhur me auditimin e pasqyrave financiare, viti 2015, në vlerën prej 180 000 lekë, është kryer në mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor; Vlera prej 180 000 lekë vlerësohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Në përfundim të inspektimit, Ministri i Financave ka urdhëruar/kërkuar:

- Masë shpërblim dëmi 1 (një)
- Masa rregullative 15 (pesëmbëdhjetë)

Raporti i inspektimit financiar publik, si dhe Urdhëri “Për përfundimin e inspektimit financiar publik” është në proces miratimi nga Autoritetet ligjore respektive.

11. Në subjektet: Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit/strukturat përgjegjëse të saj; Departamenti i Kufirit dhe Migracionit/strukturat përgjegjëse të saj; Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin, Korçë; Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin, Gjirokastrë; Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe Dega e Thesarit Tiranë, u krye inspektim financiar publik në zbatim të Vendimit nr.78, datë 16.10.2023 të Zyrtarit Kombëtar Autorizues, i ndryshuar.

Në përfundim të inspektimit u konstatua sa vijon:

- Ministria e Brendshme e përfaqësuar nga DPPSH, ka lidhur dy marrëveshje me Agjencinë e Rojës Bregdetare/FRONTEX, konkretisht: i) Marrëveshjen e punës me datë 19.02.2009, zëvendësuar me Marrëveshjen e punës, me datë 17.03.2021, si dhe ii) Marrëveshjen statutores të ratifikuar me Ligjin nr.6, datë 07.02.2019. Sipas rregullores së FRONTEX, oficerët e vendosur nga Agjencia Evropiane e Kufirit dhe Rojës Bregdetare, kryejnë aktivitete në bashkëpunim me oficerët shqiptarë.
- Në referencë të Rregullores të Frontex, neni 39, 41 dhe 91, si dhe në referencë të Marrëveshjes së Punës, nënshkruar nga palët respektive më datë 19.02.2009 (ndryshuar me Marrëveshjen e Punës, nënshkruar më datë 17.03.2021) ndërmjet Ministrit të Brendshëm të Republikës së Shqipërisë dhe FRONTEX, për periudhën objekt inspektimi, janë lidhur 9 (nëntë) Marrëveshje Granti, të nënshkruara nga Drejtuesi i Departamentit të

Kufirit dhe Migracionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (For Partner) dhe nga Drejtuesi i Njësisë së Vendosijes në terren (For Frontex), në vlerën totale prej 202 278.2 Euro, nga të cilat disbursuar për Partnerin vlera prej 163 710 Euro.

- Mbështetur në këto Marrëveshje nga ana e Titullarit/Drejtorit/Drejtorët i/e Përgjithshëm i/të Policisë së Shtetit, sipas periudhave respektive të ushtrimit të detyrës nga ana e tyre, janë lëshuar 27 (njëzet e shtatë) urdhëra “Për transferimin e përkohshëm në detyrë”, me qëllim kryerjen e operacioneve të përbashkëta për Aktivitetet Operacionale Flexibël Ballkani Perëndimor në Shqipëri.

Rezulton:

- Për likuidimet e kryera nga struktura përgjegjëse e financës, në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin në DPPSH, për llogari oficerëve/punonjësve të përfshirë në operacionet /aktivitetet, të cilët janë trajtuar dhe kanë përfutuar dieta ditore, akomodim dhe shpenzime indirekte me burim financimi fondet e disbursuara nga FRONTEx, sipas urdhërave respektive, të nxjerra nga Drejtorët e DVKM Korçë dhe Gjirokastrë, janë konstatuar diferenca në numër ditësh (shpenzime dietë ditore) dhe diferencë në numër netësh (shpenzime për akomodim), referuar mandat pagesave respektive të Arkës, si dhe transaksioneve financiare me operatorët bankarë, krahasuar me periudhat respektive të kryerjes së shërbimeve, në referencë të këtyre Urdhrave, në vlerën 19,050 Euro, vlerë e cila vlerësohet përfitim i padrejtë nga ana e Përfituesve respektive (në kushtet kur këto trupa shërbimi janë punonjës të DVKM Korçë dhe Gjirokastrë). Për më tej:
- Nga ana e DVKM Korçë dhe DVKM Gjirokastrë (në referencë të korrespondencës me e-mail të zhvilluar ndërmjet këtyre të fundit dhe Asistencës së Departamentit të Kufirit dhe Emigracionit) të jenë lëshuar urdhërat respektive “Për transferimin e përkohshëm në detyrë” të oficerëve/punonjësve të Drejtorisë Vendore respektive, në operacione /aktivitetet e përbashkëta me FRONTEx, të cilët janë trajtuar dhe kanë përfutuar dieta me burim financimi fondet e disbursuara nga FRONTEx.
- Nuk dokumentohet që nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, në kohën respektive të ushtrimit të detyrës, të jetë urdhëruar me një akt administrativ mënyra e pagesës për oficerët në referencë të Urdhrave të nxjerrë nga Drejtori i DVKM Korçë dhe Gjirokastrë, me burim financimi FRONTEx, në kushtet kur Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit është Autoritetit ligjor, i cili është i autorizuar nga Ministri i Brendshëm për implementimin e marrëveshjes; Urdhërat e nxjerrë nga Drejtori i DVKM Korçë dhe Gjirokastrë, nuk dokumentohet të jenë referuar/mbështetur në një dokument konkret të FRONTEx, apo të koordinatorit të vënë në dispozicion të operacionit, si dhe u mungojnë elementët respektivë ligjorë, sikurse parashikuar në nenin 30, të Rregullores së Policisë së Shtetit; Urdhërat e nxjerrë nga Drejtori i DVKM Korçë dhe Gjirokastrë, nuk dokumentohet të jenë referuar/ bazuar/mbështetur në Urdhërat respektivë të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si dhe nuk dokumentohet që, këto urdhëra të kenë në përmbajtjen e tyre mënyrën e financimit të shpenzimeve që do të kryhen në referencë

- të transferimeve të përkohshme respektive, sikurse urdhëruar në këto urdhëra (me burim financimi buxheti apo nga fondet e disbursuara nga FRONTEX).
- Likujdimet e kryera nga struktura përgjegjëse e financës, në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin në DPPSH, për llogari të oficerëve/punonjësve të Drejtorive Vendore respektive, në vlerën totale 300 564 Euro, e cila përfaqëson (dieta ditore, akomodim dhe shpenzime indirekte), është kryer në mosrespektim të disiplinës financiare, si dhe në kundërshtim me: i) përcaktimet e marrëveshjeve respektive të Grantit/GC/Part B “Financial Provisions”; ii) Urdhërat respektivë të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Policisë së Shtetit; iii) VKM nr.750 datë 16.09.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”, e ndryshuar, neni 29, pika 1, 2/b, duke ekspozuar buxhetin e shtetit ndaj një efekti financiar negativ.
 - Likujdimi i kryer nga struktura përgjegjëse e financës, në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin në DPPSH, për llogari të oficerëve/punonjësve, në referencë të Urdhërave të lëshuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe Drejtuesve të Drejtorive Vendore respektive, në vlerën totale prej 78 662.24 Euro, e cila përfaqëson shpenzime indirekte në masën maksimumi 5% të shpenzimeve/ kostove direkte, në kundërshtim me: i) Marrëveshjet respektive të Grantit Aneksi II.15; ii) Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Kreu II, neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”, pika 3, germa “a”; “dh”; “e” dhe “f”, dhe neni 11 “Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë publike”, pika 3, 4 dhe 5 ; iii) Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në një sitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu I “Të përgjithshme”/ “Përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë, nëpunësve dhe punonjësve publikë”, pika 10 dhe 12, Kreu III “Rregjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”/“Regjistri i aktiveve të njësisë të sektorit publik”/“Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve, vlerësohet përfitim i padrejtë, nga Përfituesit respektivë/Trupat e shërbimit.
- ❖ Lidhur me Marrëveshjet e Grantit/Mbështetje financiare dhënë nga buxheti i FRONTEX, në kuadër të Projektit 2021/ECRet/01, për Partnerin, të nënshkruar nga Drejtuesi i Departamentit të Kufirit dhe Migracionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (For Partner) dhe nga Drejtuesi i Njësisë së Vendosijes në terren (For Frontex):
- Në referencë të Rregullores të Frontex, neni 39, 41 dhe 91, si dhe në referencë të Marrëveshjes së Punës, nënshkruar nga palët respektive, më datë 19.02.2009 (ndryshuar me Marrëveshjen e Punës, nënshkruar më datë 17.03.2021), lidhur ndërmjet Ministrit të Brendshëm të Republikës së Shqipërisë dhe FRONTEX, për periudhën objekt inspektimi, janë lidhur 18 (tetëmbëdhjetë) Marrëveshje Granti/Mbështetje financiare dhënë nga buxheti i FRONTEX, në kuadër të Projektit 2021/ECRet/01, për Partnerin, të nënshkruara nga Drejtuesi i Departamentit të Kufirit dhe Migracionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (For Partner) dhe nga Drejtuesi i Njësisë së Vendosijes në terren (For

Frontex), në vlerën totale 202 272.80 Euro, nga të cilat disbursuar për Partnerin vlere prej 163 710 Euro.

- Mbështetur në këto Marrëveshje, nga ana e Titullarëve/Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, sipas periudhave respektive të ushtrimit të detyrës nga ana e tyre, janë lëshuar 84 (tetëdhjetë e katër) urdhëra, me qëllim pjesëmarrjen në operacionin e përbashkët të riatdhesimit, nëpërmjet një fluturimi special “charter” (CRO-Collection Return Operation) nga Franca në Shqipëri, të punonjësve të policisë shqiptare që do të shërbejnë si eskortë sigurie.

Rezultat:

- Likujdimet e kryera nga struktura përgjegjëse e financës, në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin në DPPSH, për përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, në mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor, në kundërshtim me: i) Aneksin nr.2 “Kushtet e Përgjithshme”, pjesa B, neni II.15 “Shpenzimet e lejuara”; ii) Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” Kreu II, neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”, pika 3, germa “a”; “dh”; “e” dhe “f”, dhe neni 11 “Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë publike”, pika 3, 4 dhe 5 ; iii) Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu I “Të përgjithshme”/“Përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë, nëpunësve dhe punonjësve publikë”, pika 10 dhe 12, Kreu III “ Rregjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”/“Regjistri i aktiveve të njësisë të sektorit publik”/ “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”, në vlerën prej 825 Euro, e cila vlerësohet përfitim i padrejtë.
- Nuk dokumentohen lëvizjet e arkës, lidhur me grant marrëveshjet/ aktiviteti ekstradim dhe i të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera për garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi.
- Për vlerën 59 571 Euro, vlerë e cila dokumentohet të jetë tërhequr pranë operatorit bankar brenda periudhës Maj-Dhjetor 2022, nga ana e specialistit të financës/arkëtar, nuk dokumentohet përdorimi i kësaj vlerë brenda periudhës së shtrirjes së 4 Marrëveshjeve të grantit (Marrëveshja GA 2022/32/DMD/ Prefinancing), Marrëveshja GA/2022/ 184/ DMD/ Prefinancing), Marrëveshja GA 2021/ 368/ DMD, Marrëveshja GA 2022/304/ DMD/ Prefinancing), referuar “Aktivitetet e operacionale jashtë vendit”, për këtë periudhë, në kundërshtim me përcaktimet ligjore sa më lart përmendur, si dhe në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar dhe Udhëzimit në mbështetje të tij.
- Likujdimet e kryera nga struktura përgjegjëse e financës, në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin në DPPSH, periudha 01.04.2021 deri në 28.02.2023, për llogari të punonjësve të policisë shqiptare, të cilët do të shërbejnë si eskortë sigurie, me qëllim pjesëmarrjen në operacionin e përbashkët të riatdhesimit, nëpërmjet një fluturimi special “charter” (CRO-Collection Return Operation) nga Franca në Shqipëri, në mungesë të

dokumentacionit justifikues ligjor, në kundërshtim me: i) Aneksin nr.2 “Kushtet e Përgjithshme”, pjesa B, neni II.15 pika 6; ii) Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” Kreu II, neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”, pika 3 germa “a”; “dh”; “e” dhe “f”, dhe neni 11 “Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë publike”, pika 3, 4 dhe 5 ; iii) Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në një sitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu I “Të përgjithshme”/“Përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë, nëpunësve dhe punonjësve publikë”, pika 10 dhe 12, Kreu III “ Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”/“Regjistri i aktiveve të njësisë të sektorit publik”/ “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”, në vlerën prej 5 117 Euro, e cila përfaqëson shpenzime indirekte në masën, maksimum 7% të shpenzimeve/kostove direkte, vlerësohet përfitim i padrejtë për Punonjësit e Policisë, të cilët shërbejnë si eskortë sigurie.

- ❖ Lidhur me shpenzimet për dieta jashtë vendit, me burim financimi fondet e disbursuara nga FRONTEX:
 - Për periudhën objekt inspektimi (01.04.2021 deri në 28.02.2023), dokumentohet të jenë kryer pagesa nëpërmjet arkës në valutë/”Euro” për shpenzime udhëtimi e dieta jashtë vendit (dietë ditore, akomodim/fjetje, transport, shpenzime indirekte, etj), për llogari të punonjësve të Policisë së Shtetit/Departamenti i Kufirit dhe Migracionit si dhe të Drejtoritë Vendore të Kufirit dhe Migracionit, në vlerën prej 67 322 Euro, e cila rezulton të jenë kryer nga ana e Departamentit të Kufirit dhe Migracionit, nëpërmjet arkës në valutë të huaj/ në “Euro” (29 persona në vlerën prej 67 322 Euro), respektivisht sipas periudhave respektive (01.04.2021-31.12.2021), (01.01.2022-31.12.2022) si dhe, (01.01.2023-28.02.2023).

Rezultoni:

- Likujdimet e kryera nga struktura përgjegjëse e financës, në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin në DPPSH, për llogari të oficerëve/punonjësve të Drejtorive Vendore respektive, në vlerën totale prej 15 403 Euro, e cila përfaqëson shpenzime akomodimi dhe shpenzime indirekte, në mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor, vlerësohet përfitim i padrejtë nga ana e Përfituesve respektivë. Për me tej:
- Nga krahasimi i shpenzimeve faktike të kryera nëpërmjet arkës, me të dhënat e evidencës të vënë në dispozicion nga specialist i financës (e-mail datë 22.11.2023), rezultoni të ketë një mos rakordim të të dhënave në vlerë dhe numër personash përfitues nga fondet e FRONTEX-it, përkatësisht në vlerën prej 37 253 Euro (67 322 Euro -30 069 Euro); Në bashkëlidhje të mandat pagesave për shpenzimet e kryera për dieta jashtë vendit/shtetit nga të gjithë përfituesit respektiv, sipas GA (periudha objekt inspektimi), nuk dokumentohet ftesa e palës pritëse, fotokopje e pasaportës ku të jenë dokumentuar hyrje daljet në shtetin shqiptar, bord pass-et, si dhe relacioni shpjegues për pjesëmarrjen në aktivitet, për Titullarin e DKM-së;

- Nga ana e strukturës përgjegjëse për financat, nuk është respektuar limiti ditor i arkës, sikurse përcaktohet në aktet ligjore e nënligjore për këtë qëllim.
 - Veprimet dhe mosveprimet sa më sipër, janë në kundërshtim me kërkesat e: i) Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Kreu II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, neni 11 “Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë”, pika 3, 4, 5, neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”, pika 2, gërma “b”, pika 3 gërma “a”, “dh”, “e”, “ë” dhe “f”; ii) Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu I “Të përgjithshme”/Përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë, nëpunësve dhe punonjësve publik, pika 10 dhe 12, Kreu III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”/ Regjistri i aktiveve të njësisve të sektorit publik/ Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve, pika 34, 35/b, 36/ Veprimet që kryejnë nëpunësit zbatues, pika 52, si dhe “Dokumentimi i vlerave materiale dhe letrave me vlerë”, pika 61 dhe 62; iii) Ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Kreu II “Dispozita të përgjithshme mbi dokumentet kontabël dhe pasqyrat financiare”, neni 7 “Dokumentet kontabël”, pika 1 dhe 2, Kreu III “Për kriteret e pasqyrave financiare”, neni 11 “Qëllimi i pasqyrave financiare”, pika 1 dhe 2, si dhe; iv) VKM nr.750, datë 16.09.2015 “Për miratimin e rregullores së Policisë së Shtetit” i ndryshuar, neni 22 “Struktura e kufirit dhe Migracionit”, pika 2 dhe neni 20 “Drejtoritë e Përgjithshme”, pika 3, gërma “ç”, si dhe të Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.370/1, datë 18.05.2022 “Për miratimin e procedurës standarte të punës për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe buxhetore për bashkëfinancimin e aktiviteteve të përbashkëta operacionale brenda vendit me Agjencinë Evropiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare, FRONTEX dhe të aktiviteteve të kordinuar nga FRONTEX që zhvillohen jashtë vendit”.
- ❖ Lidhur me korrespondencën zyrtare të zhvilluar me Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, Drejtorinë Rajonale Tatimore Korçë, Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër, Drejtorinë Rajonale Tatimore, Sarandë, si dhe për dijeni Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në referencë të shkresës së Zyrtarit Kombëtar Autorizues nr.15277/11 Prot, datë 10.11.2023:
- Likujdimet e kryera nga struktura përgjegjëse e financës, në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin në DPPSH, për llogari të oficerëve/punonjësve të përfshirë në operacionet /aktivitetet, të cilët janë trajtuar dhe kanë përfutur shpenzime akomodimi, me burim financimi fondet e disbursuara nga FRONTEX, sipas urdhërave respektive të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm të Policisë dhe Drejtuesit e DVK-ve, në vlerën 74 390 Euro, si dhe në vlerën prej 422 252 lekë, në mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor (referuar dokumentacionit të administruar nga DRT Rajonale të DPT, në përgjigje të Tonës nr.15277/11 Prot, datë 10.11.2023, si dhe atij të administruar nga subjektet objekt inspektimi vlerësohet përfitim i padrejtë nga Përfutuesit/Trupat e Shërbimit.

- Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, strukturat përgjegjëse të saj (Departamenti për Kufirin dhe Migracionin dhe Sektori i Financës) për periudhën objekt inspektimi, nuk janë menaxhuar me përgjegjshmëri fondet e Grantit/ve/Mbështetje financiare dhënë nga buxheti i FRONTEx, referuar shkeljeve ligjore të konstatuara në fushën e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, të menaxhimit të aktiveve në njësitë e sektorit publik, të kuadrit ligjor në fushën e tatimeve, në papërgjegjshmëri menaxheriale të Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues, në mos kryerje të detyrave funksionale të strukturave respektive, si dhe referuar veprimeve/transaksioneve financiare për shpenzimet e kryera nga fondet FRONTEx, në mungesë të dokumentacionin vërtetues e justifikues, të cilat kanë sjellë për pasojë ekspozimin e buxhetit të shtetit ndaj një efekti financiar negativ në vlerën totale prej 300 564 Euro, të përfitimit të padrejtë nga ana e Përfituesve respektivë në vlerën prej 193 447.24 Euro dhe në vlerën prej 422.252 lekë.
- Strukturat drejtuese të DPPSH nuk kanë përmbushur kërkesat e nenit 16, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, lidhur me garantimin e gjurmës së auditimit, e cila të pasqyrojë qartë informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t’i verifikuar këto transaksione dhe operacione, sipas cilësimeve të pikës nr. 19, neni 4 të ligjit.

Në përfundim të inspektimit, Ministri i Financave ka urdhëruar/kërkuar:

- Masa shpërblim dëmi 6 (gjashtë)
- Masa administrative 2 (dy)
- Masa rregullative 9 (nëntë)
- Masa disiplinore 7 (shtatë)

Raporti i inspektimit financiar publik, si dhe Urdhri “Për përfundimin e inspektimit financiar publik” është në proces miratimi nga Autoritetet ligjore respektive.

12. Në zbatim të Vendimit të Nëpunësit të Parë Autorizues nr.101, datë 20.11.2023 “Për fillimin e inspektimit financiar publik”, i ndryshuar, me objekt: “Zbatimi i ligjshmërisë në procedurën e prokurimit me Nr.REF-74887-07-12-2023, me objekt “Mbrotjtje nga ujrat e larta dhe sistemimi i përroit të SMT”, në përlllogaritjen e fondit limit në vlerën 43 588 214 lekë pa Tvsh, nga ana e Bashkisë Devoll, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, si dhe kuadri ligjor për llogaritjen e vlerës së kontratës/fondit limit nga ana e Studios së projektimit “xxx” shpk”, u krye misioni i inspektimit financiar publik në subjektet: i) Bashkia Devoll; ii) Studio e Projektimit “xxx” shpk; iii) Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë: Shoqëria “xx” shpk & Shoqëria “xx” shpk; Shoqëria “xxx” shpk (Kapacitet Mbështetës), nga ku u konstatua, për sa vijon:

- ❖ Mbi zbatimin e procedurave ligjore në zhvillimin e procedurës të prokurimit publik, me objekt “Mbrojtje nga ujrat e larta dhe sistemimi i përroit të SMT-së, në Bashkinë Devoll:
- ✓ Me Urdhrin e prokurimit nr.8, datë 07.06.2016, të Titullarit të AK, Bashkia Devoll, është urdhëruar kryerja e prokurimit elektronik për shërbime konsulence me objekt “Shërbime projektimi për projekte të financuara nga Bashkia Devoll” me fond limit 15 000 000 lekë pa Tvsh.
- ✓ Në përfundim të procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, me objekt “Shërbime projektimi për projekte të financuara nga Bashkia Devoll”, rezulton të jetë lidhur Kontrata nr.08, datë 24.08.2016, ndërmjet Bashkisë Devoll, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z.xx dhe Kontraktorit: BOE “xxx”shpk & “xxx” shpk & “xxx” shpk, ku ndër të tjera është përfshire edhe shërbimi “Studim projektim i Mbrojtjes nga ujrat e larta dhe sistemimi i Përroit të SMT-së”, në vlerën prej 14 778 591 lekë pa Tvsh dhe 17 734 309 lekë me Tvsh, me afat realizimi 6 (gjashtë) muaj.
 - Dokumentohet të jetë hartuar nga BOE “xxx” shpk & “xxx” shpk & “xxx” shpk Projekti Teknik i zbatimit, cili ka zgjidhur kërkesat e shprehura në “Detyrën e Projektimit”.
 - Në preventivin e punimeve të hartuar janë përcaktuar 24 zëra punimesh në vlerën totale prej 43 588 214 lekë pa Tvsh dhe 52 305 857 lekë me Tvsh.

Konstatohet se:

- Nuk dokumentohet që Bashkia Devoll, në cilësinë e zhvilluesit të ketë marrë miratimin nga strukturat përkatëse, lidhur me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, në moszbatim të dispozitave të Ligjit nr.10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” i ndryshuar, neni 8 “Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të VNM-së” dhe neni 10 “Paraqitja e kërkesës për vlerësimin e ndikimit në mjedis nga zhvilluesi”, gërma “a”, si dhe të VKM nr. 13, datë 04.01.2013 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis”.
- ✓ Me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.260, datë 27.04.2023 “Për miratimin e projekteve fituese të financuara nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të Autoritetit Kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas Njësive të Qeverisjes Vendore” është shpallur fitues projekti me objekt “Mbrojtja nga ujrat e larta dhe sistemimi i Përroit të SMT-së” me vlerë 52 305 857 lekë me Tvsh.
- ✓ Me Urdhrin nr.1947 prot, datë 29.06.2023 “Për caktimin e anëtarëve të Njesisë së prokurimit”, Kryetari i Bashkisë Devoll, ka urdhëruar krijimin e Njesisë së Prokurimit për procedurën e prokurimit me objekt “Mbrojtja nga ujrat e larta dhe sistemimi i Përroit të SMT-së”, e cila me Procesverbalin nr.1947/1 Prot, datë 29.06.2023 “Për llogaritjen e vlerës së fondit limit, ka vendosur si fond limit vlerën prej 43 588 214 lekë pa Tvsh ose 52 305 857 lekë me Tvsh, referuar projektit dhe preventivit të hartuar përpara nxjerrjes

së urdhrimit të prokurimit, nga BOE “xxx” shpk & “xxx” shpk & “xxx” shpk, bazuar në Manualin e Cmimeve të miratuar me VKM nr.629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre dhe analizës së çmimeve.

- ✓ Për procedurën e prokurimit me objekt “Mbrojtja nga ujrat e larta dhe sistemimi i Përroit të SMT-së”: Me Urdhrin nr.1947 Prot, datë 29.06.2023 “Për caktimin e anëtarëve të Njesisë së prokurimit”, të Kryetarit të Bashkisë është urdhëruar krijimi i Njesisë së Prokurimit; Me Urdhrin e prokurimit nr.1947/2 Prot, datë 29.06.2023 të Kryetarit të Bashkisë Devoll, është urdhëruar kryerja e prokurimit, me fond limit 43 588 214 lekë pa Tvsh ose 52 305 857 lekë me Tvsh, respektivisht: i) Viti 2023 financimi në vlerën 27 242 633.8 lekë pa Tvsh ose 32 691 160.63 lekë me Tvsh me burim financimi: Buxheti i shtetit, si dhe; ii) Viti 2024 financimi në vlerën 16 345 580.8 lekë pa Tvsh ose 19 614 697 lekë me Tvsh, me burim financimi: Transfertë e pakushtëzuar; Lloji i procedurës: Procedurë e hapur pune; Me Urdhrin nr.1947/3 prot, datë 12.07.2023 “Për krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave”, është urdhëruar krijimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave; Dokumentat e tenderit rezultojnë të jenë publikuar në datën 13.07.2023, me datë zhvillimi të tenderit/hapje e ofertave data 02.08.2023.

Konstatohet se:

- Nga ana e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, është vepruar në kundërshtim me kërkesat e VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, neni 74 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, pika 1 dhe 2.
- Lidhur me kriteret kualifikuese, të kërkuara në Dokumentat e Tenderit, Shtojca 7 “Kriteret kualifikuese”:
 - Nga ana e Bashkisë Devoll, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 74 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, pika 1 dhe 2.
 - Nga ana e Bashkisë Devoll, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, në hartimin e kriterit/pika 2.2.3, kriterit/pika 2.2.3/e, kriterit/pika 2.3.5, paragrafi 6 (shtojca 7 të Dokumentave të Tenderit), të kërkesave për kualifikim, nuk janë respektuar kërkesat ligjore, sikurse parashikuar në: i) Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77, ii) VKM-në Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 39/6/8; iii) VKM-në Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1, si dhe; iv) Ligjin Nr.10440, datë 7.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, neni 1, gërma “a”.

- Lidhur me parregullsitë dhe shkeljet ligjore, nga ana e Autoritetit Kontraktor, Bashkia Devoll gjatë periudhës së publikimit të Dokumentave të Tenderit, në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), lidhur me kërkesat për sqarim, të paraqitura nga OE të interesuar:
 - ✓ Në dosjen e tenderit me objekt: “Mbrojtje nga ujrat e larta dhe sistemimi i përroit të SMT-së”, nuk dokumentohet administrimi në dosjen e tenderit me objekt: “Mbrojtje nga ujrat e larta dhe sistemimi i përroit të SMT-së”, dy kërkesat “Për sqarim” të paraqitur nga OE.
 - ✓ Nuk janë respektuar kërkesat ligjore, sikurse parashikuar në Ligjin Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 75, pika 1; neni 111, pika 1 dhe 4, si dhe është vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, sikurse parashikuar në VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 33 “Formulari i ankesës” dhe neni 94 “Paraqitja e ankesave”.
 - ✓ Nuk janë respektuar kërkesat ligjore të sikurse parashikuar në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 75, pika 1; neni 111, pika 1 dhe 4, si dhe rregullat e prokurimit publik të përcaktuara në VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar: neni 33 “Formulari i ankesës” dhe neni 94 “Paraqitja e ankesave” (Kërkesa e paraqitur në datën 24.07.2023 “Kërkesa për sqarim” nga ana e operatorit ekonomik “xxxx” shpk, ndonëse është paraqitur si kërkesë për sqarim, është trajtuar si ankesë nga AK).
- Lidhur me shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të ofertave të paraqitura nga 7 (shtatë) operatorët ekonomik pjesëmarrës (përfshirë BOE të shpallur fitues):

Nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave:

- ✓ Nuk janë respektuar kërkesat ligjore, sikurse parashikuar në VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”.
- ✓ Nuk janë respektuar kërkesat ligjore, sikurse parashikuar në VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 1.
- ✓ Nuk janë respektuar kërkesat ligjore, sikurse parashikuar në VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 dhe pika 3 (gjatë përlllogaritjes së zërave të ofertës ekonomike që ka marrë përsipër të kryejë OE “xxx” shpk rezulton se, nga ky OE do të realizohen 28% e punimeve, ndërsa referuar Aktmarrëveshjes së dorëzuar nga BOE “xxx” shpk & “xxx” shpk, rezulton që: i) OE “xxx” shpk të ketë marrë përsipër të realizojë 64 % të zërave të punimeve, ndërsa, ii) OE “xxx” shpk të ketë marrë përsipër të realizojë 36% të vlerës punimeve, sipas ofertës ekonomike).
- ✓ Gjatë vlerësimit të ofertave të paraqitura nga BOE, nga ana e KVO-së nuk është konstatuar mospërmbushja e kërkesave ligjore nga ana e BOE, të shpallur fitues, sikurse

parashikuar në VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, të nenit 39 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, pika 7/a (Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE dhe dokumentacionit origjinal të ofertës, konkretisht vërtetimit të debisë nr.420 prot datë 06.07.2023, rezulton që OE “xxx” Shpk të ketë 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike vlerë e llogaritur deri në datën 06.07.2023, pa përfshirë faturën koherente të muajit qershor 2023, ndërkohë që tenderi është zhvilluar në datën 09.08.2023 dhe duhet të ishte përfshirë dhe muaji qershor, tashmë i maturuar).

- ✓ Gjatë vlerësimit të ofertave të paraqitura nga BOE, nga ana e KVO-së është vepruar në kundërshtim me kërkesat ligjore të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 92/3;
 - Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “xxx” shpk & “xxx” Shpk, nuk ka plotësuar kërkesat e veçanta për kualifikim, shtojca 7, lidhur me aftësinë profesionale, ne kushtet kur referuar DST, Njoftimi i Kontratës, Seksioni 2, pika 2.16 “Mbështetja në kapacitete të subjekteve të tjera”, nga ana e Autoritetit Kontraktor është përcaktuar se, nuk lejohet mbështetja me kapacitete të subjekteve të tjera (rezulton se, BOE fitues “xxx” Shpk & “xxx” Shpk, kanë hyrë me kapacitet mbështetës me operatorin ekonomik “Ndregjoni” Shpk, referuar Akt Marrëveshjes Nr.12, datë 28.07.2023 të lidhur mes tyre);

Për pro, sa më lart:

- Gjatë vlerësimit të ofertave të paraqitura nga OE, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave rezulton të jenë s’kualifikuar 3 (tre) operatorë ekonomik me vlerë ofertuese më të ulët: i) BOE “xxx” shpk & “xxxx” shpk për ofertë anomalisht më të ulët me ofertë ekonomike në vlerën prej 29 490 619.20 lekë pa Tvsh, ii) OE “xxx” shpk për mosplotësim të nivelit të klasifikimit të kategorisë NP-9 B të licencës, pasi ka ofruar kategorinë NP-9 A me ofertë në vlerën prej 29 889 185 lekë pa Tvsh; si dhe; iii) OE “xxx” shpk, për mungesë kapacitetesh teknike/makineri me ofertë ekonomike, në vlerën prej 35 630 375 lekë pa Tvsh.
- Oferta e paraqitur nga ana e BOE “xxx” shpk & “xxx” shpk, nuk rezulton të jetë Oferta ekonomikisht më e favorshme përse i përket vlerës ekonomike të ofruar prej 35 690 533 lekë pa Tvsh (në kushtet kur rezulton të jetë s’kualifikuar oferta OE “xxx” shpk me vlerë ekonomike më të ulët, konkretisht me ofertë në vlerën prej 29 889 185 lekë pa Tvsh, vetëm për nivelin e Kategorisë për mosplotësim të nivelit të klasifikimit të kategorisë së licencës nga A në B).
- Kualifikimi, e për më tej shpallja fitues e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “xxx” shpk & “xxx” shpk, i cili nuk ka plotësuar kriteret e DST, është bërë në kundërshtim me kërkesat ligjore, sikurse përcaktuar në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 92/3, duke sjellë për pasojë obligimin e buxhetit të shtetit ndaj përdorimit të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet.

Në përfundim të inspektimit, Ministri i Financave ka urdhëruar/kërkuar:

- Masa rregullative 7 (shtatë) masa;
- Masa disiplinore 3 (tre) masa;
- Masa Administrative 2 (dy) masa;

Raporti i inspektimit financiar publik, si dhe Urdhëri “ Për përfundimin e inspektimit financiar publik” është në proces miratimi nga Autoritetet ligjore respektive.

13. Në zbatim të Vendimit të Zyrtarit Kombëtar Autorizues nr.106, datë 05.12.2023 “Për fillimin e inspektimit financiar publik” (protokolluar në MFE nr.19927/6 Prot, datë 05.12.2023), i ndryshuar, me objekt: “Zbatimi i ligjshmërisë lidhur me përdorimin e fondeve publike nga ana e Institucionit të AZHBR-së, në kuadër të Instrumentit të BE-së, për ndihmën e Para-Anëtarësimit për Zhvillimin Rural (IPAR II) 2014-2020, për: Zbatimin e kontratës ID:02/7/5/12/0013, lidhur ndërmjet AZHBR-së, në cilësinë e Palës që jep mbështetjen financiare dhe Operatorit Ekonomik “xxx” shpk, në cilësinë e Përfituesit të fondeve të Programit IPARD II, 2014-2020, në subjektet: Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR)/strukturat përgjegjëse, Bashkia Delvinë/strukturat përgjegjëse; Autoriteti Kombëtar të Ushqimit/Drejtorinë Rajonale, Qarkut Vlorë; Agjencia Kombëtare e Mjedisit/strukturat përgjegjëse; Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore/Dega Rajonale, Qarkut, Gjirokastrë, Shoqëria “xxx” shpk, në cilësinë e Përfituesit të Fondeve të Programit IPARD II; Subjekti “xx” shpk/ndërtues; Subjekti “xx”, në cilësinë e Mbikqyrësit, si dhe; Subjekti “xx”/kollaudator, nga ku u konstatua, për sa vijon:

Më datë 05.10.2020 është lidhur Kontrata nr.1533/10 Prot, datë 16.11.2020, ndërmjet palëve kontraktuese: i) Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, AZHBR, si palë që jep mbështetjen, përfaqësuar nga Titullari i Institucionit; si dhe ii) Përfituesit “xxx” shpk, në cilësinë e Përfituesit të fondeve, përfaqësuar nga z.xx, si palë që përfiton fondet.

Kontrata sa më lart i referohet: i) Masës së aplikuar nr.7 “Diversifikimin e fermave dhe zhvillimin e biznesit”; ii) Grupi i investimit nr.7-5 “Turizmi rural dhe ai i natyrës”; Llojin e investimit nr.7-5.1 “Ndërtimi dhe/ose rindërtimi i shtëpive apo ndërtesave me stil tradicional për aktivitete turistike që shërbejnë si atraksione turistike dhe pajisjet përkatëse; i) Dhomat për akomodimin e turistëve, duke përfshirë, përfshirë të gjitha mjediset përkatëse dhe pajisje për dhënie të shërbimeve B&B (fjetje dhe mëngjes); ii) Infrastrukturë dhe pajisje për dhënie të shërbimeve turistike në ferma, përfshirë rrugët e brendshme për aksesimin e mjedisve akomoduese, këndeve të lojrave për fëmijë, pishinat, këndet sportive; iii) Ambiente katering (Restorante, furrave, dhomave të mëngjesit, tendave për ngrënie darke), përfshi pajisje përkatëse, përveç serviset e ngrënies; si dhe iv) Vend parkime.

Rezulton: i) Kontrata e grantit nr.1533/10 Prot, datë 16.11.2020, neni 12 “Shtojca”, nuk dokumenton në bashkëlidhje të kësaj kontrate përkatësisht: Aneksin 5 “Grafiku i punimeve” si dhe Aneksin 6 “Kriteret e përzgjedhjes për investimin e propozuar”; si dhe ii) “Shtojca 4:

Raport progresi/Formulari E-3.0-1.29”, nuk dokumenton plotësimin e kërkesave të këtij formulari si dhe nuk dokumenton vulën e subjektit përfitues “xxx” shpk, sikurse kërkuar nga AZHBR; (Referuar pikës 5.8 “Kontraktimi i aplikimeve”, të Manualit të procedurave të Drejtorisë së Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve për implementimin e Programit IPARD 2014-2020/Versioni 1.6”).

Objekti i investimit: Ndërtim me stil tradicional për aktivitet turistik, 2 kat + papafingo, në bazë të Lejes së Ndërtimit nr.22 datë 27.11.2019, të lëshuar nga Bashkia Delvinë, me zhvillues subjektin “xxx” shpk, me Administrator z. xx; Ndërtues, subjekti “xx” shpk, me Administrator z. xx, sipërfaqja e sheshit është 3 800 m², sipërfaqja e godinës 612 m², si dhe sipërfaqe ndërtimi e godinës 1 250 m².

- Punimet për ndërtimin e objektit, nuk rezultojnë të kenë përfunduar në afatin sikurse përcaktuar në nenin 1, të Kontratës së grantit, që përkon me datën 16.11.2021, konkretisht ende sot, rezultojnë punime të papërfunduara për 11 (njëmbëdhjetë) zëra punimesh, duke sjellë për pasojë mospërmbushjen e objektit të kësaj kontrate.
- Referuar Situacionit përfundimtar dokumentohen punime të deklaruara të përfunduara, por në fakt rezultojnë punime të pakryera në vlerën 5 921 765 lekë, me Tvsh.
- Nga kontrolli i dokumentacionit, vënë në dispozicion nga palët subjekt inspektimi janë deklaruar si të përfunduara punime, të cilat ende sot, nuk rezultojnë të jenë në proces, referuar dokumenteve ligjore; Librezat e masave; Situacioni përfundimtar; Akt kontrolli për përfundimin e Rifiniturave datë 01.11.2021; Akt kontrolli i sistemit, datë 01.11.2021; Deklarata teknike e përfundimit të punimeve; Çertifikatë e marrjes në dorëzim të punimeve, datë 12.11.2021; Akt kolaudimi, datë 12.11.2021; Çertifikatë përdorimi, datë 20.01.2022.
- AZHBR/Autoriteti Kontraktor, Përfituesi, Supervizori, Kolaudatori, Bashkia Delvinë, kanë vepruar në kundërshtim me kërkesat e: i) Ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; ii) Udhëzimit nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve në ndërtim”; iii) Udhëzimit nr.3, datë 15.02.2001 “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011, si dhe; iv) Ligjit nr.107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin e Zhvillimit të Territorit”, neni 42, lidhur me objektin: “Ndërtim me stil tradicional për aktivitet turistik, 2 kat + papafingo”, me Përfitues “L G P” shpk;
- Në kushtet kur ende sot, rezulton se: Punimet e pakryera dhe të çertifikuara nga palët e mësipërme, konkretisht: Përfituesi, Supervizori, Kolaudatori dhe Bashkia Delvinë, janë në vlerën 3 849 147.25 lekë me Tvsh (5 921 765 lekë me Tvsh*65 %), AZHBR nuk duhet të vijonte me autorizimin për kryerjen e pagesës, e për më tej, me ekzekutimin e saj në kohën respektive të kryerjes së saj, në masën 80 % të ndihmës publike, në vlerën prej 19 663 780 lekë.
- Për më tej, AZHBR ka qenë në kushtet e aplikimit të nenit 7, pika 1, paragrafi 2, të kontratës në fjalë dhe të aplikimit të nenit 5 “Të drejtat e AZHBR-së”, pika 7, për refuzimin e autorizimit për pagesë tërësisht dhe jo sikurse është proceduar “korrigjim shume për pagesën përfundimtare”, në vlerën 2 085 498.78 lekë *65%=1 355 574.21

lekë, për më tepër kur referuar listës së kontrollit për verifikimin në vend, dokumentohen “shënimet” nga Inspektorët e VNV-së”, të cilat konsistojnë: “Grupi i verifikimit realizoi verifikimin në vend pas kërkesës për pagesë në prani të përfaqësuesit z. xx, Administrator i subjektit “” shpk, në cilësinë e përfituesit, për aplikimin në masën nr.7/7-5 “Turizëm rural dhe ai i natyrës”, konkretisht: “Ndërtesë me stil tradicional për aktivitet turistik 2 kat-Papafingo”, është konstatuar se: Investimi për ndërtimin e ambienteve me funksion “agroturizmin”, ishte realizuar (ka përfunduar); Konstatimi duhet të konsistonte që: Investimi është ose jo funksional.

- Drejtorja e Autorizimit të Pagesave, ka qenë në kushtet ti drejtohej Drejtorisë së Kontrollit në AZHBR, me kërkesë për kontroll shtesë për investimin në fjalë, referuar Manualit të procedurave, të Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave.
- Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme të strukturave përgjegjëse në AZHBR, në kohën respektive të kryerjes së pagesës, ekspozuan buxhetin e shtetit ndaj një dëmi ekonomik, në vlerën prej 24 918 618 lekë.

Për më tej:

- Kontrata e lidhur ndërmjet AZHBR-së dhe subjektit “xxx” shpk, Përfitues i fondeve, nr.1533/10 Prot, datë 16.11.2020, është lidhur bazuar/në referencë të kritereve të pranueshmërisë së aplikueshme për të gjitha, germa “i”, “ndërtimi apo përmirësimi/ rikonstruksioni i pasurive të paluajtshme, deri në masën e vlerës së tregut të pasurisë”.
- Nga ana e subjektit “xxx” shpk, nuk dokumentohet të jetë/jenë lidhur kontratë/kontrata me të tretë për “Pajisje mobilimi”, në funksion të përmbushjes së qëllimit të investimit, për të cilin është përfituar granti në vlerën 26 274 193 lekë; Komponenti “Pajisje mobilimi”, gjatë aplikimit të bërë nga subjektit “xxx” shpk, është marrë përsipër të kryhet me fondet e vet subjektit.
- Pajisjet e mobilimit si dhe akomodimi i ndërtesës, nuk janë realizuar nga ana e Përfituesit, sikurse paraqitur në plan-biznesin e tij.
- Ende sot mbas rreth 19 muaj nga data e kryerjes së pagesës finale, në masën 80% të ndihmës publike, nga ana e subjektit “xxx” shpk, në cilësinë e përfituesit të fondeve IPARD II 2014-2020, nuk janë përmbushur detyrimet kontraktuale, me pasojë mos realizimin e qëllimit të investimit të Kontratës së Grantit nr.1533/10 Prot, datë 16.11.2020, e amenduar.
- AZHBR/struktura përgjegjëse e kontrollit, gjatë kontrolleve të ushtruara/kontrollit përfundimtar, duhet të konstatojnë në kohë reale mungesën e një kontrate/kontratave me të tretët për “Pajisje mobilimi”, në funksion të përmbushjes së qëllimit të investimit, e për më tej, Drejtorja e Autorizimit të Pagesave, ka qenë në kushtet e mos autorizimit të kryerjes së pagesës në masën 80% të kontributit të përgjithshëm publik, për llogari të subjektit përfitues.

❖ Drejtorja e Kontrollit:

Nga ana e Drejtorisë së Kontrollit/Sektorit i Kontrollit, dokumentohen të jenë kryer 8 kontrolle në vend/terren, kontrolle këto të ushtruara pranë subjektit përfitues “xxx” shpk, lidhur me investimin “Investim në ndërtesë me stil tradicional për aktivitet turistik e një bujtine 2-kate+papafingo”, me numër identifikimi ID: 02/7/5/12/0013, Masa 7/Sektorit 5 “Turizmi Rural dhe ai i Natyrës”/ Lloji i investimit “Investim në agroturizëm”, në kuadër të Programit IPARD II 2014-2020 “Për zhvillimin e sektorit Agro-Ushqimor në Shqipëri dhe në fermat bujqësore”, respektivisht:

- 1 (një) verifikim/kontroll në vend/terren, para miratimit të lidhjes së Kontratës së Grantit;
- 6 (gjashtë) verifikime/kontrolle shtesë në vend/terren, pas lidhjes së kontratës së grantit (të cilat kanë konsistuar në verifikimin në vend, për identifikimin e punimeve të fshehta/maskuara-kontrolli shtesë gjatë zbatimit të investimit);
- 1 (një) verifikim/kontroll në vend/terren, para autorizimit për pagesë, në masën 80 % të vlerës së Kontratës së Grantit.

Për sa më lart:

- Kontrollat e ushtruara sa më lart përmendur, janë bazuar në kërkesën për kontroll të Subjektit përfitues “xxx” shpk, lidhur me investimin “Investim në ndërtesë me stil tradicional për aktivitet turistik e një bujtine 2-kate+papafingo” Masa 7/Sektorit 5 “Turizmi Rural dhe ai i Natyrës”/Lloji i investimit “Investim në agroturizëm”, në kuadër të Programit IPARD II 2014-2020 “Për zhvillimin e sektorit Agro-Ushqimor në Shqipëri dhe në fermat bujqësore”, lidhur me verifikimin e punimeve të fshehta, në zërat e grafikut të punimeve, konkretisht zëri II dhe zëri III.
- Referuar grafikut të punimeve, pjesë integrale e kontratës së grantit, rezulton se në 30 ditëshin e katërt dhe të pestë të ecurisë së punimeve, janë parashikuar për t’u realizuar zërat e punimeve: i) punime suvatimi (VII); ii) punime hidrosanitare (VIII); iii) punime elektrike (IX); si dhe; iv) punime të mbrojtjes kundra zjarrit (X), për të cilat në Raportin e verifikimit në vend, nënshkruar dhe miratuar nga palët respektive “pa vërejtje”, nuk evidentohet të jetë raportuar mbi ecurinë e këtyre punimeve.
- Referuar grafikut të punimeve, pjesë integrale e kontratës së grantit, rezulton se nga 30 ditëshi i pestë dhe deri në kontrollin në vend/terren para autorizimit për pagesë, në masën 80 % të vlerës së kontratës së grantit, nga kjo Drejtori nuk është ushtruar asnjë kontroll shtesë, në kushtet kur kontrollet shtesë në vend/terren pas lidhjes së kontratës së grantit si më lart trajtuar, nuk kanë përfshirë në raportin e verifikimit në vend statusin e realizimit të punimeve: i) punime suvatimi (VII); ii) punime hidrosanitare (VIII); iii) punime elektrike (IX), si dhe; iv) punime të mbrojtjes kundra zjarrit (X), për më tepër, kur urdhrat dhe Programet e punës për verifikimin në terren konsistojnë: “Procedura e verifikimit përfshin: Studimi i dosjes, verifikimi në kohë i projektit, njoftimi i përfituesit/përfaqësuesit për verifikimin në vend, përgatitja për verifikimin, marrja e

- gjithë formularëve dhe masave të nevojshme në lidhje me investimin, Inspektorët plotësojnë listën e kontrollit dhe formularin e raportit; Dosja dhe të gjithë formularët që kanë të bëjnë me investimin i jepen Përgjegjësit të SKI-së” (pika 5.2.3 “Procedura për verifikim shtesë” e Manualit të procedurave të Drejtorisë së Kontrollit).
- Drejtoria e Kontrollit, referuar kontrollit final para kryerjes së pagës finale (80%), rezulton të mos ketë evidentuar dhe referuar pranë Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave, zërat e papërfunduar të punimeve, referuar inspektimit të kryer në terren, nga Grupi i inspektimit, sikurse trajtuar hollësisht në Raportin e inspektimit financiar publik.
 - ❖ Drejtoria e Autorizimit të Pagesave (DAP), si dhe Drejtoria e Ekzekutimit të Pagesave (DEP):
 - Mbi autorizimin dhe ekzekutimin e parapagesës, në masën 10 % të Kontratës së Grantit nr.1533/10 Prot, datë 16.11.2020:
 - Dokumentohet që, nëpërmjet operatorit bankar me urdhër transfertën e datës s’ka, të jetë kryer parapagesa në masën 10% të ndihmës publike, në vlerën prej 2 627 419 lekë, referuar Kontratës nr.1533/10 Prot, datë 16.11.2020, Kreu II “Të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese”, neni 3 “Të drejtat e përfituesit”, pika 1/gërma “a”, si dhe të nenit 6 “Detyrimet e AZHBR”, pika 1 dhe pika 2/gërma “a”.
 - Dokumentohet që, në llogarinë bankare të përfituesit/ të jetë transferuar parapagesa në masën 10% të ndihmës publike, në vlerën prej 2 627 419 lekë.
 - Mbi autorizimin dhe ekzekutimin e parapagesës, në masën 10 % të Kontratës së Grantit nr.1533/10 Prot, datë 16.11.2020, amenduar me nr.149/1 Prot, datë 27.01.2021.
 - Dokumentohet që, nëpërmjet operatorit bankar, me urdhër transfertën e datës 22.02.2021, të jetë kryer parapagesa në masën 10% të ndihmës publike, në vlerën prej 2,627,419 lekë, referuar Kontratës nr.1533/10 Prot, datë 16.11.2020, Kreu II “Të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese”, neni 3 “Të drejtat e përfituesit”, pika 1/gërma “a”, si dhe të nenit 6 “Detyrimet e AZHBR”, pika 1 dhe pika 2/gërma “a” si dhe Amendimit të kontratës nr.149/1 Prot, datë 27.01.2021, neni 1.
 - Dokumentohet që, në llogarinë bankare të përfituesit/operatori bankar të jetë transferuar parapagesa në masën 10% të ndihmës publike, në vlerën prej 2,627,419 lekë.
 - Mbi autorizimin dhe ekzekutimin e pagesës, në masën 80 % të kontratës së grantit, të amenduar:
 - Nga ana e Drejtorisë së Kontrollit me shkresën nr.1743/1 Prot, datë 01.06.2022, drejtuar Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave, është përcjellë dosja e aplikimit dhe seti i dokumentacionit ligjor nga verifikimi në vend/terren kryer në subjektin aplikues/përfitues “xxx” shpk. (Raport verifikimi në vend/terren; Lista e kontrollit për verifikimin në vend; Imazhet të printuara nga Google earth; Printimet nga GPS; Fotot nga

kontrollat në terren (66 foto), respektivisht secila me numër markimi 001025-001059, me statusin pamje nga objekti i përfunduar me funksion agroturizëm, si dhe pamje nga brenda objektit të përfunduar me funksion agroturizëm”).

- Referuar listës së kontrollit për verifikimin në vend (196 zëra punime ndërtimore të kontraktuara), dokumentohen “Shënimet nga Inspektorët e VNV-së”, të cilat konsistojnë: “Grupi i verifikimit realizoi verifikimin në vend, pas kërkesës për pagesë në prani të përfaqësuesit z.xx të subjektit “xxx shpk, për aplikimin në masën nr.7/7-5 “Turizëm rural dhe ai i natyrës”, konkretisht: “Ndërtesë me stil tradicional për aktivitet turistik 2 kat-Papafingo”. Vendndodhja ku u krye verifikimi ishte vendi ku është realizuar investimi Bashkia Delvinë. Nga verifikimi në vend u konstatua se: Investimi për ndërtimin e ambienteve me funksion “agroturizmin”, ishte realizuar (ka përfunduar).
- Nga verifikimi në terren, kryer nga grupi i inspektimit, rezultojnë se punimet për ndërtimin e objektit, nuk rezultojnë të kenë përfunduar në afatin sikurse përcaktuar në nenin 1, të Kontratës së grantit që përkon me datën 16.11.2021, dhe konkretisht ende sot, rezultojnë punime të papërfunduara, për 11 (njëmbëdhjetë) zëra punimesh, duke sjellë për pasojë mospërbushjen e objektit të kësaj kontrate.

Për më tej:

- Dokumentohet që në llogarinë bankare të përfituesit/operatori bankar të jetë transferuar pagesa 80% e ndihmës publike, në vlerën prej 19 663 780 lekë.
 - Nga ana e Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave, në cilësinë e strukturës përgjigjëse për kontrollin e plotësisë dhe përshtatshmërisë të kërkesave për pagesë, nuk janë përmbushur detyrat funksionale, sikurse përcaktuar në Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), neni 15, pika 15.3, pika 15.5/15.5.1 si dhe kërkesat respektive, sikurse përcaktuar në “Manualin e Procedurave të Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave”, pika 3 “Objekti i punës”, si dhe në pikën 5.5. “Verifikimi administrativ i kërkesës për pagesë”.
- ❖ Lidhur me lëshimin e raporteve nga autoritet teknike kombëtare, lidhur me përmbushjen e standarteve kombëtare/të BE-së, sipas Programit IPARD, paragrafi 8.2.3.8 (Kontrata e Grantit nr.1533/10, datë 16.11.2020, e amenduar):

Referuar nenit 4 “Detyrimet e Përfituesit”, pika 8, e Kontratës Grantit nr.1533/10, datë 16.11.2020, të amenduar parashikohet: “Përfituesi është i detyruar të përmbushë standartet kombëtare/ të BE-së në fushën e mjedisit, sigurisë në punë dhe shëndetit publik, në fund të realizimit të investimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Programin IPARD dhe paragrafin 3 të këtij neni...Përmbushja e standarteve kombëtare /të BE-së konsiderohen të pranueshme kur Autoritetet Teknike përkatëse në fushën e mjedisit, sigurisë në punë dhe shëndetit publik lëshon certifikatat. Në rast se Autoriteti teknik nxjerr një raport me një afat për përmbushjen e standarit kombëtar /të BE-së, investimi nuk do të konsiderohet i përfunduar, sipas Programit IPARD, paragrafi 8.2.3.8”.

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit/Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit:
 - “Çertifikata e pajtueshmërisë”, lëshuar nga kjo strukturë, nuk është në përputhje me kërkesat e Memorandumit të Mirëkuptimit “Për implementimin e Programit IPARD II 2014-2020”, protokolluar në AZHBR nr.2701 Prot, datë 24.10.2017 dhe në AKM nr.2549 Prot, datë 20.10.2017, lidhur ndërmjet AZHBR-së, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Drejtorit të Përgjithshëm (në mungesë dhe me porosi) neni 2 dhe neni 3, si dhe të kontratës së lidhur midis AZHBR së dhe subjektit “xxx” shpk, në cilësinë e përfituesit, me nr.1533/10 Prot, datë 16.11.2020, e amenduar neni 4 “Detyrimet e përfituesit”, pika 8.
- Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore/Dega Rajonale, Qarku Gjirokastrë:
 - Nga ana e Drejtorisë Rajonale, Gjirokastrë, të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore nuk janë respektuar kërkesat e Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.165 Prot, datë 13.09.2021, Ligjin nr.10237 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, Ligji nr.7961 “Kodi i punës në RSH”/Për marrëdhëniet e punës dhe sigurinë në punë, si dhe nuk janë plotësuar kërkesat e check listës, në të cilën përfshihen të gjithë treguesit e sigurisë së personelit në punë, referuar standarteve të BE-së, siç parashikohet në legjislacionin e BE-së, në lidhje me investimet e përfituara nga programet IPARD.
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit/Dega Rajonale e Qarkut Vlorë:
 - Referuar Kapitullit të Parë të Check listës respektive, pika 2 citohet: “subjekti me godinë konform projektit (me hapësira të bollshme për të gjitha funksionet dhe shërbimet...Kuzhinë, sallë shërbimi, dhoma fjetje, tualete, bar etj...me markimin “PO”)
 - Nga ana e Autoriteti Kombëtar i Ushqimit/Dega Rajonale e Qarkut Vlorë është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” si dhe VKM nr.1081, datë 21.10.2009 ”Për organizimin dhe funksionimin e AKU së”, si dhe Rregulloren e Brendshme nr.297, datë 23.06.2022 “Për miratimin e rregullores dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, të miratuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Seksioni II “Organizimi dhe funksionimi në nivel Rajonal”, neni 45 “Drejtoritë Rajonale të Autoritetit Kombëtar”, neni 46 “Veprimtaria e Drejtorive Rajonale”.

Për sa më lart, vlerësohet:

- Strukturat sa më lart përmendur, kanë miratuar përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, nga ana e Subjektit përfitues “xxx” shpk, kur ende sot, mbas rreth 19 muaj nga data e

kryerjes së pagesës finale, në masën 80% të ndihmës publike, nga ana e këtij subjekti, në cilësinë e përfituesit të fondeve IPARD II 2014-2020, nuk janë përmbushur detyrimet kontraktuale, të investimit të Kontratës së Grantit nr.1533/10 Prot, datë 16.11.2020, e amenduar, me pasojë mos realizimin e qëllimit të investimit të Kontratës së Grantit nr.1533/10 Prot, datë 16.11.2020, e amenduar.

- Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), Bashkia Delvinë, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore/Dega Rajonale, Qarku Gjirokastrë, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit/Dega Rajonale e Qarkut Vlorë; Agjencia Kombëtare të Mjedisit/Drejtoria e Inspektimit dhe Kontrollit, Subjekti “xxx” shpk, në cilësinë e përfituesit të fondit, Subjekti “xx” shpk, në cilësinë e ndërtuesit të punimeve të ndërtimit, Supervizori Inxh.xx, si dhe Kolaudatori Inxh. xx, me veprimet dhe me mosveprimet e tyre, trajtuar hollësisht në Raportin e inspektimit financiar publik, në kohën respektive, kanë ekspozuar buxhetin e shtetit ndaj një dëmi ekonomik, në vlerën prej 24 918 618 lekë.
- Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës Akredituar nga Bashkimi Evropian:
- Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës Akredituar nga Bashkimi Evropian, e cila me shkresën nr.172/4 Prot, datë 12.01.2023 ka përcjellë “Audit finding” no.9/No of Audit engagement: AA-IPARD II-2022-AoO-01-IA, pjesë e të cilit është dhe Aplikimi ID 02/7/5/12/0013, ka evidentuar pargullësi vetëm në afatin prej 359 ditë, kur duhet të sillte në vëmendje/konstatonte mospërmbushjen e detyrimeve kontraktuale nga ana e Subjektit përfitues, si dhe parregullësitë dhe shkeljet ligjore të kryera nga ana e Institucionit të AZHBR-së gjatë zbatimit të Kontratës së Grantit nr.1533/10 Prot, datë 16.11.2020, e amenduar.

Gjatë periudhës së kryerjes së inspektimit financiar publik, AZHBR me shkresën nr.49/11 Prot, datë 23.02.2024, protokolluar në Ministrinë e Financave nr.19927/39 Prot, datë 26.02.2024, drejtuar Zyrtarit Kombëtar Autorizues dhe për dijeni Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik, bën me dije kthimin e vlerës të përfituar padrejtësisht prej 24 918 618.80 lekë, në llogarinë bankare të AZHBR-së nëpërmjet operatorit bankar, me të cilin operon kjo e fundit, në përgjigje të shkresës së Zyrtarit Kombëtar Autorizues nr. 19927/37 Prot, datë 21.02.2024 drejtuar AZHBR-së dhe për dijeni Drejtorisë së Fondit Kombëtar në Ministrinë e Financave.

Në përfundim të inspektimit, grupi i inspektimit ka propozuar:

- Masa rregullative 8 (tetë)
- Masa administrative 3 (tre)
- Masa disiplinore 13 (trembëdhjetë)

Raporti i inspektimit financiar publik është në proces miratimi nga Autoritetet ligjore respektive.

SHËRBIMI I KOORDINIMIT TË ANTIMASHTRIMIT:

Gjatë vitit 2023 lidhur me funksionimin e strukturës së inspektimit në rolin e shërbimit të koordinimit të anti-mashtrimit (AFCOS) dhe si pikë kontakti e Zyrës Evropiane kundër Mashtrimit (OLAF), janë zhvilluar këto aktivitete:

Ka vijuar bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit për dy raste bashkëpunimi me OLAF “shkëmbim informacioni”, të dërguar nga OLAF, në lidhje me pretendimet për parregullsi dhe mashtrim në kuadër të përdorimit të fondeve të akreditura IPARD II, si në kuadër të përdorimit të fondeve të BE-së.

Për këto raste të konstatuara me parregullsi në përdorimin e fondeve të BE-së, Zyra Evropiane kundër Mashtrimit (OLAF), për periudhën raportuese u mbështet nga AFCOS, me kërkesë të tyre:

- Është zhvilluar korespondencë zyrtare me Prokurorinë e Përgjithshme dhe SPAK, ku janë adresuar kërkesat respektive të bëra nga OLAF.
- Është zhvilluar korespondencë zyrtare me Agjencinë e Inteligjencës Financiare dhe Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, ku janë adresuar kërkesat respektive të bëra nga OLAF.
- Lidhur me hartimin e Strategjisë Kombëtare për mbrojtjen e Interesave Financiare të BE-së:
 - Në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2024-2026, është parashikuar hartimi i Strategjisë Kombëtare kundër mashtrimit, me qëllim mbrojtjen e interesave financiare të BE-së, në të cilën janë përfshirë operuese dhe menaxhuese të fondeve të BE-së (IPA & IPARD), si dhe disa struktura/ institucioneve, pjesë e rrjetit të raportimit të shërbimit “AFCOS”.
 - Referuar Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2024-2026, përfundimi i hartimit të kësaj strategjie dhe planit të veprimit në zbatim të saj, si dhe miratimi me Vendim të Këshillit të Ministrave, brenda 3 muajve të parë të vitit 2025.
 - Ministri i Financave dhe Ekonomisë me Urdhrin nr.127, datë 15.04.2022 “Për ngritjen e Grupit të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare kundër mashtrimit, me qëllim mbrojtjen e interesave financiare të BE-së”, ka ngritur Grupin e punës, në të cilën janë përfshirë operuese dhe menaxhuese të fondeve të BE-së (IPA & IPARD), si dhe disa struktura/ institucioneve, pjesë e rrjetit të raportimit të shërbimit “AFCOS”, të cilët do të japin kontributin e tyre në hartimin e kësaj strategjie dhe zbatimin e planit të veprimit të saj.
 - Nëpërmjet Projektit për Qeverisje të Mirë është siguruar asistencë teknike për hartimin e kësaj strategjie. Ekspertët e kontraktuar kanë filluar bashkëpunimin me grupin e punës.

- Për periudhën raportuese, pranë Ministrisë përgjegjëse për financën, janë zhvilluar takime, në funksion të mbarëvajtjes së procesit të hartimit të këtij dokumenti strategjik.
- Për hartimin e kësaj strategjie Ministria e Financave/Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik/AFCOS do të vijojë të jetë në kontakt të vazhdueshëm me OLAF.
- Strategjia është parashikuar të miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave brenda 3 muajve të parë të vitit 2025;
- Do të vijohet me shtimin e përdoruesve në sistemin e raportimit të parregullsive edhe me përfaqësues të Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga BE, por jo vetëm.

6. MARËDHËNIET INSTITUCIONALE

6.1. Marëdhëniet institucionale kombëtare

Drejtoria e Inspektimit financiar publik ka dhënë mendime në të gjitha rastet e kërkuara nga Drejtoria Juridike dhe Drejtori të tjera të Ministrisë së Financave, apo nga struktura të tjera institucionale.

Marëdhëniet me struktura të tjera institucionale:

- DIFP jep kontribut periodik lidhur me përafrimin e legjislacionit të brendshëm me atë të BE-së, për kapitullin 23 “Drejtësia dhe të drejtat e njeriut”, kapitullin “Kriteri ekonomik”, Ecofin 2022, etj.
- Raportimi periodik për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme lidhur me kapitullin 32.
- Raportimi periodik për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme lidhur me kapitullin 33.
- Raportim periodik për Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike, PFM 2023-2030.
- Raportimi periodik për Strategjinë Ndërsektoriale SNKK 2023-2030.
- Raportimin në kuadër të Raportit shtetëror Antikorrupsion.

6.2. Marëdhëniet institucionale ndërkombëtare

- OLAF, në kuadër të luftës ndaj korrupsionit me fondet e BE-së, ka vijuar një bashkëpunim të vazhdueshëm me Rrjetit AFCOS.
- Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) ka filluar dy misione investigimi, lidhur me dyshimet për parregullësi. Në vijim të kërkesave të OLAF, AFCOS ka mundur të kontaktojë me Përfaqësuesit e Autoriteteve Kombëtare të përfshira në Rrjetin e Raportimit të Shërbimit AFCOS, dhe institucione të tjera shtetërore, në funksion të bashkëpunimit operacional për rastet e hetimit të kryera nga OLAF, si dhe ka asistuar në dhënien e informacionit të kërkuar nga OLAF (për dy rastet e investigimit).

7. ANGAZHIMET DHE OBJEKTIVAT

7.1. Realizimi i objektivave dhe aktiviteteve të vitit 2023:

- U realizua përmirësimi i kapaciteteve inspektuese dhe profesionale, si dhe rritje e përgjegjshmërisë dhe integritetit të inspektorëve financiarë publikë.
 - Trajnuar inspektorët financiarë publik mbi Kontrollin financiar dhe menaxhimin e fondeve të BE-së.
 - Janë zhvilluar takime dhe bashkëpunim i vazhdueshëm me Kontrollin e Lartë të Shtetit, organin e Prokurorisë si dhe Drejtues të Strukturave Audituese në Institucione Qendrore.
 - Gjithashtu në kuadër të luftës ndaj korrupsionit me fondet e BE-së, bashkëpunim i vazhdueshëm me OLAF, nëpërmjet rrjetit AFCOS.

- U realizua rritje cilësore e treguesve të shërbimit të inspektimit financiar publik nëpërmjet:

Plan aktivitete:

- Rritja e zbulueshmërisë së rasteve të keqmenaxhimit financiar dhe korrupsionit me dëm ekonomik në buxhetin e shtetit;
- Kryerja e inspektimeve financiare publike, me profesionalizëm e integritet, sipas rregullave të miratuara.
- Informimi i publikut për zbulimet e inspektimit financiar publik.
- Monitorimi i procesit të inspektimit financiar publik, në lidhje me vlerësimin e performancës së Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik.

- U realizua zgjerimi i përdoruesve (oficerët e parregullsive) të strukturave menaxhuese të IPA-s në AFIS portal.

Plan aktivitet:

- U mundësua akses në AFIS portal me përfaqësues respektivisht nga Agjencia e Zhvillimit Bujqësorë Rural (AZHBR), në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

- U realizuan objektivat dhe aktivitete të tjera të programuara sa vijon:
 - Shqyrtimi i kërkesave, informacioneve apo ankesave dhe dhenia e mendimit të Nëpunësi i Parë Autorizues për fillimin ose jo të inspektimit financiar publik apo të inspektimit paraprak.
 - Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit me OLAF.
 - Bashkëpunimi operacional me OLAF, (u zhvilluan 2 misione investigimi në Tiranë, në të cilën morën pjesë edhe përfaqësuesit e DIFP/AFCOS).
 - Monitorimi i zbatimit të masave të kërkuara nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, në përfundim të inspektimit financiar publik.

- Kërkimi dhe shkëmbimi i informacionit me njësi të tjera publike, në fushën e veprimtarisë së inspektimit financiar publik.
 - Përfshirja në Rrjetin e Raportimit AFCOS edhe të Strukturës së Posaçme të luftës kundër korrupsionit dhe Krimin të Organizuar SPAK dhe po punohet për përfshirjen e AKSH-it , sikurse kërkuar nga OLAF.
 - Ngritja e grupit të Punës për hartimin e strategjisë Kombëtare për mbrojtjen e Interesave Financiare të BE-së.
- Lidhur me ndërgjegjësimin e institucioneve publike, punonjësve të tyre si dhe publikut, mbi fushën e veprimtarisë së inspektimit financiar publik dhe kompetencat e Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik, me qëllim sensibilizimi, për të prezantuar rastet e parregullsive që konstatohen prej tyre, janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

Plan aktivitetet:

- Është bërë informimi i publikut nëpërmjet rubrikës “Denonconi Korrupsionin me Fondet Publike” të pasqyruar në ëeb-in e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
 - Në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, në menunë e informacionit mbi funksionet e DIFP, bëhet publikimi i përmbledhjeve ekzekutive dhe rezultateve të inspektimeve të kryera, si dhe raporti vjetor i veprimtarisë së DIFP.
 - Janë organizuar 3 takime me Drejtues të NJAB, në institucione qendrore, gjatë të cilave janë diskutuar mundësitë e bashkëpunimit si dhe raste konkrete të përcjella në DIFP/MFE.
- Lidhur me hartimin e Strategjisë Kombëtare për mbrojtjen e Interesave Financiare të BE-së:
 - Është hartuar urdhri për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare kundër mashtrimit, me qëllim mbrojtjen e interesave financiare të BE-së, në të cilën janë përfshirë operuese dhe menaxhuese të fondeve të BE-së (IPA & IPARD), si dhe disa struktura/ institucioneve, pjesë e rrjetit të raportimit të shërbimit “AFCOS”.
 - Për hartimin e kësaj strategjie DIFP/AFCOS do të vijojë me koordinimin e mundësimit të asistencës teknike nga OLAF, nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm që ka me këtë strukturë.
 - Strategjia është parashikuar të miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave brenda 3 muajve të parë të vitit 2025.

7.2. Objektivat dhe aktivitetet për vitin 2024:

“Inspektimi financiar publik nis vetëm mbi bazën e kërkesës, informacionit apo ankesës dhe jo në bazë të programeve ose planeve të paracaktuara”.

Puna e Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik për vitin 2024 do të fokusohet kryesisht në këto objektiva dhe aktivitete për realizimin e objektivave:

- Përmirësim i kapaciteteve inspektuese dhe profesionale, si dhe rritje e përgjegjshmërisë dhe integritetit të inspektorëve financiarë publikë:

Plan aktivitetet:

- ✓ Plotësimi i vendeve vakante.
- ✓ Trajnimi i inspektorëve financiarë publik.
- Rritje cilësore e treguesve të inspektimit financiar publik:

Plan aktivitetet:

- ✓ Rritje e besueshmërisë së Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik nëpërmjet rritjes së zbulueshmërisë së rasteve të keqmenaxhimit financiar dhe korrupsionit.
- ✓ Informimi i publikut për zbulimet e inspektimit financiar publik.

- Hartimi i Strategjisë Antikorrupsion për mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit Evropian:

Plan aktivitetet:

- ✓ Vlerësim për gjendjen aktuale dhe rrisqet që ekzistojnë në parandalimin e parregullive apo korrupsionit.
- ✓ Nevojat, masat, prioritetet dhe objektivat e çdo institucioni për parandalimin dhe eliminimin e parregullive dhe korrupsionit me fondet e EU-së.
- ✓ Plani i veprimit dhe indikatorët.
- ✓ Zbatimi dhe monitorimi i procesit.
- Vijim i procedurës së nisur për zgjerimin e përdoruesve (oficerët e parregullive) të strukturave menaxhuese të IPA-s në AFIS portal:

Plan aktivitetet:

- ✓ Për oficerët e përcaktuar të parregullive të strukturave të Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga BE, por jo vetëm.
- Aktivitete të tjera të DIFP të programuara për vitin 2024 janë:
- Shqyrtimi i kërkesave, informacioneve apo ankesave dhe dhënia e mendimit tek Nëpunësi i Parë Autorizues për fillimin ose jo të inspektimit financiar publik apo të inspektimit paraprak.
- Kryerja e inspektimeve financiare publike, me profesionalizëm e integritet, sipas rregullave të miratuara.
- Realizimi i procesit të përzgjedhjes së inspektorëve të jashtëm në profesionet e munguara.
- Trajnimi i inspektorëve financiarë publik.

- Monitorim i zbatimit të masave të kërkuara nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, në përfundim të inspektimit financiar publik.
- Kërkimi dhe shkëmbimi i informacionit me njësi të tjera publike, në fushën e veprimtarisë së inspektimit financiar publik.
- Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit me OLAF, si dhe bashkëpunimi operacional në raste të kërkuara prej tij.
- Rishikimi i Urdhrit të Ministrisë të Financave nr.84, datë 09.12.2015 “Për formimin e Rrjetit të Raportimit të Shërbimit AFCOS”, me qëllim përditësimin e emërtimeve të disa institucioneve të përfshira në këtë rrjet dhe përfshirja e institucioneve të reja, sikurse është Agjencia shtetërore e Kadastrës.
- Rishikimi i Marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura ndërmjet Ministrisë të Financave dhe drejtuesit e institucioneve, anëtarë të rrjetit AFCOS, në kuadër të ndryshimeve të Kuadrit ligjorë për organizimin dhe funksionimin e secilit prej këtyre institucioneve (Prokuroria e Përgjithshme, etj).

DREJTORIA E INSPEKTIMIT FINANCIAR PUBLIK

Mars 2024